



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Menaxhimin e Resurseve Ujore.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Përcaktimin e Procedurave Efektive për Identifikimin, Raportimin dhe Referimin ndaj Shfrytëzimit, Neglizhimit dhe Abuzimit të Fëmijës si dhe për Mbrojtjen e Fëmijës në Situatë Rruge.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 64 dhe 66 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, nenit 14 të Statutit Nr. 01/2023 të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 22/140 i datës 26 prill 2023, për emërimin e Bordit Drejtues të Shërbimit Klinik Universitar të Kosovës, si në vijim:
 - Dr. Naim Bardiqi, Ministria e Shëndetësisë zëvendësohet me Dr. Besa Balidemaj; dhe
 - Dr. Besim Demolli, nga Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj zëvendësohet me Dr. Ismet Ramadani nga Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, në bazë të rotacionit dhe përmbushjes së indikatorëve të kualitetit të shërbimeve shëndetësore.
- Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 22/140 të datës 26 prill 2023.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i parcelave Nr.1504-16 dhe 1504-17 dhe Objektit/Ndërtesës ish prona shoqërore "Pallati i Shtypit - Nderm.Inf.Botuese", për nevoja të Depos Qendrore të Barnave dhe akomodim të Administratës së Ministrisë së Shëndetësisë, Zona Kadastrale Prishtinë, Komuna Prishtinë, sipas tabelës bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Ministria e Shëndetësisë.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia e Republikës së Kosovës për Drejtësi Tranzicionale 2024-2034.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit 2024 - 2025 i Strategjisë për Migrim.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe të gjitha institucionet tjera kompetente për zbatimin e aktiviteteve nga Plani i Veprimit 2024-2025 nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Mbrojtjes për nënshkrimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Statusin e Forcave "SOFA" ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Mbretërisë Hashemite të Jordanisë.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Punësimit dhe Inovacionit Social (EaSI) të Fondit Social Evropian Plus (ESF+).
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/208

Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për aplikim për ndryshim të statusit të Republikës së Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë ("ONF") nga anëtar i asociuar në anëtar me të drejta të plota".
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Formulari/Kërkesa për ndryshimin e statusit të Republikës së Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi dhe ndërmarrjen e veprimeve në drejtim të realizimit të angazhimeve që burojnë nga Kërkesa/Formulari për ndryshimin e statusit të Republikës së Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
Ministarstvo Spoljnih Poslova i Diaspore - Ministry for Foreign Affairs and Diaspora**

Grupi Punues Ndërinstitucional (GPN)

**KËRKESA PËR AVANSIMIN E STATUSIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË
ORGANIZATËN NDËRKOMBËTARE TË FRANKOFONISË (ONF)**

Prishtinë, 31 maj 2024

I. PARAQITJA DHE ANGAZHIMET E SHTETIT APO QEVERISË KANDIDATE PËR NJË MODIFIKIM TË STATUSIT

Shteti/Qeveria: *Republika e Kosovës.*

Gjuhët zyrtare: *Gjuha shqipe dhe gjuha serbe.*

Korrespondenti për përpunimin e kësaj dosjeje (identiteti i personit/Ministrit, dhe koordinatat):

Avni Hasani, Ministër-Këshilltar/Zyrtar i lartë për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare; Koordinator nacional për ONF/ Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Rruga "Luan Haradinaj", p.n., 10.000, Prishtinë.

Tel: +383 44 172 795.

1. Shteti ose qeveria kandidate për modifikim të statusit duhet të paraqes motivet që e shtyjnë të procedojë me këtë kërkesë për ndryshimin e statusit. Shteti ose qeveria pas pagesës së kontributit të saj statutor, duhet të paraqes evoluimet e situatës në lidhje me gjuhën frënge, demokracinë, të drejtave dhe lirive, mbështetjen e vet për paqen, por edhe respektimin e angazhimeve të marrura në këto fusha kur ajo u bashkua ose gjatë një ndryshimi të mëparshëm të statusit:

Kërkesa e Republikës së Kosovës për ndryshimin e statusit të saj në ONF, avancimi nga anëtar i asociuar në anëtar me të drejta të plota, në rend të parë ka për bazë interesin dhe vullnetin e saj politik për të zhvilluar më tej bashkëpunimin me ONF-në dhe me vendet tjera të hapësirës frankofone, si dhe integrimin e mëtutjeshëm dhe të tërësishëm të saj në arenën ndërkombëtare. Kosova ndan vlera të përbashkëta me ONF-në, si: gjuha frënge, multilinguizmi, multikulturalizmi, barazia gjinore, të drejtat e njeriut, paqja, solidariteti dhe demokracia, si dhe dëshiron që këto vlera t'i kultivojë dhe zhvillojë në vazhdimësi duke bashkëpunuar me këtë organizatë dhe me të gjitha vendet e hapësirës frankofone.

Duke u bërë tashmë dhjetë (10) vjet prej pranimit të saj si anëtar vëzhgues i Frankofonisë (Dakar, 2014) dhe gjashtë (6) vjet prej avancimit si anëtare e asociuar (Erevan, 2018), Republika e Kosovës ka zhvilluar aktiviteteve dhe projekte të ndryshme, duke dëshmuar se është e gatshme për të thelluar më tej bashkëpunimin me ONF-në. Këtu janë disa prej atyre aktiviteteve dhe projekteve të bashkëpunimit të cilat janë realizuar dhe të cilat vazhdojnë të realizohen, e që njëkohësisht janë edhe motiv për avansimin e statusit pranë kësaj organizate.

1. *Festimi në Kosovë për çdo vit i Javës së Frankofonisë. Aktivitete të shumta kulturore mbahen çdo vit në kryeqytet dhe në qytete tjera të Kosovës me qëllim promovimi të gjuhës frënge dhe kulturës frankofone. Përveç kryeqytetit, çdo vit zgjedhet edhe nje qytet tjetër i Kosovës që konsiderohet si "kryeqytet i Frankofonisë" dhe ku zhvillohen aktivitete të ndryshme kulturore për këtë qëllim. Në vitin 2023 kryeqytet i Frankofonisë në Kosovë ka qenë Peja, kurse për vitin 2024 është Mitrovica. Sivjet, përveç Javës së Frankofonisë dhe Javës së filmi frankofon, Kosova organizon aktivitete kulturore edhe për Festivalin e Frankofonisë 2024. Këtë do ta bëjnë përfaqësitë diplomatike kudo në botë, e sidomos ato në vendet frankofone.*
2. *Avancimi i statusit të Kuvendit të Kosovës në anëtar të Asociuar, në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë (APF), si dhe aktivitetet e rregullta që i bënë Kuvendi i Kosovës si anëtar i APF-së. Vitin e kaluar ka mbajtur Konferencën «Promovimi i një*

Kuvendi me ndjeshmëri gjinore» kurse sivjet, në nëntor 2024, do të jetë nikoqir i Asamblesë Rajonale e Evropës e Asamblesë Parlamentare Frankofone (APFAER) dhe tema qendrore e sesionit do të jetë: “Demokracia, siguria dhe lajmet e rreme”;

3. *Kryerja me sukses e projektit Iniciativa Kombëtare Frankofone (INF) për periudhën 2019-2022, si dhe vazhdimi i projektit të njëjtë për periudhën 2023-2026, përmes së cilës është paraparë që Kosova të përgatisë personelin e saj, zyrtarët e lartë/diplomatët për ta përfaqësuar atë në frëngjisht në të gjitha nivelet e përgjegjësisë në nivel ndërkombëtar. Poashtu MPJD në kuadër të konkurseve të fundit të shpallura për zyrtarë të ri të shërbimit të jashtëm (7 zyrtar/e), në kuadër të kritereve rekrutuese si kualifikim të posaçëm formal, ka kërkuar njohuri të gjuhës frënge për kandidatët/et e interesuar/a. Është e rëndësishme që të vazhdohet projekti aktual si dhe krijimi i projekteve të tjera i trajnimit në frëngjisht për zyrtarët publik-diplomatët e Kosovës si dhe që politikat e resurseve humane të përforcohen me synim që të jenë më favorizuese për frëngjishten (ANEX 1).*
4. *Krijimi i Shoqatës së Profesorëve të Frëngjishtes (APFK) dhe organizimi i spektakleve dhe aktiviteteve të ndryshme kulturore në gjuhën frënge me nxënës të shkollave dhe gjimnazeve në Kosovë, në bashkëpunim me Alliance française dhe me ambasadat e vendeve frankofone në Kosovë; trajnimi i vazhdueshëm i arsimtarëve të frëngjishtes për mësimdhënien më të mirë të gjuhës frënge; si dhe pjesëmarrja e Kosovës në projektet e CREFECO;*
5. *Pjesëmarrja e disa universiteteve të Kosovës (Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe ai i Mitrovicës “Isa Boletini”) në Agjencinë Universitare Frankofone (AUF) dhe interesimi i disa të tjerave për tu anëtarësuar (Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”, Universiteti i Pejes “Haxhi Zeka”, Universiteti i Ferizajit si dhe kolegjet private “Rezonanca” dhe kolegji AAB);*
6. *Hapja e Centre d’Employabilité Francophone në UP dhe hapja e katër qendrave tjera frankofone “Espace France” në Pejë, Prizren, Vushtrri dhe Fushë Kosovë;*
7. *Pjesëmarrja e Kosovës deri tash në dy edicione të Lojërave të Frankofonisë (Abidjan 2017, Kinshasa 2023) dhe fitimi total i gjashtë medaljeve, gjysma prej të cilave janë të arit;*
8. *Pjesëmarrja aktive e përfaqësisë diplomatike të Republikës së Kosovës në Grupin e Ambasadorëve Frankofonë (GAF);*
9. *Anëtarësimi i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKM) në AIMF (Cotonou, 2023) dhe interesimi i disa komunave të Kosovës (Gjakovë, Viti), përfshirë edhe Prishtinën si kryeqytet, për tu bërë pjesë e AIMF-it;*
10. *Anëtarësimi dhe pjesëmarrja e institucioneve të Kosovës në Rrjetet Institucionale Frankofone (RIF). Deri tash 6(gjashtë) institucione të Kosovës janë anëtarësuar në RIF:*
 - *Oda e Avokatëve të Kosovës,*
 - *Akademia e Kosovës për Siguri Publike,*
 - *Institucioni i Avokatit të Popullit,*

- Agjencia për Informim dhe Privatësi, 2023
- Gjykata Supreme e Kosovës, 2023;
- Këshillit Qendror Zgjedhor (KQZ).

11. Synimi i disa institucioneve tjera të sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe demokracisë, për tu bërë pjesë e RIF, si përpjekja e mëhershme e Gjykatës Kushtetuese e Kosovës, për tu bërë pjesë e Association de cours constitutionnelles francophones (ACCF)'
12. Bashkëpunimi i thelluar akademik dhe kulturor, sidomos në fushën e trashëgimisë kulturore dhe arkeologjisë, filmit dhe kinematografisë, muzikës, teatrit dhe arteve pamore, me vendet frankofone, veçanërisht me Francën;
13. Mbajtja në Kosovë për çdo vit e Festivalit të filmit frankofon. Në vitin 2023 është mbajtur edicioni i XIII-të dhe filma të ndryshëm frankofonë janë shfaqur në kinematë e Kosovës;
14. Ekzistimi në Kosovë i një popullate frankofone, e veçanërisht i një diaspore të madhe frankofone, është motiv shtesë për të avansuar statusin në Frankofoni. Një rajon i tërë i Kosovës, ku hyjnë komunat Gjilan, Viti dhe Kamenicë ka diasporë përgjithësisht frankofone;
15. Bashkëpunimi në fushën e ekonomisë me vendet e hapësirës frankofone, veçanërisht me Zvicrën, Francën, Belgjikën, Kanadanë etj., dhe dëshira për të thelluar dhe zgjeruar akoma më shumë atë bashkëpunim;
16. Vazhdimi i traditës së gjatë të mësimin të frëngjishtes nëpër shkolla dhe universitete të Kosovës. Tash 50 vjet në Universitetin e Prishtinës ekziston Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Frënge, kurse gjuha frënge si gjuhë e huaj mësohet edhe në departamente tjera të UP-së.
17. Bashkëpunimi në fushën e arsimit mes universiteteve publike të Kosovës, veçanërisht Universitetit të Prishtinës « Hasan Prishtina » me universitete të Francës (Ecole Normale Supérieure, Sorbone, Nanterre, Toulouse) si dhe me universitete të vendeve tjera frankofone, si dhe Marrëveshja mes dy qeverive për bursa për studentët kosovarë që kryejnë studimet Master në Francë ;
18. Bashkëpunimi i mirë i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës me Unionin Akademik Ndërkombëtar (UAI) dhe me Akademinë franceze;
19. Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e Kosovës në punën e grupeve, komisioneve, komiteteve dhe instancave të Frankofonisë (CPF, CMF dhe Samit);
20. Pagesa e rregullt e kontributeve statutoire të Kosovës për ONF. Kosova asnjëherë nuk ka shënuar ndonjë vonesë në pagesën e kontributeve statutoire dhe sigurisht se kjo praktikë e mirë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Avancimi i statusit të Republikës së Kosovës në ONF, po ashtu do ta mundësonte pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e saj në shumë projekte dhe programe tjera të rëndësishme të kësaj organizate, sidomos në Projektet Phare për çka Kosova ka parakushte të jashtëzakonshme,

sidomos për të bashkëpunuar me Projektin « D-Clic » dhe atë « La Francophonie avec Elles », si dhe në përhapjen dhe promovimin e vlerave dhe orientimeve strategjike të ONF-së siç janë zhvillimi i qëndrueshëm, tranzicioni energjetik, digjitalizimi, qasja dhe kërkimi në internet (la découvrabilité au Internet).

Kosova ka ndërmarrë disa hapa në fushën e zhvillimit të demokracisë, të sundimit të ligjit, të drejtave njeriut dhe lirive themelore, si dhe është e përgjegjshme në fushën e ruajtjes së paqes dhe sigurisë rajonale. Shpjegimet konkrete për të gjitha këto janë në pjesën III të këtij formulari, por këtu përgjithësisht po përmendim se në vitet e fundit janë bërë disa reforma të rëndësishme në fushën e sundimit të ligjit, janë miratuar ligje dhe janë marrë vendime, janë zhvilluar aktivitete të ndryshme formative, publike, teknike, politike dhe juridiko-kushtetuese (Konventa e Stambollit), si dhe janë bërë disa marrëveshje të rëndësishme, përfshirë edhe marrëveshje ndërkombëtare (Marrëveshja e Brukselit për Normalizimin e Marrëdhënieve Kosovë - Serbi me lehtësimin e BE-së, pastaj Ankeksi zbatues i kësaj marrëveshjeje, i arritur në Ohër, 2023) në këto fusha të jetës.

Kosova i kontribuon ruajtjes së paqës në rajon dhe vazhdon të ketë marrëdhënie të shkëlqyeshme me të gjithë fqinjët e vet, me përjashtim të Serbisë me të cilën ka mosmarrëveshje në lidhje me njohjen reciproke, por që në bisedimet me këtë shtet, të ndërmjetësuara dhe lehtësuara nga BE-ja, Kosova përherë është treguar palë konstruktive, e interesuar dhe e angazhuar që t'i kalojë të gjitha mosmarrëveshjet vetëm përmes rrugës së dialogut, pra në mënyrë paqësore.

Avancimi i statusit të Kosovës në ONF do të ndikojë edhe më shumë në promovimin dhe përhapjen e mëtejme të gjuhës frënge dhe kulturës frankofone në Kosovë, që do të thotë se do të shoqërohej edhe me ndryshime në kurrikulat shkollore dhe zhvillimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare në funksion të promovimit të gjuhës frënge dhe kulturës frankofone; pastaj me ndryshime në skemat mediale me qëllim bashkëpunimi me mediat frankofone dhe me përdorimin më të madh të gjuhës frënge në komunikimin publik të zyrtarëve të lartë, në konferencat dhe takimet ndërkombëtare.

Këto pra janë disa nga motivet për të cilat Republika e Kosovës dëshiron të bëhet anëtar me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë.

- 2. Në funksion të specifikave të tij, shteti ose qeveria që aplikon për një modifikim të statusit duhet të specifikojë angazhimet shtesë që synon t'i bëjë në raport me përdorimin dhe promovimin e gjuhës frënge dhe thellimin e demokracisë, të drejtave dhe lirive në përputhje me kriteret që gjenden përkatësisht në Titujt II dhe III të këtij formulari:**

Qeveria e Kosovës do të marrë masa për përmirësimin e statusit të frëngjishtës dhe përdorimit të saj në sferën publike të shoqërisë kosovare. Këto janë disa masa konkrete të cilat pritet se do të ndërmerren në këtë drejtim:

- 1. Ndryshimi në Kurrikulën e Arsimit Parauniversitar, ku frëngjishtja figuron si gjuhë e huaj e detyrë opsionale. Nëpër disa shkolla frëngjishtja do të bëhet si gjuhë obligative;*

2. Në disa komuna të Kosovës do të synohet të hapen shkolla dygjuhësore, ku krahas gjuhës zyrtare, disa lëndë mësimore do të zhvillohen edhe në gjuhën frënge. Tashmë në Kosovë, në komunën e Vushtrrisë ekziston një shkollë e tillë, por diçka e tillë do të mund të bëhej edhe në Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan;
 3. Në universitete publike dhe kolegje private do të avansohet statusi i frëngjishtes si gjuhë e huaj. Ajo do të jetë pjesë e kurrikulës së programeve studimore, sidomos në nivelin BA dhe MA;
 4. Në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" do të mundësohet që në Universitetin Veror, të ketë kurse edhe në gjuhën frënge. (Në fushën e Letërsisë, Arkeologjisë dhe në atë të Shkencave politike, mund të mbahen kurse edhe në frëngjisht). Kurse në gjuhën frënge do të mbahen edhe gjatë Universitetit veror dhe atij dimëror në Universitetin "Haxhi Zeka" të Pejës, si dhe në Universitetin veror që do të fillojë të mbahet nga viti i ardhshëm akademik nga Universiteti "Fehmi Agani" i Gjakovës;
 5. Në universitete publike dhe kolegje private do të krijohet hapësirë frankofone duke u krijuar qendra frankofone (Espace France). Tashmë këto qendra ekzistojnë: në Kolegjin AAB, dhe UPZ, në Institutin për aftësime profesionale në Fushë Kosovë - KTC, në kinemanë "Jusuf Gërvalla" në Pejë si dhe në shkollën "Bahri Haxha" në Vushtri;
 6. Institucionet qeveritare të Kosovës dhe institucionet tjera publike, përfshirë edhe Universitetin e Prishtinës, në faqet e tyre zyrtare do të vendosin informata për punën dhe aktivitetet e tyre edhe në gjuhën frënge. Aktualisht këtë e bënë Gjykata Kushtetuese e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës, si institucione të shtetit, si edhe Grupi KOHA në fushën e biznesit medial;
 7. Në konferencat ndërkombëtare të organizuara nga ASHAK, Universiteti i Prishtinës dhe universitetet tjera publike dhe kolegjet private, si dhe shoqatat tjera profesionale ose shoqëria civile do të flitet edhe frëngjisht. Botimi i kumtesave dhe rezymeve të artikujve nëpër revista shkencore dhe akademike do të bëhet edhe në frëngjisht. Kësisoj, në Kosovë frëngjishtja do të bëhet gjuhë akademike;
 8. Do të shtohet numri i diplomatëve dhe zyrtarëve të lartë të Kosovës që merren me dosje ndërkombëtare, e që do të jenë në gjendje të flasin dhe përfaqësojnë qëndrimet shtetërore nëpër forume ndërkombëtare në frëngjisht;
 9. Mediat kosovare do të emitojnë emisione me përmbajtje programore frankofone. Në platformën ART MOTION, DOC 1 dhe Doc 2 vazhdimisht transmetohen emisione/ dokumentarë në frëngjisht;
3. Si e parashikon shteti ose qeveria që kërkon ndryshimin e statusit të rrisë kontributin e saj në promovimin dhe ndikimin e Frankofonisë si dhe zbatimin e kornizës strategjike të ONF-së (përfshirë strategjitë e saj sektoriale dhe transversale): Klikoni këtu për të shtypur tekstin.
- o Kosova do t'i rris angazhimet e saj për avansimin e mësimin, përdorimit dhe promovimit të gjuhës frënge, kulturës frankofone dhe multilinguizmit në përgjithësi.

Përveç kurseve për diplomatët dhe zyrtarët e lartë, siç ka ndodhur me projektin Iniciativa Nacionale frankofone(INF) në fazën e parë 2019-2022 dhe aktualisht është duke ndodhur me fazën e dytë 2023-2026, do të organizohen kurse edhe nga institucionet e veçanta, si Kuvendi i Kosovës, Gjykata Kushtetuese,etj;

- *Aleanca Franceze, në bashkëpunim me Akademinë Diplomatike dhe Ambasadën e Francës në Kosovë do të organizojnë kurse falas për nivelin A1 të frëngjishtes për zyrtarët dhe diplomatët e MPJD-së për vitin 2024, në mënyrë që të njejtët në vijim të pjesës së dytë të vitit 2024 të jenë të gatshëm për vijimin e kurseve të specializuara të frëngjishtes të nivelit A2 që ofrohen në kuadër të Iniciativës Nacionale Frankofone(INF) 2023-2026;*
- *Qendrat Frankofone (Espace France) tashmë janë hapur në pesë komuna të Kosovës dhe pritet që ato të hapen edhe në disa komuna tjera;*
- *Aktivitete tjera që kanë të bëjnë me trajnimet, seminarët, konferencat, koncertet, festivalet, sportin, artet pamore, teatrin, kinemanë, botimet dhe memorandumet e bashkëpunimit me vendet frankofone do të vazhdojnë edhe më tutje;*
- *Kosova do të vazhdojë të marrë pjesë në Lojërat e Frankofonisë, ku deri tash ka fituar 6 medalje; do të vazhdojë bashkëpunimin me vendet frankofone, veçanërisht me Francën në fushën e kinematografisë, hulumtimit arkeologjik dhe bashkëpunimit akademik;*
- *Kosova do të përdorë frëngjishten si gjuhë akademike në institucionet shkencore dhe akademike, si: Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës(ASHAK) Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP), Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë(UHZ), Universiteti Fehmi Agani në Gjakovë(UFA), etj. Tashmë në Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës gjuha frënge përdoret si në aktivitetet shkencore (fjalimet në konferenca dhe simpoziume) ashtu edhe në publikimet, përkatësisht revistat e saj. Rezimetë e revistës “Studime shoqërore” janë zakonisht në frëngjisht. Rezimetë e librave të publikuara nga ASHAK po ashtu. E njëjta pritet të ndodh edhe në institutet dhe universitetet tjera të Kosovës;*
- *Në Universitetin Veror, në kuadër të Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, por edhe në kuadër të Universitetit Veror dhe atij Dimëror të Universitetit publik “Haxhi Zeka” në Pejë, do të ketë kurse edhe në gjuhën frënge. Kjo do të ndodhë edhe në Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë. Aty do të themelohet edhe Instituti Gjuhësor dhe në atë institut do të mësohet edhe gjuha frënge. Kësisoj gjuha frënge në Kosovë synohet të bëhet, jo vetëm gjuhë e komunikimit publik, por edhe gjuhë e artit dhe shkencës;*
- *Zhvillimi i qëndrueshëm në fusha të ndryshme si urbanizmi, bujqësia, agrobiznesi, turizmi, energjetika. Përveç Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) i cili tashmë është bërë pjesë e AIMF, pjesë e kësaj të fundit pritet të bëhen edhe disa komuna tjera. Komuna e Prishtinës, pra kryeqyteti i Kosovës, komuna e Gjakovës dhe ajo e Vitisë tashmë kanë shprehur vullnetin për këtë. Kësisoj trendet dhe konceptet bashkëkohore që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë, urbanizmin, gjithpërfshirjen, ekologjinë janë në zhvillim e sipër;*

- Zhvillimi i digjitalizimit në Kosovë, në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, si: qeverisja dhe administrata publike, arsimit, mjekësia, agrobiznesi, komunikimi, do të vazhdojë duke ofruar kështu mundësi të barabarta si për burrat, ashtu edhe për gratë dhe vajzat, si për pjesëtarët e komunitetin etnik shumicë, ashtu edhe për ata të komuniteteve etnike pakicë;
- Kosova ka bërë Agjendën digjitale 2030 dhe në masë të madhe ai dokument përputhet me Kornizën Strategjike të Frankofonisë, sidomos në aspektin e digjitalizimit të shërbimeve publike dhe e-qeverisjes. Kosova ka mbulueshmëri 100% me internet dhe në aspektin e përdorimit të internetit dhe dixhitalizimit të shërbimeve qëndron më mirë se shumë vende tjera evropiane.

4. Shteti ose qeveria që aplikon për një modifikim të statusit duhet të shpjegojë, sipas nevojës, forcimin e marrëdhënieve të saj institucionale me Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë ("APF"), Agjencinë universitare e Frankofonisë ("AUF"), TV5Monde, Universitetin Senghor, Shoqatën Ndërkombëtare Frankofone të Kryetarëve të komunave ("AIMF"), Konferencën e Ministrave të Arsimit Kombëtar ("Confémen"), Konferenca e Ministrave të Rinisë dhe Sport ("Confejes"):

Marrëdhëniet me Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë (APF) - Kuvendi i Republikës së Kosovës i është bashkuar Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë si anëtare vëzhguese në korrik 2018. Më 9 korrik 2021, Asambleja e Përgjithshme e Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë (APF), me votim njëzëri ka konfirmuar vendimin për avancim të statusit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga vëzhgues në anëtar i asociuar. Vendimi u mor gjatë Sesionit të 47-të APF mbajtur në Kigali, Ruanda. Kështu, avancimi i statusit të Kuvendit të Republikës së Kosovës do të kontribuojë në zhvillimin e projekteve të reja të bashkëpunimit me institucionet, partnerët, vendet, parlamentet dhe qeveritë e anëtarëve të ONF. Delegacioni i Përhershëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës merr pjesë rregullisht në aktivitetet e APF- Me 1 mars 2021, është shpërndarë ftesa për aplikim për pjesëmarrje në edicionin e parë të Parlamentit Frankofon Rinor në Kosovë/Appel à candidature pour participer au premier parlement francophone des jeunes du Kosovo. Me 17 mars 2021, është mbajtur takimi i parë virtual me kandidatët e përzgjedhur për pjesëmarrje në Parlamentin Rinor të Frankofonisë. Më 7-10 shtator 2021, Asambleja Parlamentare e Frankofonisë së bashku me Kuvendin e Republikës së Kosovës, organizuan Parlamentin e parë të Frankofonëve të Rinj në Kosovë. Parlamenti Rinor, është një iniciativë në favor të rinisë kosovare e cila synon të promovojë vlerat e demokracisë, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe debatin në botën parlamentare, dedikuar të rinjve/studentëve të moshës nga 18 dhe 23 vjeç. Atë vit, ky edicion u mbajt në Pejë dhe mbledhi rreth njëzet (20) të rinj. (<https://uni-pr.edu/page.aspx?id=1,6,1321> linku i vitit 2021).

Me 25 gusht 2021, Nënkryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj Saranda Bogujevci dhe kryesuesi i Delegacionit të Përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblenë Parlamentare të Frankofonisë, deputeti Dimal Basha, pritën në takim z. Eric Poppe, Udhëheqës Regjional për Evropën Qendrore dhe Lindore në organizatën e Frankofonisë. Gjatë kësaj periudhe kohore, pra janë realizuar vizita të përfaqësuesve regjionale për Evropën Qendrore dhe Lindore në kuadër të ONF-së. Me 25-31 korrik 2022, Kuvendi i Kosovës ka mbështetur frankofonët e rinj nga edicioni në Prishtinë, duke siguruar pjesëmarrjen e studentëve nga Kosova: Desantila Muriqi, Mihane Beqiri dhe Alfred Buqaj, në edicionin e radhës të Parlamentit Rinor Frankofon i mbajtur në Tiranë, nga data 25 deri më 31 korrik

2022. Studentët kosovarë kanë bërë prezentimet e tyre, kanë hartuar raportin dhe rezolutën e Komisioneve përkatëse (ANEX 2).

Në kuadër të sesionit të radhës së Asamblesë së përgjithshme të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë, planifikuar të mbahet në Montréal (Canada), prej datës 4-9 korrik 2024, do të mbahet edhe Edicioni i 10-të i Parlamentit Rinor Frankofon, ku të ftuar për pjesëmarrje, përkatësisht, përfitues të këtij edicioni do të jenë edhe dy studentë, një vajzë dhe një djalë, të moshës 18-25 vjeç, nga Kosova. Lidhur me këtë, bazuar në përvojën e edicionit të parë të Parlamentit Rinor Frankofon në Kosovë, të mbajtur, tashmë Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur kandidatët/studentët të cilët do ta përfaqësojnë Kosovën në mesin e të rinjëve nga shtetet anëtare të AFP dhe ata janë Znj. Desantila Muriqi dhe z. Agon Sadiku.

Eshtë me rëndësi të përmendim se kjo mundësi për të rinjtë tanë vjen si rezultat i dy zhvillimeve të rëndësishme: organizimi i Edicionit të parë të Parlamentit të frankofonëve të rinjë, organizuar në Prishtinë, në shtator të vitit 2021, ku në fund të këtij edicioni janë propozuar edhe dy studentët e dalluar dhe avancimi e statusit të Kuvendit të Kosovës në APF, nga anëtar vëzhgues në anëtar i asociuar (ANEX 3).

Me 13 - 15 maj 2023, me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Rrjetin e Grave Parlamentare të APF-së, kanë organizuar seminarin me titull: «Promovimi i një kuvendi me ndjeshmëri gjinore», i cili trajtoi tema mbi barazinë gjinore në procesin legjislativ. Pjesëmarrës në këtë seminar ishin deputetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Gratë e mbijetuara nga dhuna seksuale gjatë luftës në Kosovë. Delegacioni i deputetëve të Rrjetit të Grave Parlamentare të APF-së, kryesuar nga Chantal Soucy, kryetare e Rrjetit të Grave Parlamentare të APF-së, u mirëprit nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca, pastaj edhe nga Presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani Sadriu, e cila iu foli për iniciativat e ndërmarra nga Kabineti i saj për forcimin e legjislacionit në favor të barazisë gjinore (Konventa e Stambollit) e të cilin Kosova e ratifikoi dhe e përfshiu në Kushtetutën e saj në shtator të vitit 2020.

Nga 4-8 korrik 2023, me ftesë të Parlamentit të Gjeorgjisë, Delegacioni i Kuvendit të Kosovës mori pjesë në sesionin e 48-të të APF-së, i cili u mbajt në Tbilisi. Kjo është pjesëmarrja e parë e Kuvendit të Kosovës me të drejtë vote në këtë Asamble. Kuvendi i Kosovës në përgjithësi zhvillon marrëdhënie të mira me vendet Frankofone. Në legjislaturën e kaluar, Kuvendi i Kosovës kishte ofruar ndihmë financiare për kurset e gjuhës frënge për deputetet dhe stafin, mirëpo për shkak të zgjedhjeve të parakohshme në vend, kursi ishte ndërprerë. Duhet shtuar se që nga viti 2015, Kryesia e Kuvendit ka formuar Grupet parlamentare të miqësisë me parlamentet e 56 shteteve, duke përfshirë edhe grupet e Miqësisë me vende frankofone si me Rumaninë, me Francën, me Belgjikën, me Kanadanë, me Tunizinë, me Zvicrën etj.

Delegacioni i Përhershëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë (APF), mori pjesë në Sesionin e 35-të të Asamblesës Rajonale të APF-së për Rajonin e Evropës. Ky sesion u organizua nga Parlamenti i Greqisë dhe u mbajt në Athinë në datat 5-7 nëntor 2023. Tema kryesore e diskutimit ishte pasojat e luftës në Ukrainë në Evropë dhe ndryshimet gjeopolitike që sjell në botë.

Delegacioni i Kosovës ka qenë pjesë e diskutimeve në dy pika të ndara në 3 panele tematike:

1. "Luftërat në shtetet ish-komuniste dhe zgjerimi i BE-së", paneli "Pasojat e luftës në Ukrainë në Evropë: kriza sistemike, kriza e migracionit, kriza energjetike dhe ekonomike".

2. "Lufta e Ukrainës, një luftë evropiane? Konflikti dhe qëndrueshmëria e kryqëzuar: Rusi-Evropë-Ukrainë", paneli "Demokracia përballë luftës: sfidat, çështjet dhe dobësitë".

Në fjalën e tij, Kryesuesi i delegacionit të Kuvendit të Kosovës, Deputeti Dimal Basha, ka shprehur pozicionin e Kosovës në lidhje me situatën në Ukrainë, duke dënuar agresionin rus mbi Ukrainën dhe ka vënë në dukje rrezikun që paraqet Rusia për demokracinë në Evropë, në veçanti ka vënë theksin te Serbia e cila sillet si satelit i Ruisë. Ai gjithashtu ka shprehur solidaritetin me popullin e Ukrainës dhe ka theksuar gatishmërinë e Kosovës për të pranuar refugjatë nga Ukraina, si dhe ka dënuar sulmin terrorist të 24 shtatorit të vitit 2023 në veriun e Kosovës që ka pas për synim kërcënimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit. Në pikën e debatit për temën "Demokracia përballë luftës", Deputeti Basha ka analizuar kërcënimet e Ruisë, duke terhequr paralele me dhunën dhe synimin e aneksimit të territorit të Kosovës nga ana e Serbisë! Kryesuesi i delegacionit kosovar ka propozuar një amandament për dënimin e sulmit terrorist në veriun e Kosovës, me synim të parandalimit të destabilizimit dhe kërcënimin të sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës. Amandamenti ka gjetur mbështetjen e të gjithë deputetëve të pranishëm.

Asambleja Rajonale ka përfunduar punimet me përcaktimin e vendndodhjeve dhe datave për Konferencën e Presidentëve 2024 dhe Asamblesë Rajonale të Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë (AER), ku është miratuar propozimi i Delegacionit të Kuvendit të Kosovës që Asambleja Rajonale e Evropës e Asamblesë Parlamentare Frankofone (APFAER) të organizohet në Kosovë në nëntorin e vitit 2024. Propozimi u miratua unanimitisht dhe pritet që në nëntorin e këtij viti të mbledhet në Prishtinë rreth 100 pjesëmarrës nga vendet anëtarë të kësaj Asambleje (datat opsionale: 11-12 nëntor 2024 (inë e preferueshme) dhe 4-5 nëntor 2024), kurse tema qendrore e sesionit do të jetë: "Demokracia, siguria dhe lajmet e reze" (ANEX 4).

Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF) - Anëtare të AUF janë : Universiteti i Prishtinës « Hasan Prishtina », Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", Universiteti i Prizrenit « Ukshin Hoti » dhe Universiteti i Mitrovicës « Isa Boletini », kurse kanë shprehur vullnetin dhe interesimin për anëtarësim edhe Universiteti i Ferizajit, Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka", Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka" si dhe Universitetet/kolegjet private "Rezonanca" dhe kolegji AAB.

Në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Filologjisë, në 21 mars 2023, në fillimin e Javës së Frankofonisë, në 50 vjetorin e ONF-së është promovuar Qendra Profesionale e Frankofonisë. Kjo në të vërtetë është një rihapje e Qendrës së Frankofonisë e cila ekzistonte më parë në këtë hapësirë, por tash me koncept të ri të orientimit profesional dhe punësimit të rinjve frankofonë. Ky është një nga projektet kryesore të strategjisë 2021-2025 të AUF-së për studentë dhe të sapo diplomuarit. Kjo Qendër synon të mbështesë orientimin dhe integrimin profesional, si dhe të promovojë ndërmarrësinë dhe sidomos mësimdhënien dixhitale, duke ofruar shërbime të përmbledhura rreth katër pikave:

1. Këshilla dhe orientim për punësim,
2. Trajnime plotësuese, integrim profesional,
3. Certifikim profesional,
4. Para-inkubacion ndërmarrësie (mbështetje në ngritjen e një projekti, mbështetje studimore, trajnime specifike.

Për mësimdhënësit dhe studiuesit, kjo qendër është një vend për shkëmbim idesh, promovim të rezultateve kërkimore, formim ekipesh për t'u përgjigjur thirrjeve për projekte, qasje në burimet e mësimdhënies, shkëmbime praktikash, zhvillim në mësimdhënie digjitale etj.

Qendra aktualisht mbështet të rinjtë tanë në botën e integrimit profesional duke u ofruar trajnime specifike dhe mundësi për të krijuar projekte. Për periudhën shtator-dhjetor 2023 Qendra ka pasur në planin e punës këto aktivitete :

- *Pôle 1: Insertion: Techniques de recherche d'emploi et de stages*
- *Pôle 1: Insertion: Rédaction d'un CV, d'une lettre de motivation*
- *Pôle 2: Formation : Se former en ligne, apprentissage autonome et responsable*
- *Pôle 2: Formation : Les nouveaux outils pour l'évaluation*
- *Pôle 2: Validation des acquis de l'expérience*
- *Pôle 4: Entrepreneuriat: Formation ménagement de projet*
- *Pôle 4 : Entrepreneuriat : Formation entrepreneuriat*

Që nga vitit 2018, kur fillimisht ishte themeluar Qendra e Frankofonisë, ajo ka ofruar trajnime në këto tema:

- *Evaluimi pozitiv në orët e frengjishtës si gjuhë e huaj,*
- *Mësimdhënja përmes programit TV5 Monde,*
- *Përdorimi i përkthimit në mësimdhënien / mësimnxënjen e FLE: qasje të reja,*
- *Integrimi dixhital në mësimdhënien / mësimnxënjen e gjuhës frënge,*
- *Leximi përmes dixhitalizimit)*
- *Mësimdhënja me teknologjinë dixhitale dhe senarizimi pedagogjik.*

Qendra Frankofone tash Qendra Profesionale Frankofone ka pasur bashkëpunime me Qendrat frankofone në Rumani, me ESFAM në Bullgari ku ka pasur edhe projekte të përbashkëta me Qendrën Frankofone në Tirane, si dhe me Qendren digjitale të Universitetit të Caen (France), pastaj edhe me Shoqatën Scenari France.

Bashkëpunimi me AUF, Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Frënge të Universitetit të Prishtinës i ka sjellur dobi edhe në përfshirjen në projekte Erasmus+. Kësisoj ky Departament tashmë është i përfshirë në dy projekte të tilla : për periudhën 2019-2022 ka patur bashkëpunim me Universiteti Ternav, Sllovakia; kurse në periudhën 2020-2022 dhe 2022-2025 ka patur dhe do të ketë bashkëpunim në programin Erasmus me Universitetin Caen të Francës.

Me Universitetin Nanterre Paris, ka bashkëpunim me programin Erasmus+ edhe Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, kurse me Universitetin e Nice ka bashkëpunim Fakulteti Ekonomik. Me École Normale Supérieure bashkëpunon Departamenti i Arkeologjisë dhe Antropologjisë i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës si edhe me disa universitete tjera franceze..

Pjesë e aktiviteteve të Qendrës Frankofone në Prishtinë ka qenë edhe krijimi i Klubit të Nxënësve Frankofonë (CLEF), si dhe bashkëpunimi me qendrat frankofone nëpër komuna të Kosovës. Kurse një marrëveshje bashkëpunimi njafë e veçantë është ajo e bashkëpunimit mes gastronomisë franceze dhe asaj kosovare, projekt ky që zhvillohet me studentët e Departamentit të Gjuhës frënge të Universitetit të Prishtinës.

Në vitin 2022, mes MASHTI-it dhe Ambasadës së Francës në Kosovë është nënshkruar Marrëveshja për Bashkëfinancimin e Bursave të Arsimit të Lartë në Nivelin Master

(marrëveshja e bashkëpunimit). Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, në vitin akademik 2022-2023 kanë nisur studimet në universitete franceze 4 studente/ë. (ANEX 5).

TV5Monde – Kosova ka bashkëpunim me TV5Monde. Në kuadër të projektit “Destination” ky televizion ka bërë një dokumentar të shkurtër por njaft informues dhe promovues për Kosovën. Dokumentarë tjerë do të bëhen edhe më tutje duke fokusuar objekte të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Kosovës. Një kohë Qendra Frankofone e Prishtinës ka bashkëpunuar në mbajtjen e kurseve përmes këtij kanali televiziv. Përndryshe Pjatforma IPKO dhe Kujtesa ka në vete TV5 Monde. Kemi bërë bisedat preliminare me drejtuesit e televizionit publik të Kosovës RTK për iniciimin e bashkëpunimit të tyre me TV5 monde.

Universitetin Senghor – Universitetet publike dhe kolegjet private të Kosovës akoma nuk kanë bashkëpunime konkrete me Universitetin Senghor, por në vitin 2023 një diplomat i ri kosovar ka marrë pjesë në trajnimin dyjavor të mbajtur në Alexandri, e sigurisht se edhe në seminarin e vitit 2024 Kosova do të marrë pjesë. Gjithsesi se do të vëmë kontakte nëpërmjet UP-së, përkatësisht prorektorese për marrëdhënie ndërkombëtare, që përmes programit ERASMUS ose përmes ndonjë mundësie tjetër të iniciohen lidhjet dhe bashkëpunimi akademik me Universitetin Senghor. Janë zhvilluar bisedat preliminare me tri universitete të Kosovës në lidhje me iniciimin e bashkëpunimit me Universitetin Senghor të Aleksandrisë dhe ekziston disponim pozitiv të përfaqësuesit e këtyre universiteteve. Mbetet të zhvillohen kontaktet edhe me Universitetin Senghor. Gjatë Konferencës Ministeriale të Frankofonisë në Yaounde (3-5 nëntor 2023) është vënë kontakti me përfaqësuesit e Universitetit në fjalë. Programi i ri Master, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës: Të Drejtat e Njeriut, e Drejta Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësia Tranzicionale, është rast i mirë për të filluar me bashkëpunim.

Bashkëpunimi me Shoqatën Ndërkombëtare të Komunave Frankofone (AIMF) - Deri në vitin 2023 komunat e Kosovës, përveç ndonjë binjakëzimi dhe bashkëpunimi me komunat e vendeve frankofone, nuk kanë pasur bashkëpunim me AIMF. Në vitin 2023 disa komuna të Kosovës, përfshirë edhe kryeqytetin Prishtinën kanë shprehur interesim për tu bërë pjesë e AIMF. Interesimin për këtë e ka shprehur komuna e Gjakovës, e cila është e binjakëzuar me komunën Lodève të Francës, prej kohës kur poeti ynë nacional Ali Podrimja ka ndërruar jetë atje. Kryetari i Gjakovës, z. Ardian Gjini ka shprehur vullnetin e tij për nisjen e procedurës për anëtarësim në AIMF, për emërtimin e ndonjë rruge, përkatësisht sheshi të qytetit me emra personalitetesh frankofone, e sidomos ka shprehur interesim për bashkëpunim kulturor me Francën. Duke u njoftuar me projektin “Rekujem për Ali Podrimjen”, që është mbajtur në Paris, në dhjetor të vitit 2023, ai ka shprehur dëshirën që aktiviteti i njëjtë kulturor të mbahet edhe në Gjakovë, ku do të mund t’i shtohet edhe ndonjë pikë muzikore nga Orkestra Simfonike e Gjakovës, institucion tashmë i formuar rishtas në këtë qytet me traditë të njohur muzikore dhe përgjithësisht kulturore. Në të vërtetë, autorët e projektit “Requiem pour Ali” i cili tashmë me 2 dhjetor 2023 u mbajt në Kishën St. Bernard në Paris, e kanë në plan që Requiemin ta shfaqin edhe në Kosovë, në qytetet: Gjakovë, Rahovec dhe në Prishtinë.

Interesimin për tu bërë pjesë e AIMF ka shprehur edhe kryeqyteti i Kosovës – Prishtina. Nën kryetari i Prishtinës po ashtu ka shprehur gatishmërinë për emëruar rrugë të reja me emra të personalitetesh frankofone, edhe pse disa rrugë të Prishtinës tashmë janë të emërtuara me emra personalitetesh franceze, si: Victor Hugo, René Descartes dhe Charles de Gaulle etj. Komuna e Prishtinës bashkëpunon me disa qytete në veri të Francës, si: Lille, Amiens, Dunkerque etj. Nën kryetari i Prishtinës ka shprehur vullnet edhe për binjakëzim me komunat franceze. Sa i përket bashkëpunimit kulturor, ka mundësi bashkëpunimi në kuadër të festivaleve të filmit dhe të muzikës. Prishtina mund të kontribuojë shumë në promovimin e kulturës

frankofone. Përveç kësaj, Prishtina mund të kontribuoj edhe në mësimin e gjuhës frënge duke organizuar aktivitete ekstrakurrikulare për nxënës të shkollave që e kanë zgjedhur gjuhën frënge si gjuhë mësimore. Nënkrjetari ka shprehur interesimin për sigurimin e stafit frankofon në administratën komunale, ose edhe për krijimin e mundësive për ndjekjen e kursit të frëngjishtes për anëtarë të stafit komunal.

Pjesë e AIMF tash e tutje është Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKM). Më 16 nëntor 2023, Asociacioni i Komunave të Kosovës ka pranuar letrën e konfirmimit të aderimit të AKK në AIMF, e cila ka ndodhur në Kongresin e Asamblesë Gjenerale të AIMF-it të mbajtur në Cotonou të Beninit, më 13 tetor 2023. Duke qenë një asociacion që përbëhet prej 35 komunave kosovare, anëtarësimi i tij në AIMF do të ketë rëndësi të veçantë për promovimin e gjuhës frënge dhe kulturës frankofone në komunat e Kosovës dhe për bashkëpunimin e tij me asociacione tjera nacionale që janë anëtare të AIMF, si edhe për të marrur pjesë në projektet e rëndësishme që i zhvillon AIMF.

Konferenca e Ministrave të Arsimit Kombëtar (Confémen) - Kosova ka marrur pjesë për herë të parë në takimin e Këshillit Konsultativ Rajonal të Qendrës Rajonale të Frankofonisë për Evropën Qendrore dhe Lindore - CREFECO si anëtare e asociuar e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë, i cili është mbajtur në Sofje, Bullgari më 23-24 shkurt 2023.

Duhet nënvizuar faktin që pjesëmarrja e Kosovës në atë takim u çmua dhe u pa si tregues i përkushtimit institucional ndaj promovimit të gjuhës dhe kulturës frënge në Kosovë. Dhe në të njëjtën kohë, është përmbushje e obligimeve që parashihet memorandumit i partneritetit i nëshkruar nga MASHTI me Frankofoninë. Po ashtu, përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse në takim shprehën gatishmërinë për mbështetjen e përfshirjes së Kosovës në aktivitete të tilla drejt anëtarësimit të plotë në ONF. Aktualisht MASHTI ka caktuar Prof Nerimane Kamberin – profesore e Letërsisë frënge në Departamentin e Gjuhës Frënge dhe Kryetare e Shoqatës së Mësimdhënësve të Frëngjishtes, për ta përfaqësuar Kosovën në CREFECO. Po ashtu, në atë takim u përsëriten angazhimet e MASHTI-it për të garantuar që çdo shkollë të ketë në dispozicion një mësues të frëngjishtes me qëllim që nxënësit të kenë mundësinë e zgjedhjes së frëngjishtes si gjuhë opcionale. Po ashtu u rriheksua si e rëndësishme së veçantë mësimi i frëngjishtes si gjuhë profesionale në shkollat e mesme të bujqësisë, turizmit, tekstilit etj.

Bashkëpunimi me Konferencën e Ministrave të Rinisë dhe Sportit (Confejes) - Kosova akoma nuk është bërë pjesë e Confejes, edhe pse në fushën e rinisë dhe sportit ka shënuar arritje në aktivitete sportive dhe vlera të rëndësishme që lidhen me Frankofoninë. Deri tash dy herë ka marrë pjesë në Lojërat e Frankofonisë, dhe siç e kemi cekur më lartë, gjithsej ka fituar 6 medalje, tri prej të cilave të arta. Të rinjtë kosovarë e përbëjnë pjesën dominante të popullatës së Kosovës dhe në përgjithësi shquhen për arritje në fushën e sportit, muzikës, filmit, por edhe arteve pamore. Duke patur parasysh aktivizmin rinor në Kosovë, arritjet e të rinjëve në fushën e sportit dhe kulturës, nevojën për t'i mbështetur me projekte zhvillimore, orientimin e të rinjëve drejt vlerave të demokracisë dhe të frankofonisë, Kosova është e interesuar të bëhet pjesë e CONFEJES dhe kërkesën për këtë do ta bëjë në një nga CMJ-të (Konferenca e Ministrave të Rinisë dhe Sportit) e ardhshme, sapo të bëhet anëtar me të drejta të plota në ONF.

5. Shteti ose qeveria që aplikon për një modifikim të statusit duhet të paraqesë rezultatet e pjesëmarrjes së saj në instanca:

Prej herës së fundit kur është bërë avansimi i statusit të Kosovës në ONF, nga vëzhgues në anëtar të asociuar, Kosova ka marrë pjesë rregullisht në instancat e Frankofonisë. Në Samitin

e Jerevanit (2018) ka marrë pjesë ish-Presidenti i Kosovës z. Hashim Thaqi, kurse në Samitin e Djerbas (2022) ka marrë pjesë Presidentja Znj. Vjosa Osmani Sadriu. Edhe në instancat tjera CMF dhe CPF ka patur pjesëmarrje të rregullt dhe aktive. Pjesëmarrje të rregullt dhe aktive ka patur edhe nëpër mbledhjet e komisioneve dhe komiteteve të ndryshme të ONF-së, si Komisioni për Përgaditjen e dokumentave të Samitit, Komisioni Politik, Komisioni i Programatik etj.

Në samitin e Djerbas në Tunizi, Kosova, veç tjerash ka marrë pjesë në sesionin plenar ku ka paraqitur fjalën e vet në dy tryezat e rrumbullakta: e para, "Dixhitalja si mjet parësor i Frankofonisë" dhe e dyta, "Gratë dhe të rinjtë synim prioritar i Frankofonisë". Në tryezën për dixhitalizimin, Presidentja e Kosovës, si folëse në këtë sesion, theksoi rolin e dixhitales në ndërlidhjen dhe komunikimin ndërnjerëzor, arritjet e Kosovës në fushën e dixhitalizimit, mbidueshmërinë e Kosovës me internet, pjesëmarrjen e vajzave në studimet mbi teknologjinë informative dhe rëndësinë e kontrollimit dhe evitimit të përmbajtjeve të dëmshme në internet. Të nesërmen Përfaqësuesi Personal i Presidentes së Republikës në OIF ka folur në tryezën "Gratë dhe të rinjtë synim prioritar i Frankofonisë" ku ka theksuar se barazia mes burrave dhe grave është kusht i zhvillimit të qëndrueshëm për një shoqëri. U theksua fakti që Kosova ka ndërmarrë masa ligjore duke harmonizuar ligje të rëndësishme me Ligjin për barazinë gjinore. Pastaj ka përmendur kuotën gjinore e cila garanton së paku 30% të ulëseve në Kuvend të jenë të rezervuara për gratë. Këtu e ka përmendur edhe faktin se Kosova para pak kohe ishte nikoqire e Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, ku kanë marrë pjesë mbi 500 veta nga 33 vende të botës. Në të dy tryezat e Samitit të Djerbas, Kosova ishte aktive edhe gjatë pjesës së diskutimit.

Kosova ka marrë pjesë në sesionin e jashtëzakonshëm të CPF-së në mars të vitit 2023, pastaj në sesionin e rregullt të CPF në qershor të vitit 2023. Ka marrë pjesë gjithshatu në punimet e Komisionit Politik, Komisionit Ekonomik, Administrativ dhe Financiar, Komisionit Programatik dhe do të vazhdojë të merr pjesë në mënyrë të rregullt dhe aktive edhe në të ardhmen në punën e komiteteve, komisioneve, gupeve të punës dhe në të gjitha sesionet e instancave të Frankofonisë. Më 3-5 nëntor 2023, në Yaounde të Kamerunit është mbajtur sesioni 44 i Konferencës Ministrore të Frankofonisë (CMF) ku ka marrë pjesë Ministra e Punëve të Jashtme dhe Diasporës znj. Donika Gërvalla Schëarz. Më 3 nëntor është mbajtur Këshilli i Përhershëm i Frankofonisë ku ka marrë pjesë Përfaqësuesi Personal i Presidentes së Republikës në ONF, ku gjatë sesionit janë miratuar dokumente të rëndësishme të Frankofonisë sa i përket aspektit administrativ financiar si edhe janë bërë përgatitjet e draftit të rezolutës së Frankofonisë e cila është miratuar gjatë sesionit 44 të CMF.

Duke marrë pjesë në instancat e Frankofonisë, sidomos në CPF, CMF dhe Samit, Kosova ka përkrahur të gjitha deklaratat dhe dokumentet e rëndësishme të këtyre instancave. Në këtë kontekst, ka përkrahur Deklaratën e Samitit të Djerbas, Projekt-rezolutën për situatën e krizës, daljes nga kriza dhe ruajtjen e paqes në vendet frankofone, Deklaratën për Gjuhën frënge në diversitetin lingvistik të Frankofonisë, Projekt kornizën Strategjike të Frankofonisë 2023-2030, si edhe Rregulloren e procedurave për aderimin dhe modifikimin e statusit të Shtetit ose qeverisë në ONF si dhe së fundi Rezolutën e Yaoundes "La bonne gouvernance au service de la stabilité politique, de la prospérité économique et du rayonnement culturel dans l'espace francophone", shkalla e kontributeve statutare si dhe regjimi i sanksioneve në rast të mospagesës së kontributeve statutare, dokumente të aprovuara në sesionin e 44-të të CMF, të mbajtur në Yaoundé, më 4 dhe 5 nëntor 2023. Gjatë CPF të jashtëzakonshëm të datës 8 shkurt 2024, Kosova ka mbështetur projekt rezolutat e parashtruara mbi Gabonin dhe Guinenë, përmes të cilave është kërkuar ulje e tensioneve dhe një tranzicion paqësor.

II. KRITERET DHE TË DHËNAT QË LIDHEN ME PËRDORIMIN DHE PROMOVIMIN E GJUHËS FRËNGE DHE DIVERSITETIT KULTUROR DHE GJUHËSOR

1. Përqindja e frankofonëve në gjirin e popullsisë

- Kur kërkoni një ndryshim të statusit (numri dhe % + viti referencë):

Sipas një vlerësimi mbi numrin e atyre që mësojnë frëngjisht, familjeve frankofone dhe pranisë së komunitetit frankofon, përqindja e frankofonëve në Kosovë është më pak se 5% e popullsisë së përgjithshme.

Duke e patur parasysh se gjuha frënge është mësuar në shkollat e Kosovës që nga vitet '50-ta të shekullit 20-të, dhe atëherë ka qenë gjuhë obligative, kurse për gati dy dekada është mësuar nga rreth 80% e nxënësve, atëherë mund të themi se grupmoshat e shtyera të popullsisë kanë njohuri bazike të kësaj gjuhe.

Poashtu, duke patur parasysh se Kosova ka një diasporë të madhe në vendet frankofone, sidomos në Zvicër, ku jetojnë rreth 300 mijë qytetarë me origjinë nga Kosova, poashtu edhe në Belgjikë, Francë, Luxemburg, Kanada, si dhe duke patur parasysh se ka shumë qytetarë dhe familje kosovare që janë kthyer nga diaspora, qoftë për shkaqe pensionimi, qoftë për shkaqe investimi, apo edhe për arsye tjera, atëherë mund të themi se përqindja e popullatës frankofone, ashtu siç është përmendur në dosjet paraprake kur është pranuar Kosova si vend observues në ONF, si dhe kur ka aplikuar për avansim në anëtar të asociuar, sillet rreth 30%.

Dhjetë (10) vjet para datës së kësaj kërkese (numri dhe % + viti referencë):

Sipas një vlerësimi mbi numrin e atyre që mësojnë frëngjisht, familjeve frankofone dhe të pranisë së komunitetit frankofon, përqindja e frankofonëve në Kosovë para 10 viteve ka qenë nën 30% të popullsisë së vendit .

2. Përqindja e folësve të gjuhëve të tjera

- Gjuha 1 - shqipe
- Gjuha 2 - serbe
- Gjuha 3 – turke
- Gjuha 4-rome
- Gjuha5-boshnjake
- Gjuha 6-angleze
- Gjuha 7-gjermane

Gjuha shqipe është gjuhë amtare e 95,9% e banorëve të Kosovës.

Sipas Kushtetutës së republikës së Kosovës, përveç gjuhës shqipe, gjuha serbe është gjithashtu gjuhë zyrtare, duke qenë gjuhë amtare e komunitetit serb që përfaqëson 4% të popullsisë së Kosovës.

Të dyja gjuhët kanë status të njëjtë në institucionet e Kosovës. Kushtetuta parasheh që gjuha turke, gjuha boshnjake dhe gjuha rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal dhe do të përdoren zyrtarisht në të gjitha nivelet në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Duke pasur parasysh faktin që gjuha angleze fillon të mësohet që nga niveli fillestar i klasëve/klasa përgatitore, klasa 1 dhe 2) dhe vazhdon deri në vitin e fundit të shkollës së mesme, anglishtja mbetet një gjuhë e huaj e kuptuar dhe e folur nga një pjesë shumë e rëndësishme e popullsisë së vendit. Për më tepër, duke pasur parasysh numrin e madh të diasporës kosovare që jetojnë në vendet gjermanofolëse, veçanërisht në Gjermani, ku jetojnë deri në 500 mijë shtetas të Kosovës, si dhe në Zvicër, Austri, si dhe duke pasur parasysh numrin e madh të qytetarëve dhe familjeve kosovare të kthyer nga diaspora, qoftë për shkaqe të pensionimit, investimeve ose tjera, mund të konstatojmë që gjermanishtja është një gjuhë e huaj e cila kuptohet dhe flitet nga një pjesë e rëndësishme e popullsisë së vendit.

Në shkollat fillore të Kosovës në vitet '50 frëngjishtja është mësuar nga 83% e nxënësve, rusishtja 13% kurse gjermanishtja me vetëm 4%. Në vitet '60 frëngjishtja është mësuar nga 63% e nxënësve të këtij niveli, kurse në vitet e 70-ta ka rënë në 30% si rezultat i ngritjes rapide të anglishtes si gjuhë e huaj. Në vitet '90 frëngjishtja është mësuar në 105 shkolla fillore, kurse anglishtja në 320 shkolla fillore.

Në shkollat e mesme të Kosovës në vitet '50 frëngjishtja është mësuar nga 68% e nxënësve, Gjatë viteve '60 është mësuar nga 65% të nxënësve të shkollës së mesme, kurse gjatë viteve '70 nga 30% e nxënësve. Gjatë viteve '80 frëngjishtja është mësuar nga 30% e nxënësve të shkollës së mesme, kurse anglishtja, rusishtja dhe gjermanishtja nga 70% e nxënësve të shkollës së mesme.

Mësimi i frëngjishtes ka pësuar një rënie të madhe gjatë viteve '90 si rezultat i zhvillimeve dramatike në këtë pjesë të Evropës. Pas çlirimit të Kosovës dhe vendosjen e saj nën administrimin ndërkombëtar, frëngjishtja ia ka lëshuar pak vendin anglishtes. Në arsimin paramuniversitar ajo ka mbetur si gjuhë e huaj duke filluar nga klasa e 6-të. Gjatë viteve 2000, 6328 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme kanë mësuar frëngjisht.

Sipas të dhënave të MASHTI në vitin 2012, 14 400 nxënës, të vendosur në 31 institucione shkollore kanë mësuar frëngjisht me 69 profesorë të frëngjishtës aktiv.

Prej vitit 2015 frëngjishtja është si gjuhë e dytë e huaj që nga klasa e 6-të me qëllim që të zgjerohet mësimi i kësaj gjuhe. Sipas vendimeve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vitet 2018, 2019, 2020, për zbatimin e planit dhe programit lëndor, dhe sipas Kurrikulës Bërthamë (KB) për arsimin e mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë, gjuha frënge ka vazhduar të mësohet si gjuhë e dytë e huaj, me mundësi zgjedhjeje.

Gjatë vitit shkollor 2022-2023 në shkollimin parauniversitar publik dhe privat kanë mësuar frëngjisht 13.313 nxënës, kurse në vitin shkollor 2023/2024 janë duke mësuar frëngjisht 11.485 nxënës.

3. Statusi dhe vendi i frëngjishtes

- Statusi i frëngjishtes (gjuhë zyrtare ose bashkëzyrtare, kombëtare, mësimore, e huaj):

Republika e Kosovës është shtet multi-etnik dhe multikulturor me një traditë të pasur dhe plurale gjuhësore. Ajo shquhet me politikë gjuhësore mjaft liberale ku përmes dokumenteve bazike jepen garancione të larta kushtetuese dhe ligjore për përdorimin e gjuhëve të ndryshme si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal. Bashkëjetesa dhe përdorimi i gjuhëve të ndryshme si në institucione ashtu edhe në jetën e përditshme përbën një pasuri kulturore për Kosovën. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton që përveç gjuhës shqipe që është gjuhë e shumicës së popullsisë së Kosovës, gjuhë zyrtare është edhe gjuha serbe e cila është gjuhë e komunitetit serb që përbën 4-5% të popullsisë së vendit. Që të dyja gjuhët kanë statusin e njëjtit në institucionet e Kosovës. Neni 5.2 i Kushtetutës përcakton që gjuha turke, boshnjake dhe ajo romë kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Gjuha frënge nuk është gjuhë zyrtare por e ka statusin e gjuhës së huaj e cila mësohet në shkolla duke filluar nga klasa e 6-të e shkollës fillore. Ajo mësohet paralelisht me gjuhën gjermane si gjuhë e dytë e huaj në shkollat publike. Gjuha frënge përdoret në faqe zyrtare të disa institucioneve të Kosovës si Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese, e pritet që së shpejti të fillojë të përdoret edhe nëpër disa institucione tjera. Gjuha frënge do të përdoret në faqet zyrtare të komunave të Kosovës që do të bëhen anëtare të AIMF.

Vendosja dhe fuqizimi i marrëdhënieve mes institucioneve arsimore të Kosovës dhe atyre të vendeve frankofone ka rëndësi të veçantë për arsye se ka impakt të gjerë dhe krijon kushte për mundësitë e mëposhtme (dhe jo vetëm):

- Shkëmbimi i përvojave ndër-institucionale dhe akademike, duke mësuar nga praktikatat e mira të vendeve më të zhvilluara;
- Krijimi i hapësirave dhe mundësive për staf akademik dhe studentë për të zgjeruar njohuritë, për të krijuar përvoja të reja, dhe për të rrjetëzuar me kolegë dhe bashkëmohatarë në aspektin profesional dhe personal;
- Evidentimi në nivel ndërkombëtar i dijeve dhe shkathtësive të studentëve kosovarë, duke promovuar kështu Republikën e Kosovës dhe vullnetin për të lidhur ura bashkëpunimi;
- Qartësimi i pozicionit të Kosovës në kuadër të orientimeve konkrete drejt evropianizimit dhe ndërkombëtarizimit të vendit në tërësi, dhe të arsimit të veçanti.

Në lidhje me organet frankofone të lartcekura, me disa prej tyre ekziston bashkëpunimi, ndërsa me disa të tjera ende nuk ka bashkëpunim.

Gjatë viteve 2021-2022, institucionet e arsimit të lartë (IAL) në Kosovë dhe zyra e Erasmus+ në Kosovë kanë intensifikuar dukshëm bashkëpunimin me Agjencinë Nacionale Erasmus në Francë dhe me Ambasadën e Francës në Kosovë.

Ndërkohë që në vitin 2021 Kosova ka qenë e fundit për bashkëpunim nga 4 vendet e Ballkanit Perëndimor (Kosova, Mali i Zi, Shqipëria, Bosnje & Hercegovina), në vitin 2022 ka dalë në vendin e parafundit. Franca është në top 5 vendet për mobilitet përmes Erasmus në Kosovë, duke qenë prioritet i zyrës së Erasmus në Kosovë, dhe bazuar të bashkëpunimin e ngushtë me Ambasadën franceze në Prishtinë dhe me Agjencinë Erasmus+ në Francë

(<https://erasmuspluskosovo.org/ep-content/uploads/2023/03/ANNUAL-STATISTICS-REPORT-2022.pdf>).

Statusi i bashkëpunimit të institucioneve arsimore të Kosovës me disa nga organet e lartcekura:

Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF)

Në Universitetin e Prishtinës ekziston Qendra Frankofone. Më poshtë shtjellohen aspektet e bashkëpunimit me AUF që trajton kjo qendër:

- *Shkëmbimet e stafit dhe studentëve përmes Erasmus*
- *Fakulteti Juridik i UP me Universitetin e Paris Nanterre*
- *Fakulteti Ekonomik me Universitetin e Nice*
- *Fakulteti Filologjik, Departamenti i Gjuhës Frënge, me Universitetin Caen*

Sa u përket projekteve, Qendra Frankofone ka bashkëpunim me AUF në kuadër të trajnimeve të mësimdhënësve për metoda dixhitale, dhe aktivitete me studentë.

Në proces:

- *Përmes Erasmus: UP me Universitetin e Gjenevës*
- *Anëtarësimi i universiteteve kosovare në AUF*
- *Krijimi i klubit për të rinjtë frankofonë (CLEF)*
- *Marrëveshje bashkëpunimi mes Qendrës Frankofone dhe komunave*
- *Marrëveshje bashkëpunimi mes gastronomisë franceze dhe asaj kosovare me studentët e frëngjishtes*

Në vitin 2022, mes MASHTI-t dhe Ambasadës së Francës në Kosovë është nënshkruar Marrëveshja për Bashkëfinancimin e Bursave të Arsimit të Lartë në Nivelin Master (marrëveshja e bashkangjitur). Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, në vitin akademik 2022-2023 kanë nisur studimet në universitete franceze 4 studente, dhe në vitin akademik 2023-2024 ato janë duke vazhduar vitin e dytë të studimeve.

- **Teksti(et) legjislativ (e) ose rregulloret që përcaktojnë këtë status (titulli i tekstit dhe dispozita të rëndësishme: Klikoni këtu për të futur tekstin.**

Në përputhje me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Kosovës, gjuha amtare mësohet nëpër të gjitha shkallët e kurrikulës që nga klasa përgatitore e deri në klasën 12. Gjuha shqipe për nxënësit e komuniteteve joshqiptare mësohet që nga shkalla e dytë e kurrikulës (klasa e 3-të). Gjuha angleze fillon të mësohet nga shkalla e parë (klasa përgatitore, klasa e parë dhe e dytë) dhe mësohet deri në klasën e fundit të shkollës së mesme të lartë. Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (nga klasa e gjashtë). Si gjuhë e dytë mund të jetë: njëra nga gjuhët e huaja si: gjuha gjermane, gjuha frënge, gjuha italiane etj. dhe/ose gjuhët e mjedisit (gjuha serbe, boshnjake, turke) sipas zgjedhjes së lirë të nxënësve.

Gjuhët e tjera fillojnë të mësohen në shkallën e pestë të kurrikulës dmth në shkollën e mesme të lartë (gjimnaze dhe shkolla profesionale) si pjesë e kurrikulës me zgjedhje. Në këtë grup mund të përfshihet gjuha latine, gjuha e vjetër greke apo ndonjë gjuhë tjetër. Dhe këto lëndë mund të mësohen si të detyrueshme në gjimnazet e specializuara dhe në shkollat profesionale. (ANEX 6.

Tekstet shkollore për mësimin e Gjuhës frënge përcaktohen mbi bazën e Vendimit Nr. 383/01B datë 29/06/2018 nga MASHTI.

- *MERCI 1 (niveli A.1.1.1) për klasën VI,*

- Metoda INTERACTIONS I (niveli A 1.1) për klasën X, për mësimin e gjuhës frënge si gjuhë e dytë për klasat VI dhe X. (ANEX 7).

- Nëse është e aplikueshme, ndryshimet e fundit në kualifikimin e statusit të njohur të gjuhës frënge:

Nuk ka pasur ndryshime deri tash.

- Kur nuk është gjuhë zyrtare, jepni tregues për vendin e frëngjishtes në shtet ose qeveri në krahasim me gjuhët e tjera (faqet e internetit institucionale, signalistika, reklamat publike dhe komerciale, etj.):

Disa institucione si Kuvendi i Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës në faqen e tyre zyrtare në internet publikojnë informacione dhe materiale tjera edhe në gjuhën frënge. Këtë e bën edhe Grupi Koha që është njëra prej medimeve më të njohura në Kosovë. Institucione tjera si Presidenca, Qeveria, ASHAK dhe UP pritet ta bëjnë pas bisedave dhe diskutimeve që kemi patur lidhur me këtë. Sa i përket signalistikës, disa rrugë nëpër komunat e Kosovës janë emëruar me emra personalitetesh frankofone. Kështu në Prishtinë ekziston rruga “Charles de Gaulle”, “Rene Descartes”, pastaj rruga “Victor Hugo”. Me këtë të fundit është emëruar edhe një rrugë në Ferizaj, por edhe një tjetër në Gjilan. Në Prizren një rrugë quhet “Louis Pasteur”. Në Viti ekziston Sheshi “Calmy-Rey” – ish-presidente e Zvicrës. Veç personaliteteve, në Kosovë hasen edhe rrugë me emërtime të qyteteve frankofone, sikurse në Mitrovicë rruga “Parisi”, në Shtimje rruga “Rambouillet” dhe “Bruxelles”. Një kamp ushtarak afër Vushtrrisë mban emrin e ushtarakut të njohur francez Marchal de Latre. Disa rubrika nëpër radiot dhe TV-të kosovare, po ashtu mbajnë emërtime frankofone, si “Imazh”, “Rendez-vous”, “Voyage”, “Privé”, “Interaktiv”, “Metropol”, “Retro”, “Canapé” etj.

- **Strukturat kombëtare të dedikuara për politikën gjuhësore** (specifikoni mandatin e tyre, kompetencat e tyre, mjetet e tyre të veprimit dhe bëni një bilanc shumë sintetik të veprimeve të tyre të rëndësishme):

Zyra e Komisionerit për Gjuhët

Është strukturë e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe ka për qëllim monitorimin e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Këto janë disa prej veprimeve që i kryen kjo zyre:

- *Ndërton një njedis institucional që respekton detyrimet kushtetuese dhe ligjore, mbron, promovon, ruan dhe zbaton të drejtat gjuhësore të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.*
- *Monitoron përputhshmërinë me Ligjin nga ana e çdo institucioni nën juridiksionin e saj;*
- *Merr të gjitha masat e nevojshme nën autoritetin e vet, përfshirë ato përmes ndërmjetësimit, për të siguruar përputhshmërinë me Ligjin nga të gjitha institucionet nën juridiksionin e saj;*
- *Shqyrton dhe bën rekomandime përkitazi me rregulloret apo udhëzimet administrative në kuadër të Ligjit, sa i përket përputhshmërisë dhe konsistencës së cilitdo akt legjislativ, rregullorë apo udhëzimi administrativ me Ligjin;*
- *Kryen hetime, qoftë me iniciativën e vet apo në bazë të ankesave të bëra nga një person juridik apo fizik sa i përket dështimit të ndonjë institucioni nën juridiksionin e saj për respektimin e Ligjit apo me ndonjë akt tjetër ligjor sa i përket statusit apo*

përdorimit të gjuhëve zyrtare apo gjuhëve tjera të komuniteteve gjuha e të cilave nuk është gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës;

- Ofron, kur duhet, këshilla apo ndihmë për publikun në lidhje me të drejtat e tyre sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve;
- Ofron, kur duhet, këshilla apo ndihmë për institucionet nën juridiksionin e saj sa i përket obligimeve të tyre sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve;
- Sipas nevojës, në rast se një nuk iu përmbahet apo refuzon t'iu përmbahet kërkesave të Zyrës apo e pengon Zyrën në kryerjen e detyrave të saj, apo kur natyra e shkeljes lejon një masë të tillë, Zyra mund të nisë procedura juridike apo disiplinore përmes autoriteteve përkatëse ndaj personit apo organizatës përgjegjës/e për shkeljen. (ANEX 8).

Departamenti i Gjuhës frënge – është themeluar në vitin 1973/74 në kuadër të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës dhe tash funksionon në kuadër të Fakultetit Filologjisë. Ky departament ka dhënë shumë kuadra mësimit të gjuhës frënge nëpër shkollat dhe universitetet e Kosovës. Themeluesit e tij dhe stafi që ka punuar aty kanë kontribuar shumë në përhapjen e frëngjishtes në Kosovë dhe promovimin e kulturës frankofone. Në kuadër të Fakultetit Filologjik është edhe Instituti i Gjuhëve dhe aty po ashtu mësohet gjuha frënge.

4. Mësimdhënia dhe mësimnxënia në sektorin publik dhe privat

- Nëse frëngjishtja është një gjuhë mësimore (vetëm ose me një ose më shumë gjuhë):
 - Numri total i nxënësve dhe orët e mësimit në frëngjisht në nivelin fillor dhe të mesëm:

Komuna	Kl. 6	Kl. 7	Kl. 8	Kl. 9	Kl. 10	Kl. 11	Kl. 12	Gjithsej
Gjakovë	0	0	0	0	204	390	375	969
Glllogoc	0	0	0	0	142	142	130	414
Gjilan	0	0	0	0	376	436	572	1384
Dragash	0	0	0	0	9	22	55	86
Istog	0	0	0	0	202	0	222	424
Klinë	10	31	47	13	0	0	0	101
Kamenicë	0	0	0	0	35	42	66	143
Mitrovicë - jug	0	0	0	0	163	227	164	554
Lipjan	0	0	12	0	253	195	241	701
Obiliq	23	21	15	20	102	80	107	368
Pejë	0	0	0	22	511	497	227	1257
Podujevë	34	39	21	61	372	255	264	1046
Prishtinë	21	0	0	0	166	118	352	657
Prizren	23	0	31	0	0	0	0	54
Skënderaj	0	0	0	0	0	27	0	27
Shtime	39	111	284	150	66	122	98	870
Shtërpçë	16	13	16	15	25	32	32	149
Suharekë	0	0	0	0	124	129	135	388

Perizaj	0	0	0	0	159	271	210	640
Viti	0	0	0	0	253	108	199	560
Vushtrri	246	239	277	240	238	261	266	1767
Malishevë	0	0	0	0	127	172	190	489
Hani i Elezit	0	0	0	0	119	54	92	265
Gjithsej	412	454	703	521	3646	3580	3997	13313

Në shkollën fillore të mesme të ulët private *Ecole Française Internationale de Prishtina*, me seli në Prishtinë, procesi edukativo-arsimor zhvillohet në gjuhën frënge. Kjo shkollë është e licencuar nga Komisioni për licencim dhe rilicencim në MASHT.

Shkolla franceze *Ecole Française Internationale de Prishtina* është hapur në shtator 2017. Fillimisht, në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët ka pasur 17 nxënës. Gjatë viteve numri i nxënësve është rritur në mënyrë progresive, si vijon:

2018-2019	25 nxënës
2019-2020	28 nxënës
2020-2021	28 nxënës
2021-2021	30 nxënës
2021-2022	33 nxënës
2022-2023	36 nxënës
2023-2024	61 nxënës (Çerdhe: 3 nxënës, Kopsht: 11 nxënës, Klasa I: 8 nxënës, Klasa II: 5 nxënës, Klasa III: 10 nxënës; Klasa IV: 5 nxënës; Klasa V: 6 nxënës; Klasa VI: 5 nxënës; Klasa VII: 5 nxënës; Klasa VIII: 1 nxënës; Klasa IX: 2 nxënës. Në nëntor 2023 ka pasur tre regjistrime të reja, dy nga Franca dhe një regjistrim dy-mujor (nëntor-dhjetor) nga Kosova.

Orët e mësimi në gjuhën frënge janë:

Klasat I, II, kanë 26 orë mësimi në javë, ku 22 orë të mësimdhënies mbahen në gjuhën frënge. Klasat III, IV, V kanë 26 orë mësimi, ku 20 orë të mësimdhënies mbahen në gjuhën frënge. Shkolla e mesme e ulët brenda javës ka 28 orë mësimi, si vijon:
 Klasa VI - mban 22 orë në gjuhën frënge.
 Klasa VII - mban 20 orë në gjuhën frënge.
 Klasa VIII - mban 20 orë në gjuhën frënge.
 Klasa IX - mban 20 orë në gjuhën frënge.

Gjuhët e huaja në institucionet parauniversitare private:

<i>Insitucionet Arsimore parauniversitar e Private</i>	<i>Gjuha Frënge</i>	<i>Gjuha Angleze</i>	<i>Gjuha Gjermane</i>	<i>Gjuha Italiane</i>	<i>Gjuha turke</i>	<i>Nr. i orëve</i>
1. Prishtina High School	2022/2023 3 2 nxënës (online)		2022/2023 16 nxënës 2023/2024 10 nxënës			

	french courses) 2023/2024 4 nxënës (online French courses)					
2.American School of Kosova			103 nxënës	46 nxënës		5 orë në javë
3.Kosovo Leadership Acaedemy			(klasa 7-12) 104 nxënës			Secila klasë një orë mësimore në javë
4.Akademia Ora		(klasa 1-9) 239 nxënës	(klasa 6-9) 96 nxënës			
5.Gjinnazi Cambridge-Pejë			(klasa 6-12) 99 nxënës			9 orë javë /3 orë plotësuese
6.Euro School		2022/2023 (klasa 10-12) 225 nxënës 2023/2024 23 nxënës	2022/2023 (klasa 10-12)155 nxënës 2023/2024 168 nxënës			Gjuhë angleze 1 orë në javë / Gjuhë Gjermane 2 orë në javë
7.Don Bosko-Gjilan		(klasa 6-9) 135 nxënës (klasa 10-12) 118 nxënës				(klasa 6-9) një orë mësimore në javë (klasa 10-12) Dy orë mësimore në javë
8.International Learning Group	2022/2023 3 Klasat 1-5 30 nxënës Klasat 6-11 15 nxënës 2023/2024 4 Klasat 1-5 34 nxënës	Në të gjitha klasët	2022/2023 Klasat 1-5 14 nxënës Klasat 5- 6 - 9 12 nxënës 2023/2024 Klasat 1-5 20 nxënës Klasat 6-10			Gjuhë gjermane/frënge Klasat 1-5 (3 orë në javë) Klasat 6-12 (4 orë në javë)

			17 nxënës			
9.Mehmet Akif Lipjan		Klasa 1-2 (1 orë mesimore) Klasan 3-11 (2 orë mesimore) Klasa 12 (1 orë mesimore)	Klasa 6 (2 orë mesimore) Klasa 7-8 (1 orë mesimore) Klasa 10-11 (2 orë mesimore)		Klasa 6-7-8-9 (1 orë mesimore) Klasa 10-11-12 (2 orë mesimore)	<i>Gjithësej 610 nxënës</i>
10.Mileniumi i tretë		2022/2023 Klasat 1-5 - 483 nxenes Klasat 6-9 - 261 nxenes Klasat 10-12 - 142 nxenes 2023/24: Klasat 1-5 - 527 nxenes Klasat 6-9 - 312 nxenes Klasat 10-12 - 157 nxenes	2022/2023 Klasat 1-5 - 483 nxenes Klasat 6-9 - 261 nxenes Klasat 10-12 - 142 nxenes 2023/24: Klasat 1-5 - 527 nxenes Klasat 6-9 - 312 nxenes Klasat 10-12 - 157 nxenes			<i><u>Klasat 1-5</u> (2 ore gj. angleze 1 ore) Gj.gjermane <u>Klasat 6-9</u> (5 ore gj. angleze 2 orë gj.gjermane) <u>Klasat 10-12</u> (5 ore gj. angleze 2 orë gj.gjermane)</i>
11.International School of Prishtina			2022/2023 Nxenes 324 2023/2024 Nxënës 373		2022/2023 3 Nxënës 324 2023/2024 4 Nxenes 373	<i>2022/23 7 orë gjuhë gjermane 17 orë gjuhë turke 2023/24 Gj.turke 18 ore Gj.gjermane 18 ore</i>
12.Viciana Med		Klasa 10 (70 nxënës)	Klasa 10 (35 nxënës)			<i>Gjuha angleze</i>

		Klasa 11 (70 nxënës) Klasa 12 (64 nxënës)	Klasa 11 (35 nxënës)			2 orë në javë Gjuha Gjermane 2 orë në javë
13.ISPE						Gjuhë Gjermane /Angleze Gjithësej 148 nxënës Konform Komrizez Kurrikulare te aprovuar nga MASHTI
14.UBT		201 Nxënës	186 Nxënës			1-2 orë në javë
15.Gjimnazi Britanik per Teknologji		Klasa 10/ 11/ 175 nxënës	Klasa 10/11/ 175nxën ës			2 orë gjuhë angleze 4 orë gjuhë gjermane 5 orë gjuhë gjermane
16.German School of Kosova		Klasët 1-9 44 nxënës	Klasët 1-9 44 nxënës			2 orë në javë
17.Loyola		Klasat 1-5 385 nxënës Klasat 6- 12 757 nxënës	Klasat 1-5 231 nxënës Klasat 6-12 757 nxënës			
18.International Maarif Schools of Kosova		Klasa 1-12 345 nxënës			Klasa 6- 12 215 nxënës	Gjuha Angleze gjithsej 35 orë mësimore Gjuha Turke

						gjithsej 16 orë mësimore
19.Gjimnazi Cambridge - Lipjan		1365 nxënës	324 nxënës			
20.British School of Kosova		1-12 1131	1-12 548			Gjuhë angleze 2-3-4-5 orë në javë Gjuhë gjermane 1-2 orë në javë
21.Zenit		Klasa 1-12 341 nxënës	Klasa 6-12			Gjuhë angleze komplet klasa 1-12 / 34 orë në javë Gjuhë gjermane komplet klasat 6-12 / 14 orë në javë

Numri i nxënësve në shkolla publike dhe private nga kl. 6-12 që mësojnë gjuhët e huaja nga viti shkollor 2014-2015 deri vitin shkollor 2023-2024:

Viti shkollor	Gjuhë frënge			Gjuhë gjermane		
	M	F	Gjithsej	M	F	Gjithsej
2014/15	8422	10609	19031	9102	9871	18973
2015/16	8819	11343	20162	10461	10999	21460
2016/17	8934	11813	20747	14778	16840	31618
2017/18	9619	13233	22852	19089	21605	40694
2018/19	9492	12889	22381	23036	24440	47476
2019/20	8271	10563	18834	28968	30304	59272
2020/21	7755	9691	17446	31383	32444	63827
2021/22	6967	8662	15629	31660	34544	66204
2022/23	5806	7387	13193	29426	31828	61254
2023/24	4932	6553	11485	29643	32811	62454

- Numri total i studentëve dhe orëve mësimore në gjuhë(t) tjera mësimore (duke dalluar kategoritë e mësimiit dygjuhësor: gjuhë kombëtare dhe frëngjisht (mësimi i parë) / “klasat dygjuhësore » Frëngjisht dhe gjuhë kombëtare): *Klikoni këtu për të futur tekstin.*

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në vitin akademik 2022/2023 numri i përgjithshëm i studentëve në institucionet e arsimit të lartë është 71.848. Gjuha shqipe është gjuhë e mësimiit në të gjitha institucionet publike, kurse gjuha angleze dhe gjermane është gjuhë e huaj në planprogramet mësimore, në disa si gjuhë të huaja obligative e në disa si gjuhë e huaj zgjedhore. Në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” përveç në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge/Fakulteti i Filologjisë, ku gjuha frënge është gjuhë studimore, ajo është gjuhë e dytë zgjedhore në shumicën e departamenteteve të Fakultetit të Filologjisë, dhe në Fakultetin Ekonomik dhe Juridik. Përveç programit të studimit në gjuhën shqipe, në studimet bachelor Universiteti publik “Ukshin Hoti” në Prizren ofron programe studimi edhe në gjuhën turke dhe boshjake.

Në shumicën e institucionet private të arsimit të lartë, gjuhë e mësimiit është gjuha shqipe. me përjashtim të disa kolegjeve private (RIT-kolegji Amerikan i Kosovës) në të cilat gjuha angleze është gjuhë e mësimiit. Në të gjitha institucionet tjera private gjuha angleze dhe gjermane janë si gjuhë të huaja zgjedhore, në disa gjuha angleze si gjuhë e huaj e detyrueshme, kurse gjuha frënge nuk është e paraparë as si gjuhë e huaj obligative dhe as zgjedhore.

- **Numri total i studentëve dhe orëve mësimore në frëngjisht në arsimin e lartë:**

Në institucionet e arsimit të lartë gjuha shqipe është gjuhë kryesore e mësimiit në të gjitha institucionet publike, si dhe në institucionet private të arsimit të lartë, me përjashtim të disa kolegjeve private, në të cilat gjuha angleze është gjuhë e mësimiit.

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” aktualisht ka 24.983 studentë, prej t[cilëve 7.988 meshkuj dhe 16.995 femra. Në kuadër të këtij institucioni publik të arsimit të lartë, i cili është më i madhi dhe më i vjetëri në vend, ekziston Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Frënge në UP, i cili në studimet BA prej vitit 2018-2023 ka pasur këtë numër të studentëve:

*Viti akademik 2018/2019 - 92 studentë,
Viti akademik 2019/2020 - 92 studentë,
Viti akademik 2020/2021 - 86 studentë,
Viti akademik 2021/2022 - 81 studentë,
Viti akademik 2022/2023 - 59 studentë,
Viti akademik 2023/2024 - 46 studentë.*

Kurse në studimet në programin Gjuhë dhe Letërsi frënge niveli MA ka pasur këtë numër të studentëve:

*Viti akademik 2019/20 - 11 studentë,
Viti akademik 2020/21 - 0 studentë,
Viti akademik 2021/22 - 21 studentë,
Viti akademik 2022/23 - 20 studentë,
Viti akademik 2023/24 - 9 (nëntë).*

Në institucionet tjera publike të arsimit të lartë numri i studentëve është si në vijim:

Në Universitetin publik “Kadri Zeka” në Gjilan aktualisht vijojnë studimet 6890 studentë (3735 femra dhe 3155 meshkuj) në nivel bachelor dhe nivelin master.

Në vitin akademik 2021/2022 kanë qenë 641 studentë.
Në vitin akademik 2022/2023 kanë qenë 602 studentë, kurse
Në vitin akademik 2023/2024 janë 520 studentë.

Mësimi mbahet në gjuhën shqipe. Në çdo vit akademik respektohet vendimi i MASHTI-it për pranimin e studentëve me mësim në gjuhët e komuniteteve tjera jo shqiptare, në kuotën prej 12 %, megjithatë nuk ka pasur kandidatë të paraqitur. Në plan programet mësimore të këtij universiteti publik aplikohen paralelisht si gjuhë të huaja: gjuha angleze dhe gjuha gjermane. Gjuha frënge nuk është pjesë përbërëse e plan programeve të këtij universiteti publik, sepse viteve të para kur është themeluar universiteti nuk ka pasur studentë të interesuar për të zgjedhur gjuhën frënge si gjuhë të huaj.

Në Universitetin publik « Isa Boletini » në Mitrovicë programet studimore janë në gjuhën shqipe.

Në vitin akademik 2021/2022, numri i përgjithshëm i studentëve ka qenë 1722,
Në vitin akademik 2022/2023 studimet i kanë vijuar 1843 studentë, kurse
Në vitin akademik 2023/2024 studimet i kanë vijuar 1912 studentë.

Disa prej programeve ofrojnë lëndë mësimore si gjuhë e huaj lëndën e gjuhës angleze dhe asaj gjermane. Nuk ofrohet mësimi i gjuhës frënge si gjuhë e huaj si obligative dhe as si lëndë zgjedhore.

Universiteti publik « Ukshin Hoti » në Prizren ofron studime kryesisht në gjuhën shqipe.

Në vitin akademik 2021/2022 ka pasur 3648 studentë,
Në vitin akademik 2022/2023 ka pasur 3027 studentë, kurse
Në vitin akademik 2023/2024 janë të regjistruar 3242 studentë.

Përveç programit të studimit në gjuhën shqipe, në studimet bachelor universiteti ofron programe studimi edhe në gjuhën turke dhe boshnjake.

Në vitin akademik 2021/2022 ka pasur 119 studentë në programin në gjuhën turke,
Në vitin akademik 2022/2023 ka pasur 105 studentë kurse
Në vitin akademik 2023/2024 ka 110 studentë.

Në programin e studimeve në gjuhën boshnjake ka pasur:

Në vitin akademik 2021/2022 - 156 studentë
Në vitin 2022/2023 -140 studentë kurse
Në vitin akademik 2023/2024 -146 studentë

Në Fakultetin e Filogjisë gjuha angleze figuron si gjuhë e huaj obligative si lëndë mësimore në vitin e parë, semestri i dytë me fond orësh 2+2. As gjuha frënge dhe as ajo gjuha gjermane nuk figurojnë në kurrikulën e studimeve si gjuhë e huaj as obligative dhe as zgjedhore. Në programin e studimeve bachelor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe dhe Gjuhë dhe Letërsi Gjermane gjuha angleze figuron si gjuhë e huaj obligative dhe frëngjishtja nuk figuron si e tillë dhe as si gjuhë zgjedhore.

Në Universitetin publik “Fehmi Agani” në Gjakovë mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Në shumicën prej programeve studimore gjuha angleze është kryesisht gjuhë e huaj e obligueshme, kurse gjuha gjermane është gjuhë e huaj zgjedhore.

Në vitin akademik 2020-2021 ka pasur 330 studentë,
Në vitin akademik 2021-2022 ka pasur 455 studentë,
Në vitin akademik 2022-2023 ka pasur 437 studentë, kurse
Në vitin akademik 2023-2024 ka 407 studentë.

Në Universitetin “ Haxhi Zeka” në Pejë Numri i përgjithshëm i studentëve

Në vitin akademik 2021/2022 është 8621,
Në vitin akademik 2022/2023 është 3701 dhe
Në vitin akademik 2023/2024 është 4022.

Sa i përket pikave për numër të studentëve dhe orëve mësimore në gjuhë frënge, si dhe gjuhë tjera, këto të dhëna nuk i posedojë, sepse nuk kam qasje në këto.

Në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe.
Gjatë vitit akademik 2021-2022 ka pasur të regjistruar në nivelin bachelor dhe master në total 1112 studentë,

Në vitin 2022-2023 ka pasur të regjistruar 1312 studentë, kurse

Në vitin akademik 2023-2024 janë 1343 studentë.

Gjuha angleze dhe gjuha gjermane janë si lëndë gjuhë të huaja obligative në të gjitha programet studimore në këtë universitet dhe në vitin akademik 2023/2024 anglishten e kanë zgjedhur 640 studentë kurse gjermanishten 560 studentë. Frëngjishtja nuk parashihet as si lëndë zgjedhore.

Në Institucionet private të Arsimit të lartë:

Kolegji AAB në total 10.274 studentë. Mësimi në këtë kolegji zhvillohet në gjuhën shqipe.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 janë regjistruar 3134 studentë,

Gjatë vitit akademik 2022-2023 janë regjistruar 3535 studentë, kurse

Në vitit akademik 2023-2024 janë regjistruar 3605 studentë.

Në secilin program studimi, lënda e "Gjuhës angleze", ofrohet si lëndë obligative në vitin e parë, dhe si rrjedhojë e kësaj i bie që të gjithë studentët, tri gjeneratat e përfshira e kanë ndjekur ligjëratat në lëndën gjuhë angleze (10.274 studentë). Ndërsa lënda e "Gjuhë gjermane" ofrohet vetëm në programin e "Gjuhës angleze", në vitin e parë dhe vitin e dytë, kurse nuk ofrohet mësimi i gjuhës frënge as si gjuhë e huaj zgjedhore.

Kolegji Heimerer zhvillon programet në bachelor dhe master vetëm në gjuhën shqipe. dhe nuk ka programe në gjuhë të huaj.

Në vitin akademik 2021/2022 kanë vijuar studimet 330 studentë,

Në vitin akademik 2022/2023 ka pasur 386 studentë, kurse

Në vitin akademik 2023/2024 janë duke i vijuar studimet 430 studentë.

Studentët e programit Infermieri mësojnë gjermanishten vetëm si gjuhë të huaj. ju konfirmojmë që nga gjeneratat, të cilat i keni kërkuar, rregullisht i ndjekin klasat e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj 144 studentë. Ky numër nuk përfshinë studentët pasiv, të cilët ndjekin klasat e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj, gjatë muajve të verës. Atyre studentëve u ofrohet programi i njëjtë i mësimit gjatë muajve korrik - shtator në formë të organizuar, në mënyrë që t'u bashkangjiten gjeneratës përkatëse, sapo të fillon viti i ri akademik. Numri i këtyre studentëve është 86.

Kolegji AMECC rezonanca zhvillon programet zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe.

Gjatë vitit akademik 2021/2022 janë regjistruar gjithsej 631 studentë,

Gjatë vitit akademik 2022/2023 janë regjistruar gjithsej 526 studentë, kurse

Gjatë vitit akademik 2023/2024 janë regjistruar gjithsej 406 student.

Studentët mësojnë anglisht si gjuhë e huaj. Nuk mësohet në asnjë gjuhë tjetër si gjuhë e huaj.

Kolegji RIT Kosovo ofron të gjitha programet e studimit në gjuhën angleze dhe nuk ka asnjë program në ndonjë gjuhë tjetër.

Në vitin akademik 2021-2022: 562 studentë,

Në vitin akademik 2022-2023: 589 studentë, kurse

Në vitin akademik 2023-2024: 662 studentë.

Gjatë semestrave të rregulltë, të gjitha programet studimore ofrohen në gjuhën angleze. Sidoqoftë, gjatë programit veror, që mbahet çdo vit, RIT Kosova ofron një lëndë hyrëse pa kredi, në gjuhën shqipe. Për më tepër, gjatë programit veror 2023, është ofruar nga një lëndë hyrëse pa kredi, në gjuhën shqipe si dhe në gjuhën serbe.

Kolegji Riinvest aktualisht ka 910 studente. Gjeneratën e fundit të studentëve e ka të regjistruar në vitin akademik 2021/22.

Në vitin akademik 2021/22 kanë regjistruar 242 studentë të rinjë.

Në vitin akademik 2023/24 ka pasur aktiv 276 studente. Pra, keta janë studente që kanë regjistruar vitin akademik 2023/24.

Kolegji Riinvest nuk ofron mësim në gjuhën frënge. Në vitin akademik 2021/22 në kolegjin Riinvest 242 studentëve të rinjë ligjërata në lëndën "Anglisht për Biznes". Angazhimi javor për këtë lëndë ka qenë dy orë akademike në javë, në total, 24 orë akademike.

Kolegji Universum ofron studime në gjuhën shqipe. Numri total i studentëve në vitin 2023-2024 është 1628. Prej tyre në programin gjuhë angleze me specializim : anglisht me gjermanisht janë 117 studentë.

Në vitin akademik 2022-2023 kanë vijuar studimet 1395 studentë prej tyre në Gjuhë angleze me specializim anglisht me gjermanisht 137 studentë, kurse

Në vitin akademik 2021-2022 kanë vijuar studimet 1502 studentë, kurse në Gjuhë angleze me specializim gjuhë të huaj anglisht me gjermanisht 168 studentë. Nuk ka studentë që vijojnë studime në gjuhën frënge.

Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë - ligjëratat i zhvillon në gjuhën shqipe. Si gjuhë të huaja të cilat mësohen në kuadër të programit studimor janë: gjuha arabe, gjuha angleze dhe gjuha turke. Gjuha arabe ka më së shumti kredi, e pasuar nga gjuha angleze dhe gjuha turke.

Në vitin akademik: 2021/2022 kanë qenë 240 studentë.

Në vitin akademik: 2022/2023 kanë vijuar studimet 215 studentë

Në vitin akademik, 2023/2024 është 242 studentë.

Gjuha arabe është obligative, që nënkupton se të gjithë studentët i ndjekin ligjëratat në këtë gjuhë. Ndërsa gjuha angleze, viti i parë është obligative, viti i dytë në dy semestrat është opsionale. Gjithashtu edhe gjuha turke është opsionale.

Kolegji ESGL ka gjithsejtë 50 studentë. Mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe. Gjuha frënge nuk mësohet.

Kolegji Tempulli zhvillon studimet vetëm në gjuhën shqipe, por të gjithë studentët e nivelit bachelor në semestrin e parë dhe semestrin e dytë mësojnë gjuhën angleze, që do të thotë rreth 180 studente. Po ashtu, studentët kanë mundësi të zgjedhin edhe gjuhën gjermane si lëndë zgjedhore e huaj, por nuk ka pasur kandidatë. Gjuha frënge nuk është as si lëndë e huaj as obligative dhe as zgjedhore.

- **Numri total i studentëve dhe orëve mësimore në gjuhë të tjera në arsimin e lartë** (specifikoni gjuhët): *Klikoni këtu për të shkruar tekstin.*

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" – në programet e veta studimore i ka këto gjuhë të huaja: angleze, gjermane, franceze, italiane dhe kroate. Gjuha frënge si gjuhë e huaj u propozohet studentëve në të gjitha departamentet e Fakultetit të Filologjisë si dhe në Fakultetin

Filozofik, Fakultetin Juridik dhe Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Në vitin akademik 2021/2022 - në gjuhën angleze si lëndë gjuhë të huaj kanë mësuar 5732 studentë, në gjuhën gjermane 1650, në gjuhën frënge 421 studentë, në gjuhën italiane 114 studentë, në gjuhën kroate 5 studentë.

Në vitin akademik 2022/2023 - në anglisht kanë mësuar 4176 studentë, në gjermanisht 1683 studentë, në frëngjisht 511 studentë, 99 studentë në italisht dhe 1 student në gjuhën kroate

Në vitin akademik 2023/2024 - si gjuhë të huaj në anglisht kanë mësuar 2819 studentë, në gjuhën gjermane 781 studentë, në gjuhën frënge 267 studentë kurse 43 studentë si gjuhë të huaj kanë pasur italishten.

- **Përshkrim i shkurtër i sistemit të trajnimit të mësuesve dhe në frëngjisht: Klikoni këtu për të futur tekstin.**

Sipas Shoqatës së Profesorëve të Frëngjishtes në kuadër të UP-së numri i përafërt i profesorëve të frëngjishtes në shkolla publike aktualisht është 50. Sa i perket trajnimeve, sipas të dhënave të ofruara nga Shoqata në fjalë, pas pandemisë nuk janë mbajtur trajnime nga ana e Shoqatës, por në bashkëpunim me Ambasadën franceze dhe Aleancen franceze, si dhe me CREFECO janë dërguar dhe po dërgohen profesorë në trajnime në Paris (përmes Aleances franceze), në Struge dhe në Budapest (Universitete verore), trajnime të cilat nuk janë të akredituara nga MASHTI-it.

• **Nëse frëngjishtja është gjuhë e huaj:**

- **Numri total i nxënësve dhe orëve mësimore të frëngjishtes në nivele fillore dhe të mesme: Kliko këtu për të futur tekstin.**

Në shkollat publike në vitin shkollor 2022-2023 në nivelin fillor kanë mësuar frëngjisht **2.090** nxënës kurse në nivelin e mesëm: **11.223** nxënës kurse në shkollat private, niveli fillor: **936** orë në vit, kurse niveli i mesëm: **936** orë në vit.

- **Evoluimi i këtij numri (në dhjetë vitet e fundit) dhe krahasimi me gjuhë të tjera të huaja të mësuara: Klikoni këtu për të futur tekstin.**

Numri i nxënësve që mësojnë frëngjisht në shkollat publike të Kosovës ka evoluar përgjatë viteve si në vijim:

Viti shkollor 2014/2015 - **20.162** nxënës,

Viti shkollor 2018/2019 - **22.277** nxënës,

Viti shkollor 2022/2023 - **13.313** nxënës.

Një prej arsyeve të rënies së numrit të nxënësve 5 vitet e fundit është zvogëlimi i numrit të nxënësve në përgjithësi në shkollat e Kosovës, në shifrat si vijon:

Viti shkollor 2014/2015 - **388.351** nxënës,

Viti shkollor 2018/2019 - **356.270** nxënës,

Viti shkollor 2022/2023 - **318.947** nxënës.

Tekstet e përdorura për mësimin e gjuhës frënge në shkolla janë:

- MERCI 1 (niveli A 1.1.1) për klasën e 6-të
- INER ACTIONS 1 (niveli A 1.1) për klasën e 10-të, për mësimin e gjuhës frënge si gjuhë e dytë për klasat e 6-ta dhe të 10-ta.

- Numri, titujt dhe efektivet e ndjekësve frankofonë të kurseve universitare:
Klikoni këtu për të futur tekstinin.

*Frëngjishtja në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" është ligjëruar që nga vitet e 70-
a dhe vazhdon të mësohet në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Franceze si dhe është si
lëndë zgjedhore në disa prej fakulteteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Frënge është partner me Universitetin e Caen dhe ku
studentët kosovarë kalojnë një vit akademik atje dhe më pastaj marrin diplomë të dyfishtë.*

- Numri i përgjithshëm i atyre që mësojnë frëngjisht jashtë sistemit shkollor (në
Aleancat franceze, Institutet franceze ose qendra të tjera gjuhësore private ose
publike): *Klikoni këtu për të shtypur tekstin.*

*Në kuadër të Memorandumit të Partneritetit me ONF-së për periudhën 2019-2022 dhe 2023-
2026, Aleanca Franceze është e përfshirë si ofruese e shërbimit të mësimit të frëngjishtes për
nëpunësit civil/diplomatët. Gjatë kësaj periudhe janë trajnuar në mësimin e frëngjishtes së
marrëdhënies ndërkombëtare nga niveli A2-B2 ky numër të zyrtarëve/diplomatëve: 2019(32
veta), 2020 (17 veta), 2021(31 veta), 2022(32 veta), 2023 (36 veta), pra në total 148
zyrtarë/diplomatë. Jashtë këtij memorandumi të partneritetit me ONF-në dhe jashtë sistemit
edukativ formal parauniversitar, numri i atyre që kanë mësuar frëngjisht në këtë institucion(
Aleancën Franceze) gjatë tre viteve të fundit ka qenë si në vijim: viti 2021: 407 veta, gjatë vitit
2022: 305 veta dhe gjatë vitit 2023: 263 veta (ANEX 9) .*

- Përshkrim i shkurtër i sistemit të trajnimit të mësuesve të gjuhës frënge dhe
gjuhë të tjera të huaja: *Kliko këtu për të futur tekstin*

*Sa i përket trajnimeve, sipas të dhënave të ofruara nga Shoqata e Profesorëve të Frëngjishtes,
pas pandemisë nuk janë mbajtur trajnime nga ana e Shoqatës, por në bashkëpunim me
Ambasadën franceze dhe Aleancën franceze, si dhe me CREFECO janë dërguar dhe po
dërgohen profesorë në trajnime në Paris (përmes Aleancës franceze), në Strugë dhe në
Budapest (Universitete verore), trajnime të cilat nuk janë të akredituara nga MASHTI-it.*

- **Ekzistenca e një politike gjuhësore arsimore e favorshme për frëngjishten dhe, në
përgjithësi, për mësimin e gjuhëve të huaja** (sidomos masat dhe reformat arsimore të
ndërmarra në lidhje me mësimin në dhe të frëngjishtes):

*Gjuha frënge, si gjuhë zyrtare e OKB-së, e diplomacisë, kulturës, artit, modës etj., është ndër
gjuhët më të rëndësishme botërore dhe paraqet interes për t'u mësuar kudo në botë, e
rrjedhimisht edhe në Kosovë. Pas ndryshimeve të mëdha në vendin tonë (politiko-shoqërore,
ekonomike, arsimore etj.) ajo mbetet gjuhë me interes për gjeneratat tona të tashme dhe të
ardhme, jo vetëm si mundësi komunikimi në këtë gjuhë në botë, por edhe si mundësi ndërtimi
të karrierës, punësimit, studimeve etj. Gjuha frënge si gjuhë e dytë e huaj mësohet në klasat 6-
12. Sipas kurrikulës bërthamë për nivelin 2 dhe 3, lënda e gjuhës frënge është lëndë zgjedhore.
Divizioni për Plan-Programme dhe Tekste Shkollore (DPTSH) ka hartuar së bashku me ekspertë
programme lëndore të gjuhës frënge për klasën 6-12 të cilat janë shpërndarë nëpërmjet
Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) në të gjitha shkollat e Kosovës. Ekzistojnë tekste
shkollore të gjuhës frënge për këto klasa. MASHTI në bashkëpunim me shtëpitë botuese kanë
bërë trajnimin e gjithë mësimitdhënësve të gjuhës frënge se si të përdoren këto tekste për arritjen
e rezultateve të programit për klasat 6-12. Sipas Kornizës Kurrikulare të Arsimit
Parauniversitar të Republikës së Kosovës, e rishikuar në vitin 2016, Gjuha Frënge është gjuhë*

e dytë e huaj, e cila hyn te fusha kurrikulare : Gjuhët dhe Komunikimi. Ajo mësohet sipas plan-programit mësimor, i cili me vendim të MASHTI-t duhet zbatuar në çdo shkollë të Kosovës për klasat 6-9 (me nga një orë) dhe klasat 10-12 (nga dy orë). Për më shumë, shih Plan-Programet Mësimore për Gjuhën Frënge për klasat 6-9 dhe 10-12 në faqen e MASHTI-t. (ANEX 10).

- **Partneritetet e mundshme me institucionet arsimore në vendet e hapësirës frankofone dhe pjesëmarrja në bashkëpunimin arsimor frankofon: Kliko këtu për të futur tekstin.**

Ndër partneritetet më të rëndësishme mes institucioneve arsimore të Kosovës dhe atyre frankofone është ai ndërnjet Departamentit të Arkeologjisë dhe Antropogjisë të Universitetit të Prishtinës dhe Institutit Arkeologjik të Kosovës me Ecole Normale Supérieure të Parisit. Në kuadër të këtij partneriteti përveç shkollimit dhe specializimit të studentëve kosovarë në Paris, tash e disa vite zhvillohen gërmime arkeologjike në Parkun Arkeologjik Ulpiana dhe arkeologët francez së bashku me ata kosovarë kanë arritur deri te zbulimet historike me peshe jashtëzakonisht të madhe shkencore. Në vitin 2022 janë zbuluar themelet e një kishe paleokristiane me dimensione nga më të mëdhatë në trevën e Ballkanit. Në vitin 2023 mbrenda mureve të kësaj kishe është zbuluar mbishkrimi në mozaik ku shihet se Perandori Justinian së bashku me gruan e tij Theodora themelojnë qytetin e Dardanisë. Partneritete tjera kanë edhe fakultetet tjera të UP-së, siç është rasti i Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Frënge që është partner me Universitetin e Caen dhe ku studentët kosovarë kalojnë një vit akademik atje dhe më pastaj marrin diplomë të dyfishtë (ANEX 11) .

6. Mjedisi frankofon

- **Qendrat ose institutet kulturore frankofone:**

Qendra Profesionale Frankofone - Në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Filologjisë, më 21 mars 2023, në fillimin e Javës së Frankofonisë, në 50 vjetorin e ONF është promovuar Qendra Profesionale e Frankofonisë. Kjo në të vërtetë është një rihapje e Qendrës së Frankofonisë e cila ekzistonte më parë në këtë hapësirë, por tash me konceptin e ri të orientimit profesional dhe punësimit të të rinjëve frankofonë.

Espace France – Ambasada e Francës në bashkëpunim me Aleancën Franceze të Prishtinës deri më tani ka pesë (5) qendra frankofone të cilat nga ky vit do të quhen « Espace France ». Qendrat e tilla ndodhen në Prizren në Universitetin “Ukshin Hoti”, në Kinemanë “Jusuf Gervalla” në Pejë, në Fushë Kosovë në Kolegjin AAB, në Fushë Kosovë në Institutin Profesional KTC, si dhe në Vushtri në shkollën fillore “Bahri Haxha” dhe shpresojmë që deri në fund të vitit të kemi edhe një tjetër.

Rrjetizimi institucional Frankofon(RIF)

Klubi i Avokatëve Frankofonë në kuadër të Odës së Avokatëve të Kosovës - Në vitin 2020, në kuadër të Odës së Avokatëve të Kosovës është themeluar Klubi i avokatëve frankofonë. Në kuadër të aktiviteteve të tij dhe me ndihmën e Ambasadës Franceze në Kosovë, Klubi i Avokatëve Frankofonë kishte kontaktuar me CIB-Conférence Internationale des Barreaux de tradition juridique commune (Konferencës Ndërkombëtare të Avokatëve të traditës juridike anglosaksone-CIB) dhe si rezultat i kësaj më vonë Oda e Avokatëve të Kosovës është anëtarësuar në CIB. CIB është njëra prej 16 Rrjeteve institucionale frankofone. Oda e Avokatëve të Kosovës ka marrë pjesë në aktivitetet e CIB në Armeni, Rumani dhe së fundmi edhe në Niger, ku janë prezentuar me temën "Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë- 1991-2021".

Klubi i Avokatëve Frankofonë ka zhvilluar takime me përfaqësues të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë ku kanë kërkuar mbështetje për aktivitetet e Odës së Avokatëve të Kosovës. Në këtë kuadër, u është aprovuar kërkesa për mbështje për përpilimin e statutit dhe kodit të etikës së Odës së Avokatëve të Kosovës, ku ekspertët e ONF-së do të zhvillojnë aktivitete në këtë drejtim. Zbatimi i ndihmës do të bëhet përmes Konferencës Ndërkombëtare të Avokatëve të traditës juridike anglosaksone-CIB të cilat kanë si të përbashkët gjuhën frënge (ANEX 12).

Institucioni i Ombudpersonit/Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës- Më 15 tetor 2015, Institucioni i Avokatit të Popullit është pranuar anëtar me të drejta të plota në Asociacionin e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësve të Frankofonisë, si njëra prej 16 Rrjeteve Institucionale Frankofone. Si anëtar i këtij asociacioni frankofon, Avokati i Popullit në vazhdimësi merr pjesë në Asambleshë Vjetore dhe aktivitete të tjera për ngritje të kapaciteteve, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në vendimmarrjen e kësaj organizate përmes votës, me rastin e pranimit të anëtarëve të rinj (ANEX 13).

Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) - Më 3 tetor 2023 Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) e Republikës së Kosovës është pranuar si anëtare me të drejta të plota në Shoqatën Frankofone për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (me seli në Francë), gjatë mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të mbajtur në Tanger, Marok. Shoqata Frankofone e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave, e krijuar në shtator të vitit 2007, është njëra nga 16 Rrjetet Institucionale Frankofone që bashkon autoritetet e pavarura të mbrojtjes së të dhënave të 23 shteteve dhe qeverive që ndajnë si të përbashkët gjuhën frënge dhe anëtarësimi i AIP-së në këtë Shoqatë ka për qëllim vendosjen e masave të bashkëpunimit efektin me autoritetet mbikqyrëse të shteteve tjera dhe siguron informacion relevant dhe ndihmë të ndëryellë (ANEX 14).

Gjykata Supreme e Kosovës - Më datë 18 tetor 2023 ka parashtruar kërkesë për aderim në Asociacionin e Jurisdiksioneve të Larta që kanë të përbashkët gjuhën frënge (AHJUCAF), si një prej 16 Rrjeteve Institucionale Frankofone. Është konfirmuar pranimiti i kërkesës nga Sekretari i Përgjithshëm i AHJUCAF si dhe është dhënë përkrahja nga ana e tij në lidhje me kërkesën e Gjykatës Supreme të Kosovës për mbledhjen e radhës së Burosë së AHJUCAF e cila është mbajtur në Paris, më datë 1 dhjetor 2023, ku edhe është shqyrtuar kërkesa për aderim, dhe më 20 dhjetor 2023, Sekretari i Përgjithshëm i AHJUCAF ka njoftuar se Gjykata Supreme e Kosovës është pranuar anëtare vëzhguese e AHJUCAF, dhe që tani mund të merrë pjesë në punën e AHJUCAF. Kurse kërkesa për aderim me të drejta të plota do të shqyrtohet në Asambleshë e Përgjithshme të radhës që do të mbahet në vitin 2025 (ANEX 15).

Komisioni Qendror Zgjedhor(KQZ)- Më datë 1 shkurt 2024, KQZ-së ka parashtruar kërkesë për aderim të KQZ-së në rrjetin institucional frankofon të komisioneve elektorale(RECEF). Më 8 maj 2024, RECEF ka njoftuar KQZ-në për pranimitin e saj si anëtar i përkohshëm, deri në shqyrtimin për pranim formal me të drejta të plota gjatë Asamblesë së Përgjithshme të radhës që do të mbahet në Cononou, Beni, në tetor 2024. Gjatë kësaj periudhe kohore, deri në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, KQZ do të ftohet të marrë pjesë në aktivitetet e RECEF.

Komiteti Olimpik i Kosovës(KOK) - është anëtar e Asociacionit të Komiteteve Olimpikë kombëtare të Frankofonisë (AFCNO - Association of Frankophonie National Olympic Committees) si dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me vende të Frankofonisë si në vijim:

- Memorandum mirëkuptimi me NGO Play International;

- Memorandum mirëkuptimi - Balkan Cooperation 5 (BC5) ku me iniciativën e NOC të Francës ka një partneritet mes Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës;
- Bashkëpunim i ngushtë me Ambasadën e Francës në Kosovë për aktivitete të përbashkëta vjetore: International Day for Peace and Development, Olympic Day, Francophonie ëeek, aktivitete rreth Lojërave Olimpikë Paris 2024: 500 ditë deri ne LO; 134 ditë e aktivitete të përbashkëta deri në nisje për LO Paris 2024;
- Memorandum bashkëpunimi me Aleancen Franceze në Kosovë - aktivitete dhe organizimi i kursit të gjuhës frënge me bashkëfinancim: KOK- Aleanca Franceze.

Aleanca Franceze - Aleanca Franceze në Prishtinë është një asociacion i krijuar në vitin 2004, të cilës i ka paraprirë “Hapësira Kulturore Franceze” para se të shndërrohet në Aleancë Franceze e Prishtinës në vitin 2011. Është pjesë e rrjetit të Aleancës Franceze duke qenë shkolla kryesore e gjuhës frënge në Prishtinë e cila ka për funksion të merrret me mësimin e gjuhës frënge me metoda bashkëkohore cilësore. Aleanca Franceze në Prishtinë zhvillon aktivitete të nduarshme që kanë për qëllim afirmimin dhe përhapjen e gjuhës frënge dhe të kulturës frankofone në Republikën e Kosovës. Ajo organizon kurse të frëngjishtes në nivele të ndryshme, në të cilat marrin pjesë nxënës dhe gazetarë si dhe organizon debate në lidhje me veprat e autorëve francez, mbrenje muzikore dhe të poezisë franceze. Aleanca Franceze në Prishtinë disponon me një mediatekë të pasur me libra, dokumente dhe DVD. Ajo merr pjesë në “Javën e Frankofonisë” në Kosovë në bashkëpunim me praninë diplomatike të vendeve frankofone në Kosovë, në organizimin e Festivalit të Frankofonisë, Javën e Filmit Francez, festës së muzikës dhe aktivitete tjera kulturore (ANEX 16).

***Instituti Francez i Kosovës** –Më 26 mars 2024 në prani të institucioneve më të larta të vendit dhe të pranisë ndërkombëtare në Kosovë është bërë inaugurimi i Instituti Francez të Kosovës. Presidentja e Republikës znj. Vjosa Osmani Sadriu ka qenë e pranishme së bashku me të dërguarin e posaçëm të Francës për Ballkanin z. René Troccaz, Ambasadorin e Francës në Kosovë z. Olivier Guérot si dhe drejtorin e Institutit z. Donato Giulini. Kjo iniciativë dëshmon për angazhimin e fortë të Francës për të theluar lidhjet kulturore dhe gjuhësore me Kosovën. Instituti Francez i Kosovës, si një platformë operationale e Ambasadës së Francës në Prishtinë, do të forcojë praninë franceze në Prishtinë dhe në tërë Kosovën, përmes dy degëve të tij në Kolegjin AA në Fushë Kosovë si dhe Universitetin « Ukshin Hoti » në Prizren. Degë të tjera mund të hapen në të ardhmen. Inaugurimi i këtij Instituti u zhvillua në kuadër të Javës së Frankofonisë prej datës 21-27 mars 2024 në Prishtinë dhe në Mitrovicë dhe ishte e mbuluar nga mediat e Kosovës, duke u vënë theksi mbi rëndësinë e kësaj ngjarjeje për marrëdhëniet mes Kosovës dhe Francës.*

***Shoqata e Mësimdhënësve të Frengjishtes** – Sipas të dhënave të vitit 2018, Shoqata ka numëruar rreth 200 profesor/e, prej të cilëve 97 kanë qenë aktiv. Shoqata punon në promovimin e mësimin të gjuhës frënge dhe të frankofonisë në Kosovë përmes organizimit të aktiviteteve dhe manifestimeve gjuhësore dhe kulturore frankofone në shkolla dhe në universitet. Shoqata përpiket në drejtim të politikave gjuhësore me qëllim të avancimit të pozitës dhe vendit të gjuhës frënge si gjuhë e mësimin në Kosovë. Shoqata (APFK) ka organizuar trajnime te veçanta sikurse është organizimi kur janë miratuar librat e rinj për mësim të frengjishtes në vitin 2017 ose në kuadër të Universitetin Pranveror të mbajtur në Prill 2019 (edicion i parë i cili nuk u përserit më për shkak të pandemisë dhe të grevës së arsimtarëve në vitin 2022). Shoqata, ne bashkëpunim dhe bashkëfinancim të Ambasadës Franceze dërgon profesor/e në Universitetin veror të Strugës, në Universitetin veror të Budapestit si dhe në Aleancen franceze të Parisit ku ata mbajnë trajnime sipas moduleve të propozuara. Në korrik*

2023 Shoqata ka dërguar në Strugë dy profesore në një trajnim të organizuar dhe financiar nga CREFEKO. Shoqata përcjell edhe informatat e trajnimeve që mbahen nga ONF kryesisht online.

Shkolla Ndërkombëtare Franceze e Prishtinës - Kjo shkollë është hapur në vitin 2017 dhe e njejta punon sipas sistemit edukativ francez për vende të huaja. E njejta ka në gjirin e saj nxënës të familjeve franceze dhe atyre kosovarë. Stafi po ashtu është i përzier (ANEX 17).

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (ASHAK) – Kjo akademi u bë anëtare e Unionit Akademik Ndërkombëtar (UAI), në Asamblenë e përgjithshme të Unionit, e cila u mbajt në Tokio në vitin 2017, në sajë të mbështetjes, në veçanti të Akademisë franceze. I deleguari i Kosovës në atë asamble Akademik Muhamedin Kullashi është një frankofon i përkryer dhe që nga viti 2017 është kryeredaktor i revistës “Studime shoqërore” të cilën e boton Seksioni i Shkencave Shoqërore i ASHAK. Me atë rast ka biseduar si me kryetarin e UAI, profesorin Sam Lieu, ashtu edhe me profesorë të tjerë dhe ka kërkuar bashkëpunim të tyre me ASHAK, duke dërguar artikujë për botim në revistat « Studime » dhe « Studime shoqërore » si dhe për mundësinë e pjesëmarrjes së tyre në konferencat e ASHAK. Revista “Studime shoqërore” gjatë viteve ka botuar studimet e akademikëve dhe profesorëve nga vendet frankofone, nga lëmenj të ndryshëm : Sam Lieu, Michel Zink, Luisa Migliorati, Dario Canino, Henri Lavagne, Alain Brossat, Samuel Clark Lieu (Kryetar i UAI), Antoine Garapon, Patrice Vermeren, Patrick Vauday, Véronique Nahoum Grappe, Georges Navet, Gérard Raulet, Susana Villavicencio etj.

Vetë Akademik Kullashi, gjatë afro tri decenive, ka botuar si autor dhe bashk-autor libra në gjuhën franceze në Francë, Belgjikë, Zvicër e Kanada. (Humanisme et haine, Paris, Effacer l'autre, Paris, Foucault et Lefort: regards croisés sur la modernité; Vukovar- Sarajevo 1993, Paris, La république, l'Europe et l'Universel, 1993, Belfort ; Parler des camps, penser les génocides, Paris, 1999, Sur l'ex-Yougoslavie, Paris 1996 Paris, Extrémismes en Europe, Paris, 1998 etj.) Le Kosovo, un drame annoncé, Paris, 1999, De la question albanaise au Kosovo, Bruxelles, 1999, Parler des camps, penser les génocides, Paris 1999, Lettres aux générations futures, Unesco-Paris, 1999; Kosovo, six siècles de mémoires croisés, INALCO, Paris 2001. Les désastres fondateurs, Nantes ; Les intellectuels et les médias : dialogues est-ouest sur la démocratie et pour les Balkans, Montréal-Canada, 2006 ; Nationalismes et religions dans les Balkans, Fondation Schumann, Paris, 2007 etj.

Ai ka botuar njëherit edhe në revista shkencore (Esprit, Drôle d'époque etj.) dhe në të përditshmet e mëdha të Francës “Le Monde”, “Le Figaro”, “Libération”, “France-Ouest” etj., artikuj kryesisht mbi anë të ndryshme të çështjes së Kosovës, nga fillimi i viteve 90 e deri më sot. Kullashi ka përkthyer 9 vepra të filozofëve francez nga frengjishtja në gjuhën shqipe : Denis Diderot, Dialogët filozofik, Henri Lefebvre, Kritika e jetës së përditshme në botën moderne, Jean Paul Sartre, Çështje të metodës dhe Situatat, Claude Lefort, Demokracia dhe totalitarizmi, Jean-François Lyotard, Gjendja postmoderne dhe Emmanuel Lévinas, Etika dhe e pakufishmja.

Në Konferencat shkencore të ASHAK (si « Filozofia dhe teatri », « Filozofia dhe poezia » etj.) janë ftuarë akademikë e filozofë nga Franca, Italia etj.) Jean-Yves Tilliette, Gérard Raulet etj.

Anëtari tjetër i Seksionit të Shkencave Shoqërore, Akademik Hivzi Islami, i cili po ashtu është frankofon, ka qenë kryetar i ASHAK në dy mandate dhe ka zhvilluar një bashkëpunim me disa universitete frankofone: në veçanti me Universitetin Toulouse le Mirail dhe me Universitetin

Paris 8, kryesisht me Departamente të gjeografisë dhe të gjeopolitikës. Ai ka ligjëruar shpesh në këto departamente me tema që i përkasin gjeopolitikës në Ballkan e në veçanti me statusin e Kosovës dhe me rrjedhat gjeopolitike në decenitë fundit në Ballkan. Në shkrimet e veta si dhe në ligjëratat e veta në universitete frankofone, Akademik Islami ka trajtuar aspekte të ndryshme të tranzicioneve demografike në Ballkan, çështjet e spastrimeve etnike të Kosovës nga regjimet serbe etj. Ai ka botuar shpesh në revistat shkencore frankofone, si : “Revue géographique de l'Est”, “Population”, “Peuples Méditerranéen”, “Bulletin de la Société de géographie de Toulouse” etj.

Akademik Islami, si Kryetar i ASHAK ka qenë i angazhuar bashkë me Akademik Rexhep Ismajlin dhe me ambasadorin e atëhershëm të Kosovës në Francë M. Kullashi në vendosjen e bashkëpunimit të rregullt me Akademinë e Francës (AIBL) dhe me Kryetarin e saj z. Michel Zink. Si rezultat i këtij angazhimi doli edhe nënkshkrimi i Konventës për bashkëpunim midis Akademisë franceze dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, më 16 nëntor 2017 në Prishtinë. Seksioni i Shkencave shoqërore, në sajë të përvijës së vet të shumëfishtë në zhvillimin e bashkëpunimit me akademitë simotra frankofone dhe me autorë të çmuar frankofonë nga vende të ndryshme, do të vazhdojë të thellojë këto përvija të bashkëpunimit. Përndryshe, edhe seksionet tjera të ASHAK-ut si ai i Gjuhës dhe Letërsisë dhe ai i Shkencave të Natyrës kanë anëtarë frankofonë të cilët kanë botuar libra në frengjisht ose kanë përkthyer autorë frankofonë (ANEX 18).

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani” - Përveç mijëra librave që i ka në gjuhën frënge, si dhe një bashkëpunimi me bibliotekat e Francës, sidomos me Bibliotekën Kombëtare të Francës, në fushën e restaurimit, në hapësirat e kësaj biblioteke për çdo vit, prej vitit 2018 e këndeje, mbahet një aktivitet i rëndësishëm për promovimin e gjuhës, kulturës dhe arsimit frankofon – Panairi i Universiteteve të Francës, me titull: “Studioni në Francë”. Ky aktivitet mbahet në bashkëpunim me Qendrën për zhvillimin e Karrierës në kuadër të Universitetit të Prishtinës dhe me Ambasadën e Francës në Kosovë. Prandaj Biblioteka Kombëtare e Kosovës Pjetër Bogdani, po ashtu mund të konsiderohet si një mjedis frankofon.

Libraria “Bardhi” - përveç që shiten dhe promovohen libra të autorëve francez dhe frankofonë në përgjithësi, aty janë të vendosur edhe disa posterë me fotografitë e intelektualëve, filozofëve dhe autorëve të shquar francez, si: Michel Zink, Paul Ricoeur, Claude Lefort, Edgar Morin, Pierre Hasner, Antoine Garapon, Michel Foucault, Gilles Deleuze, Jean François Lyotard etj. Këto personalitete kanë statusin e “mysafirrit permanent” në këtë librari. Në konceptin e vet të punës, kjo librari ka edhe promovimet dhe debatet për librat e sapobotuara apo të përkthyer, e aktivitete të tilla aty zhvillon edhe në gjuhën frënge. Kësisoji kjo librari mund të konsiderohet gjithashtu si një hapësirë e rëndësishme frankofone e Kosovës.

Ngjarjet kryesore kulturore frankofone dhe periodiciteti i tyre:

Kosova vazhdon të promovojë gjuhën dhe kulturën frankofone përmes manifestimeve kulturore dhe aktivitete të shënuara në fushën e literaturës, teatrit, muzikës, kinemasë, multimedias, artit rrugor, takimeve të artistëve dhe të krijuesve etj.

Java e Frankofonisë: - Ka një traditë mjaft të gjatë të organizimit të Javës së Frankofonisë në Kosovë, e cila festohet me aktivitete të shumta: film, teatër, muzikë, debate, literaturë, gastronomi, kuize rreth njohurive të gjuhës frënge dhe konkurse letrare. Aktivitetet organizohen kryesisht nga Ambasada e Francës në Kosovë në bashkëpunim me misionet diplomatike frankofone në RKS (Zvicrës, Belgjikës, Kanadasë, Luksemburgut, dhe shumë partner tjerë nga

Kosova dhe Franca Aleancën Franceze të Prishtinës) si dhe institucionet e RKS Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës etj. Edicioni i XXIII-të me radhë i “Javës së Frankofonisë” në Kosovë është mbajtur në datat 20-26 mars 2023, dhe qyteti i Pejës ka qenë kryeqyteti Kosovar i Frankofonisë. Në këtë qytet janë mbajtur aktivitete të shumënduarshme dhe poashtu përfaqësia e Frankofonisë ka pozuar flamuj të saj edhe në qytetin e Mitrovicës, Ferizajit dhe në Prishtinë. Gjatë kësaj jave janë mbajtur konferenca, koncerte, projeksione filmike në ekran të madh në zemër të qytetit të Pejës. Gjatë katër ditëve, Peja ka përfutuar nga diplomacia feministe si dhe një rezonancë të rinisë frankofone dhe kosovare. Edicioni i këtij viti i Javës së Frankofonisë është shoqëruar me një përshpejtim të bashkëpunimit me qytetin partner si dhe me një rritje të bashkëpunimit mes pranive diplomatike në Kosovë. Kjo Javë e Frankofonisë pati një pjesëmarrje prej 1140 vetave dhe u pasqyrua në shtypin nacional si dhe në rrjetën sociale.

Edicioni i këtij viti, 2024, i XXIX-të i Javës së Frankofonisë është mbajtur në qytetin e Mitrovicës dhe në Prishtinë nga data 21 mars deri më 27 mars, me qytetin e Mitrovicës për këtë vit si kryeqytet kosovar i Frankofonisë. Gjatë kësaj jave janë mbajtur aktivitete kinematografike, muzikore, gastronomike dhe festive. Në ditën e hapjes së javës së Frankofonisë ka qenë i pranishëm kryeministri i Republikës së Kosovës z. Albin Kurti, dhe ka vazhduar spektakli i hapjes “B-B=BB”, një evokim poetik i viteve të lavdishme të Brigitte Bardot si aktore, këngëtare, vallëzuese dhe para së gjithash si ikonë feministe e epokës së saj. Në event ka marrë pjesë Shefi i misionit diplomatik të Luksemburgut në Kosovë z. Eric Dietz si dhe ambasadorët e vendeve tjera frankofone si dhe drejtori i Institutit Francez të Kosovës z. Donato Giuliani. Kjo ngjarje që një rast i mirë për të theksuar vlerat e përbashkëta të Frankofonisë siç janë diversiteti, i shënuar përmes tolerancës dhe multilinguizmit.

Festivali i Filmit Frankofon - Festivali i Filmit ndërkombëtar frankofon festohet çdo vit në Kosovë dhe në datat 12-18 tetor 2023 është shënuar edicioni i XXIII-të. Përgjatë javës u shfaqen filma të ndryshëm frankofonë në kinema të ndryshme në Kosovë (Prishtinë dhe Pejë). “Portrete të grave” u shfaqën filma të realizuar kryesisht nga gratë, disa prej tyre klasikë të mëdhenjë të kinemasë franceze, kurse disa të shfaqur si premierë në Kosovë. Ditën e hapjes pjesëmarrëse ishte edhe znj. Arberie Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit kurse në mbyllje të festivalit të filmit frankofon ishte i pranishëm Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit z. Hajrulla Çeku. Festa ndërkombëtare e muzikës festohet çdo vit në Kosovë rreth datës 21 qershor. Për herë të parë në Kosovë kjo festë u organizua më 21 qershor 2008, vetëm katër muaj pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Ambasada e Francës në Kosovë ka bashkëpunuar me institucionet e RKS-së për të promovuar një program të përbashkët të ngjarjeve kulturore që tregojnë lidhjen dhe miqësinë mes dy vendeve.

Bashkëpunimi në fushën e filmit - Qendra Kinematografike e Kosovës ka marrë pjesë në tregun më të rëndësishëm të filmit ‘Marche Du Film’ në festivalin e Kanës, për 12 vjet me radhë. Në kuadër të bashkëpunimit kulturor dhe me synim të veçantë bashkëpunimin në fushën e bashkëprodhimit të filmit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Francës, me datë 21 maj 2022, është nënshkruar Marrëveshja për Bashkë-prodhim të Filmit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës. Qëllimi i kësaj Marrëveshje konsiston në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e bashkëprodhimit kinematografik në mes të dyja vendeve.

Në kuadër të bashkëpunimit në fushën e bashkëprodhimit kinematografik në mes të të dyja vendeve janë bashkëprodhuar katër filma: “Gardhi” dhe “Shpija e Agës” të Lendita Zeqirajt dhe “Luaneshat e Kodrës” i Luana Bajramit, Valbona Rrahmanit dhe Pascal Judeleïcz), si dhe “Bota Jonë” i Luana Bajramit. Filmi “Bota Jonë” është përzgjedhur për të garuar në

Festivalin e Filmit të Venedikut, i cili gjithashtu shënon edicionin jubilar të 80-të të këtij festivali. Filmi garon në kategorinë "Orizzonti", bashkë me filma të tjerë ndërkombëtarë të nivelit më të lartë kinematografik. Filmi "Bota Jonë" është financim i Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe Aide au Cinéma du Monde, pra bashkë-prodhim i Kosovës me Francën si filmi i parë i prodhuar pas nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëprodhim filmik me shtetin e Francës (ANEX 19).

***Pjesëmarrja në Festivalin e filmit të shkurtër në Clermont-Ferrand** - Filmi i metrazhit të shkurtër "Prishtinë 2002" me regji të Trëndelinë Halili dhe producent Ermal Gërdoveci, ka shfaqur premierën në festivalin e filmit të shkurtër Clermont-Ferrand (Festival du court métrage de Clermont-Ferrand) në Francë, në njërin prej festivaleve më të mëdha ndërkombëtare të filmit të shkurtër në botë, i kategorisë A. "Prishtinë 2002" u shfaq në ekranet franceze në kuadër të edicionit të 45-të të festivalit, i cili kishte nisur më 27 janar deri më 4 shkurt 2023.*

***Dokufest - Bashkëpunimi i DokuFest me Le Fresnoy - Studion Kombëtare të Artit Bashkëkohor** në kuadër të edicionit të 22-të të DokuFest, të mbajtur me 4-12 Gusht, 2023.*

***Qendra Multimedia** - Qendra ka bashkëpunuar me disa teatro dhe institucione kulturore të Francës. Ndër to është Festivali Sens Interdits ku jemi prezantuar në vitin 2021 me shfaqjen tonë "Pesë Stinët e Armikut të Popullit".*

Ndërsa në vitin 2023, Qendra Multimedia ka organizuar ciklin tematik "Bashkëpunimi në kontekst" me rrjetin ONDA (Office National de Diffusion Artistique) ku pjesëtarë të këtij rrjeti kanë vizituar institucionet si Galeria Kombëtare, Teatri ODA, Teatri Kombëtar i Kosovës, Teatri i Qytetit të Gjilanit, ku kanë pasur mundësinë të njihen për së afërmi me punën e këtyre institucioneve. Menaxhmenti i rrjetit ONDA janë bashkëpunëtorë të Qendrës Multimedia tash e katër vite, duke marrë pjesë në çdo edicion të « Kosovo Theatre Shoë case ».

***Artpolis** - Organizata « Artpolis » e njohur në Kosovë për promovimin e të drejtave të grave dhe vajzave përmes artit, po ashtu bashkëpunon me organizatën zvicerane CFD (Projekti: "Ndal/Stop-Jointly and creatively against gender-based violence", 2018-2023); Ambasadën e Dukatit të Madh të Luksemburgut në Kosovë (Festivali FemArt, 2022) dhe Ambasadën e Francës në Kosovë (Festivali FemArt, 2021, 2022, 2023).*

***Anibar** - Organizata Anibar me seli në Pejë dhe e njohur në Kosovë për organizimin e Festivalit të Filmit të Animuar, bashkëpunon me me festivale dhe organizata të Francës, si : Festivalin Ndërkombëtar të Filmit të Animuar Annecy (2017, 2020, 2021, 2022, 2023), Miyu Distribution (2018 – 2023 dhe Rencontres Audiovisuelles (2018) ; por edhe me festivale dhe organizata të Zvicrës si : Biestival, Brunig (2022) dhe Fantoche (2019, 2020).*

***Fondacioni Lombardhi** - Organizatë e njohur për mbrojtjen e Kinemasë Lombardhi dhe për zhvillimin e kulturës sidomos në shfaqjen dhe prodhimin filmik, bashkëpunon me Fondacionin Kadist të Parisit (2017-2020), Institutin Nacional Audio-Vizuel Francë (Projekti : « Urban Memoryspaces Prizren » 2018). Projektin « Nuit Blanche Prizren » (2019) e ka realizuar në bashkëpunim me Komuna e Parisit, Institutin Nacional Audio-Vizuel dhe Aleancën Franceze.*

***Filharmonia e Kosovës** – Me vite të tëra bashkëpunon me profesionist të kësaj fushe nga Franca, qoftë duke interpretuar vepra të kompozitorëve francezë, qoftë duke interpretuar vepra me dirigjent francezë, e mbi të gjitha duke interpretuar vepra në Paris apo vende tjera (ANEX 20).*

***Panairi i universiteteve të Francës, "Studioni në Francë"** - Ky aktivitet zakonisht mbahet në muajin tetor dhe organizohet nga Ambasada e Francës në Kosovë, në bashkëpunim me*

Qendrën për Zhvillimin e Karrierës në kuadër të Universitetit të Prishtinës dhe Bibliotekën Kombëtare në Kosovë. Për çdo vit, disa dhjetëra universitete të Francës prezantojnë programet dhe kushtet e tyre të studimit për të rinjtë Kosovarë. Tashmë ekziston një Marrëveshje për bursat të studentëve të nivelit Master që bëjnë studimet e tyre në Francë e nënshkruar mes MASHT dhe Ambasadës së Francës në Kosovë..

- **Vendi i botimit dhe shtypi i shkruar në gjuhën frënge:** Kliko këtu për të hyrë teksti.

Në fushën e portaleve, "Le Courrier des Balcons", e ka Kosovën në rubrikë permanente dhe aty herë pas here botohen artikuj për situatën aktuale në Kosovë. Një përmbledhje e këtyre artikujve të botuar më herët dhe të shkruara nga Profesoresha universitare dhe aktivistja e shoqërisë civile Znj. Nerimane Kamberi është botuar në të dy gjuhët: shqip dhe frëngjisht. Portali më i rëndësishëm i krijuar nga gazeta e njohur kosovare Koha ditore, informatat dhe publikimet e veta i bën edhe në gjuhën frënge.

- **Transmetimi i medias franceze:** Klikoni këtu për të futur tekstin.

Në platformën Ipko, dhe platformën Kujtesa është edhe TV5Monde. Në platformën Artmotion janë dy TV Doc 1 dhe Doc 2 të cilët transmetojnë dokumentarë francezë.

- **Prania e shoqatave që promovojnë gjuhën frënge apo Frankofoninë** (grupet profesionale, shoqatat e grave dhe rinisë, ndër të tjera): Klikoni këtu për të futur tekstin.
 - Centre d'Employabilité Francophone
 - Centre de la Francophonie (Prizren, Gjakovë, Pejë, Fushë-Kosovë, Vushtrri)
 - Shoqata e Mësimdhënësve të Frëngjishtes
 - Klubi i Fëmijëve/ Nxënësve Frankofonë
 - Klubi i Avokatëve Frankofonë
 - Grupi Parlamentar i Miqësisë me Francën
 - Grupi Parlamentar i Miqësisë me Zvicrën
 - Grupi Parlamentar i Miqësisë me Belgjikën
 - Grupi Parlamentar i Miqësisë me Kanadanë
 - Grupi Parlamentar i Miqësisë me Tunizinë

6. Elemente informacioni mbi përdorimin e frëngjishtes në skenën ndërkombëtare. Përdorimi i gjuhës frënge në forumet ndërkombëtare (me shkrim dhe me gojë):

Gjuha frënge përdoret nëpër disa forume ndërkombëtare ku merr pjesë Kosova. Në rend të parë ambasadat dhe konsullatat e Kosovës në vendet frankofone, e përdorin edhe frëngjishtën si gjuhë të punës dhe komunikimit të përditshëm. Ambasadorët dhe diplomatët e Kosovës në vendet frankofone e përdorin frëngjishten edhe në kuadër të takimeve dhe diskutimeve që i zhvillojnë në kuadër të Grupin e Ambasadorëve Frankofonë (GAF). Në gjuhën frënge e ka mbajtur fjalën e vet edhe Presidentja e Kosovës në kuadër të Tryezës për Dixhitalizimin që u mbajt në Plenaren e Samitit të Frankofonisë në Djerba, në vitin 2022, e gjithësesi edhe Përfaqësuesi i saj Personal në ONF. Delegacioni i Komitetit Olimpik të Kosovës që ka marrë pjesë në Lojërat e Frankofonisë, në Kinshasa të RDC, në vitin 2023, po ashtu ka komunikuar në frëngjisht.

E në të ardhmen, ngjarja më e madhe në Kosovë ku do të përdoret frëngjishtja paraqesin Lojërat Mediterrane të cilat do të mbahen në Prishtinë, në kryeqytetin e Kosovës, saktësisht në

vitin 2030. Do të jetë kjo hera e parë që këto lojëra do të mbahen në një qytet ose në një shtet i cili nuk ka dalje në det, por çështjen e disiplinave sportive që kanë të bëjnë me ujërat, Kosova e ka zgjidhur në marrëveshje me Shqipërinë.

Një ngjarje e rëndësishme ku përveç promovimit të librave kishite edhe tryezë diskutimi në frëngjisht, ishte Salloni i Librit Ballkanik , i cili u mbajt në INALCO të Parisit më 8-9 dhjetor 2023), dhe ku temë diskutimi ishte Prishtina, kryeqyteti i Kosovës dhe zhvillimet kulturore atje. Në tryezë kishite tre poetë dhe studiuesë kosovarë: Znj.Lindita Rugova – dekane e Fakultetit Filologjik në Prishtinë dhe dy të tjerë të cilët jetojnë në Francë - z. Ndriçim Ademaj (Paris) dhe z.Musa Jupolli (Paris). Në fjalën e tij me atë rast, duke shpjeguar Rrethin kulturor të Prishtinës, z.Ademaj iu referua librit të autorit Kujtim Shala “Prishtina letrare: Petit Paris” duke treguar lidhjet historike të studiuesve kosovarë me Francën, ndikimin e kësaj të fundit në formimin e tyre intelektual dhe kulturor, për shkak të studimeve apo qëndrimeve të tyre në Paris qysh në vitet '70-ta. Për këtë përmendi emra konkret: ish-Presidentin e Kosovës Ibrahim Rugova i cili kishite qenë student i Roland Barthes-it, Akademikun Sabri Hamiti, Akademikun Rexhep Ismajli etj.

Në sallon, veç diskutimeve pati edhe lexim poezish, me ç’rast poeti me origjinë kosovare lexoi poezitë e tij në frëngjisht.

Një ngjarje tjetër kulturore, ku kultura kosovare u promovua në frëngjisht, ishte “Requiem pour Ali” që u mbajt në Kishën St. Bernard të Parisit më 2 dhjetor 2023, në nderim të poetit më të madh kosovar - Ali Podrimja, i cili ka vdekur në Lodève të Francës, në vitin 2012, gjatë një festivali të poezisë. Kompozitori Maxim Perrin dhe Poeti Marc Delouze, bashkë me ekipin e tyre të aktorëve, instrumentistëve dhe këngëtarëve, shfaqën veprën e tyre, muzikë të zhanreve të ndryshme si: requiem, jazz dhe etno dhe lexuan poezitë e poetit tonë. Ky Requiem do të shfaqet në vitin 2024 edhe në vendlindjen e poetit, në Gjakovë, por edhe në kryeqytetin e Kosovës Prishtinë.

Një ngjarje tjetër e organizuar nga Ambasada e Kosovës në Paris, ishte promovimi i veprës së Abidin Krasniqi “Cantilènes de cycle épique albanais de Muji e Halil”, publië par FAUVES Editions (2023). Libri është një zgjedhje e teksteve të këngëve epike shqiptare në Kosovë dhe të njëjtat janë përkthyer frëngjisht. Në fakt libri është bilingual (shqip dhe frëngjisht). Autori i librit, më parë ka përkthyer në frëngjisht edhe një poemë epike “La Lute des Montagnes” të shkrimtarit shqiptar At Gjergj Fishta, si dhe romanin e shkrimtarit kosovar Gani Mehmetaj “Les oisillons du coucou: Souvenir d’un colon serbe”, gjithashtu botim i FAUVES Editions (2022). Së fundi, një varg me poema i titulluar “Poezia bashkëkohore shqiptare”, e cila rigrupon një vepër me 75 autorë shqiptarë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut është përkthyer në frëngjisht dhe publikuar nga Harmatan. Promovimi i një vepre të tillë ka qenë organizuar nga Ambasada e Kosovës në Paris, me rastin e Ditës ndërkombëtare të poezisë më 21 mars 2024 si dhe gjatë Javës ndërkombëtare të Frankofonisë.

- **Pjesëmarrja në konsultimet frankofone dhe iniciativat për të promovuar gjuhën frënge dhe shumëgjuhësinë në organizatat ndërkombëtare dhe/ose në konferenca të mëdha ndërkombëtare dhe/ose rajonale** (deklarata diplomatike, tekste që rregullojnë përdorimin e gjuhës frënge nga diplomatët dhe nëpunësit civilë që flasin në skenën ndërkombëtare, etj.):

Gjuha frënge përdoret nëpër disa forume ndërkombëtare ku merr pjesë Kosova. Në rend të parë ambasadat dhe konsulatat e Kosovës në vendet frankofone, e përdorin frëngjishtën si gjuhë të punës dhe komunikimit të përditshëm. Ambasadorët dhe diplomatët e Kosovës në vendet

frankofone e përdorin frëngjishten edhe në kuadër të takimeve dhe diskutimeve që i zhvillojnë në kuadër të Grupin e Ambasadorëve Frankofonë (GAF). Përfaqësuesit e Republikës së Kosovës në Gjenevë dhe në Strasburg përdorin gjuhën frënge gjatë takimeve dhe organizimeve qoftë me trupat e Këshillit të Evropës në Strasburg, qoftë me përfaqësuesit e shteteve në organizata tjera ndërkombëtare të pranishme në Gjenevë.

Në gjuhën frënge e ka mbajtur fjalën e vet edhe Presidentja e Kosovës në kuadër të Tryezës për Dixhitalizimin që u mbajtë në Plenaren e Samitit të Frankofonisë në Djerba, në vitin 2022, e gjithësesi edhe Përfaqësuesi i saj Personal në ONF, duke përfshirë edhe Konferencën Ministrore të Frankofonisë në Yaounde 3-5 nëntor 2023. Delegacioni i Komitetit Olimpik të Kosovës që ka marrë pjesë në Lojërat e Frankofonisë, në Kinshasa të RDC, në vitin 2023, po ashtu ka komunikuar në frëngjisht.

Gjuhën frënge e përdorin edhe studiuesit dhe akademikët frankofonë të Kosovës që marrin pjesë në forume, konferenca, simpoziume ose aktivitete tjera akademike të organizuara nga institucionet akademike. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK) në gjirin e vet i ka disa anëtarë frankofonë të përkryer të cilët flasin frëngjisht edhe në forume ndërkombëtare. Duke u bërë anëtar i rregullt i Unionit Akademik Ndërkombëtar (Tokio, 2017), ku bëjnë pjesë mbi 100 akademi shkencash të 63 vendeve nga të gjitha kontinentet, përfaqësuesi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, në momentin e pranimit në atë Union, ka mbajtur fjalën e vet në gjuhën frënge. Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës është bërë anëtare e Unionit Akademik Ndërkombëtar me rekomandimin e Academie des Inscriptions et Belles Lettres. Përndryshe, ASHAK është pjesë edhe i ALLEA, Federatës së Akademive.

Gjuha frënge do të përdoret edhe nëpër universitete verore që organizojnë universitetet e Kosovës. Kësisoj, Rektori dhe Prorektorja për Marrëdhënie me Jashtë e Universitetit të Prishtinës kanë premtuar se sapo të sigurohen fondet do të mundsohet mbajtja e së paku dy kurseve akademike në kuadër të Universitetit Veror të Prishtinës. Diçka të ngjashme kanë premtuar edhe drejtuesit e Universitetit "Haxhi Zeka" të Pejës.

Gjuha frënge përdoret edhe në aktivitetet ndërkombëtare siç janë Lojërat e Frankofonisë, Lojërat Olimpike që do të mbahen në Paris në vitin 2024, por edhe Lojërat Mediterane për të cilat tashmë kryeqyteti i Kosovës Prishtina ka fituar kandidaturën për vitin 2030. Programi i Lojërave Mesdhetare përfshin 24 sporte dhe pjesëmarrje të afër 5000 sportistëve, gjë që nënkupton një pjesëmarrje të madhe të sportistëve nga vendet frankofone. Komiteti Olimpik i Kosovës ka në gjirin e vet anëtarë frankofonë dhe interesimi për mësimin e Gjuhës frënge sigurisht se do të rritet akoma tash pas fitimit të kandidaturës së Prishtinës për Lojërat Mediterane 2030.

Në muajin Janar 2023, pesë Komitete Olimpike Kombëtare nga Kosova, Shqipëria, Franca, Maqedonia Veriut dhe Mali i Zi kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit "Balkan Cooperation 5". Memorandumi u nënshkrua në Prishtinë nga presidenti i KOK-ut në Kosovë, Ismet Krasniqi, nënpresidenti i KO të Francës, Pierre Siutat, presidenti i KOKSh-it, Fidel Ylli, presidenti i KO të Maqedonisë së Veriut, Daniel Dimevski dhe sekretari i përgjithshëm i KO të Malit të Zi, Igor Vushuroviq. Memorandumi parasheh bashkëpunim në çështje të ndryshme që lidhen me Lojërat Olimpike Paris 2024.

- **Indikacione për pjesëmarrjen në mekanizmin e monitorimit, alarmit dhe veprimt në favor të gjuhës frënge dhe të shumëgjuhësisë në organizatat ndërkombëtare,**

veçanërisht përmes Grupeve të Ambasadorëve Frankofonë (GAF): Kliko këtu për të shkruani tekstin.

Angazhimi i përfaqësuesve diplomatikë të Republikës së Kosovës në GAF dëshmon angazhimin e Republikës së Kosovës në respektim të parimit të shumëgjuhësisë. Me datë 20 mars 2023, me ftesë të Grupit të Ambasadorëve Frankofonë dhe Institutit të Frankofonisë për Edukim dhe Trajnim në Dakar, I ngarkuari me punë z. Sami Halili nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Senegal ka marrë pjesë në pritjen për nder të ditës së Frankofonisë. Më datë 8 maj, ARKS në Senegal ka marrë pjesë në gala mbrëmjen e organizuar nga Instituti i Frankofonisë për Edukim dhe Trajnim në Dakar, me 21 maj 2023.

Ambasadori i Republikës së Kosovës në Bruksel ka marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga Grupi i Ambasadorëve Frankofonë, gjegjësisht në Asamblenë e Përgjithshme të Grupit të Ambasadorëve Frankofonë, më 10 tetor 2022 në Bruksel. Takimi ka pasur për qëllim shkëmbimin mbi temat e interesit të përbashkët dhe mbi aktivitetet dhe perspektivat e Grupit të Ambasadorëve frankofonë në Bruksel si në planin dypalësh njëashtu edhe në lidhje me agjendën ndërkombëtare të Frankofonisë.

Republika e Kosovës njihet dhe ftohet në baza të rregullta në të gjitha aktivitetet që GAF organizon në Kanada. Siç jeni në dijeni GAF udhëhiqet përmes Kordinatorëve në baza rotative nga përfaqësues të shteteve anëtare. GAF në Kanada, në periudhën e fundit 6 mujore është udhëhequr nga Senegali dhe aktualisht udhëhiqet nga Belgjika. Aktivitetet e GAF që ambasada në Otavë është ftuar dhe ka marrë pjesë me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Frankofonisë me temën "Ekonomia dixhitale në hapësirën frankofone. Poashtu Ambasada në Otava ka marrë pjesë në takimin plenar të GAF. Pjesëmarrje në takim të ftuar nga GAF me rastin e vizitës së përfaqësuesës së Organizatës së Frankofonisë për rajonin e amerikave. Nën organizim të GAF dhe Qeverisë së Provincës së Quebec është organizuar darkë formale për ambasadorët e akredituar në Kanada dhe që janë anëtarë të GAF me Kryeministrin e Provincës së Quebec Françoise Legault.

Nën organizim të GAF dhe Qeverisë së Provincës Quebec është organizuar aktivitet në kuadër të Programit Diplomantik të Ndërgjegjësimit (PRD) me 11 shtator 2023 në qytetin Gatineau. Ky aktivitet do të synojë të mobilizojë trupin diplomatik dhe konsullor dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në arritjen e objektivave të Planit Strategjik të Ministrisë 2023-2027 dhe vizionit ndërkombëtar të Québec-ut.

Po ashtu në kuadër të politikave dhe rregullave për anëtarësinë në GAF, çdo anëtar ka për obligim pagesën e anëtarësisë vjetore, të cilën ambasada jonë e ka paguar në fillim të këtij viti.

Që nga janari vitit 2022, Ambasadorja e RKS-së në Republikën e Çekisë znj. Iberhysaj ka marrë pjesë aktivisht në pothuajse të gjitha aktivitetet e organizuara nga institucionet çeke dhe anëtarët frankofonë të Korit Diplomantik. Grupi është themeluar vitin e kaluar dhe deri më tani janë mbajtur disa aktivitetet, takime që kanë pasur për qëllim konstituimin e plotë të grupit.

- *Pjesëmarrja e Ambasadores në ngjarjen e organizuar nga Ambasada e Tunizisë në Pragë, për nder të hyrjes së ishullit turistik tunizian të Djerba në listën e vendeve të trashëgimisë botërore të UNESCO s.(Aktivitet i mbajtur në muajin nëntor 2023).*
- *Pjesëmarrja e rregullt e Ambasadores Iberhysaj në takimin Cafe Frankofone, organizuar nga Ministria e Jashtme çeke, aktivitet i përmuajshëm me pjesëmarrje të frankofonëve të institucioneve çeke dhe misioneve diplomatike të akredituara në Pragë.*

- Pjesëmarrja e Ambasadores Iberhysaj në Javën e filmit të Luksemburgut, Francës në Pragë.
- Takimet e Ambasadores Iberhysaj me Drejtorin e Institutit francez në Pragë, me Ambasadorin e Francës, Belgjikës, Zvicrës, Luksemburgut, Tunizisë dhe përfaqësues çek frankofonë gjithnjë zhvillohen në gjuhën frënge.
- Në bashkë organizim me Ministrinë e Jashtme çeke, Ambasada e Kosovës në Pragë mbajti ngjarjen kulturore- diplomatike «Cafë francophone » me të ftuarin e nderit Avdi Visoka, profesor dhe studiues shumëvjeçar i gjuhës dhe letërsisë frënge në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë. Profesor Visoka para frankofonëve të institucioneve çeke dhe misioneve diplomatike të akredituara në Pragë prezantoi mbi letërsinë e Kadares, Kunderës dhe Camus, fuqinë e letërsisë dhe triumfin ndaj diktaturës dhe tiranisë. Ngjarja u organizua me qëllim të mbështetjes së procesit të anëtarësimit të Kosovës në anëtar i plotë i Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë.
- Pjesëmarrja e Ambasadës në organizimin e eventit të bashkërenduar nga Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë dhe Instituti francez në Pragë me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Frankofonisë (mars 2023). Kosova u përfaqësua ne eventin e lartcekur krahas shteteve të tjera anëtare të frankofonisë, përkatësisht Ambasadave në Pragë me ushqim tradicional, pije dhe material promovues.

Ambasada në Pragë ka planifuar që të marrë pjesë aktive në aktivitetet e Frankofonisë në Pragë gjatë vitit 2024, me synimin e avancimit të statusit të Kosovës në këtë organizatë. Në këtë kuadër planifikohet vazhdimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes në takimet e Grupit të Ambasadoreve Frankofonë në Pragë, sigurimi i pjesëmarrjes së Kosovës në aktivitetet e organizuara nga ONF.

- Këtë vit gjatë muajit mars Ambasada ka planifikuar pjesëmarrjen në ditët e frankofonisë në Pragë. Me këtë rast planifikohet shfaqja e filmit HIVE i regjisores Blerta Basholli i titruar në gjuhën frënge dhe në pajtim me fushat që këtë vit trajton organizata e frankofonisë, ndër të cilat edhe sporti, synohet të sensibilizohet opinioni çek e frankofon sa i përket Kosovës që do të jetë organizatore e Lojërave Mesdhetare për vitin 2030 – **“Prishtina 2030”**. Ambasada është në finalizim e sipër të detajeve, ndërsa pjesëmarrja dhe shfaqja e filmit janë konfirmuar.

Në mars të vitit 2021, Konsullata e Përgjithshme në Nju Jork, në bashkëpunim me Misionin e Përhershëm të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë në Kombet e Bashkuara, mundësuam pjesëmarrjen e Kosovës në : Festivalin Letrar Frankofonë të Pesë Kontinenteve, ku znj. Nerimane Kamberi, profesoreshë e nderuar dhe letrare e njohur e botës frankofone ishte pjesëmarrëse e kësaj ngjarje të rëndësishme, që u realizua në kuadër të aktiviteve për nder të muajit të frankofonisë. Në këtë ngjarje, krijimtarinë e tyre letrare e paraqiten 11 autore femra nga 10 shtete pjesëmarrëse.

Në mars të vitit 2023, Ambasada e Republikës së Kosovës në Bangladesh së bashku me ambasadat e Francës, Zvicrës, Kanadës, Marokut, Vietnamit, Algjerisë dhe Egjiptit, ka marr pjesë në Festivalin e Frankofonisë në Bangladesh. Në kuadër të festivalit më datën 15 mars 2023 në hapësirat e Alliance Française në Daka është shfaqur dokumentari i regjisorit kosovar Genc Berisha, i titulluar, “Okarina e Runikut”. Në cilësinë e Shefit të Misionit diplomatik të RKS-së në Daka, z. Guner Ureya, ka marrë pjesë edhe në fazën përgatitore të festivalit e

koordinuar nga ambasadorja Franceze, Sh.S.znj. Marie Masdupuy, por edhe në aktivitetin përmbyllës.

Gjatë vitit 2023 dhe gjatë këtij viti, Ambasada e Republikës së Kosovës në Uashington, D.C. i ka kushtuar një vëmendje të veçantë pjesëmarrjes aktive në eventet, aktivitetet dhe takimet që lidhen me veprimtarinë e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë (ONF/OIF), Grupit të Ambasadorëve Frankofonë (GAF) si dhe në Festivalin Kulturor të Frankofonisë 2024. Në këtë kontekst, Ambasadori i Kosovës në SHBA, z. Ilir Dugolli ka marrë pjesë në takimet e Grupit të Ambasadorëve Frankofonë në Uashington, D.C. si dhe në eventet e organizuara në kuadër të këtij Grupi. Ndërkaq, sa i takon Festivalit Kulturor të Frankofonisë 2024, të organizuar nga Aleanca Franceze dhe Smithsonian Associates, Ambasada e Republikës së Kosovës në Uashington, për të dytin vit me radhë, ka qenë ndër shtetet pjesëmarrëse në eventet e organizuara. Me këtë rast mund të veçojmë këto aktivitete:

- Më 2 maj 2023, Ambasadori Dugolli mori pjesë në aktivitetin e shënimit zyrtar të themelimit të Grupit të Ambasadorëve të Frankofonë në Uashington, D.C., ku pati mundësinë të zhvillojë edhe një bisedë me Sekretaren e Përgjithshme të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë, znj. Louise Mushikiëabo si dhe me të pranishëm të tjerë.

- Më 22 dhe 23 shtator 2023, duke qenë se Ambasadori Dugolli ka qëndruar në Nju Jork në kuadër të sesionit të 78-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Këshilltari Drilon Zogaj ka marrë pjesë në një bashkëbisedim të organizuar nga Instituti i Paqes i Shteteve të Bashkuara me Sekretaren e Përgjithshme të OIF, L. Mushikiëabo, ku është biseduar për temat kryesore aktuale me të cilat ballafaqohet kjo organizatë në këtë fazë si dhe ka përfaqësuar Ambasadën në një mëngjes pune me Sekretaren e Përgjithshme Mushikiëabo, ku është biseduar gjerësisht për objektivat dhe misionin e kësaj organizate në periudhën në vijim.

- Më 4 tetor 2023, Ambasadori Dugolli mori pjesë në takimin e Grupit të Ambasadorëve Frankofonë në Uashington, D.C., i kryesuar nga Ambasadorja e Tunizisë, Hanène Tajouri Bessassi, ku gjatë takimit të zhvilluar në Ambasadën Franceze është biseduar rreth vizitës së fundit të Sekretares së Përgjithshme të ONF dhe mbi programin e aktiviteteve.

- Më 9 shkurt 2024, Ambasadori Dugolli ka marrë pjesë në takimin e Grupit të Ambasadorëve Frankofonë, e organizuar në Ambasadën e Kosta Rikës në Uashington, D.C. Në takim është biseduar për aktivitetet që po zhvilloheshin në kuadër të Frankofonisë, në të cilat për vitin e dytë me radhë mori pjesë edhe RKS, duke përfshirë përgatitjet për muajin e Frankofonisë, për prioritetet në vitin 2024 dhe temat tjera.

- Më 27 shkurt 2024, duke qenë se Ambasadori Dugolli ka qenë për vizitë zyrtare në Minnesota, Ministri Këshilltar Bujar Maxhuni dhe Këshilltari Drilon Zogaj kanë marrë pjesë në pritjen e mbajtur në Ambasadën e Republikës së Kongos, me rastin e nisjes së Festivalit Kulturor të Frankofonisë 2024.

- Më 29 shkurt 2024, ARKS në Uashington ka marrë pjesë si një ndër shtetet pjesëmarrëse në Ekspozitën e Artit e titulluar "aVENues of Connection and the Art of Francophone Eöorld" të zhvilluar në kuadër të Festivalit të Frankofonisë 2024. Ekspozita me një fotografi nga Kosova, do të jetë e hapur deri më 31 mars.

- Më 1 mars 2024, ARKS në Uashington për të dytin vit me radhë mori pjesë me një poezi në Natën e Poesisë (La Nuit De La Poesie/Poetry Night) që u zhvillua në Ambasadën e Francës në Uashington, D.C. në kuadër të Festivalit të Frankofonisë. Ambasada po ashtu ishte pjesë e

aktivitetit pasues që karakterizohet nga testimi i verërave të disa vendeve. Ambasada e Republikës së Kosovës do të marrë pjesën edhe në eventin "Le Grande Fete De La Francophonie", që do të zhvillohet në kuadër të Festivalit të Frankofonisë më 22 mars 2024, dhe do të zhvillohet në Ambasadën e Francës në Uashington, D.C.

Në këtë event pritet të marrin pjesë mbi 35 ambasada dhe të vizitohet nga mbi një (1) mijë persona. Këshilltari Drilon Zogaj dhe Sekretari i Dytë Anell Bajra kanë marrë pjesë edhe në takimet e rregullta periodike koordinuese që janë mbajtur për organizimin e Festivalit Kulturor të Frankofonisë 2024. Në këtë aspekt, përveç koordinimit të pjesëmarrjes së Ambasadës në evente është punuar edhe për prezantimin adekuat të Republikës së Kosovës në faqen zyrtare dhe aspektet tjera të Festivalit.

III. KRITERET DHE TË DHËNAT QË LIDHEN ME NDARJEN DHE PROMOVIMIN E DEMOKRACISË, TË DREJTAVE DHE LIRIVE

Në frymën e Deklaratës së Bamakos, shteti ose qeveria kandidatë duhet të përcaktojë angazhimin që merr përsipër në promovon respektimin e demokracisë, të drejtave dhe lirive, në veçanti:

- **Statusi i ratifikimit dhe zbatimit të konventave ndërkombëtare kryesisht në përputhje me vlerat e Frankofonisë (në përputhje me listën në shtojcën më poshtë): Klikoni këtu për të futur tekstin.**

Republika e Kosovës, përmes kushtetutës së saj të miratuar më 2008 ka paraparë një standard të lartë të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore. Të drejtat dhe liritë e njeriut të parapara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare garantohen me Kushtetutë dhe zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Disa prej këtyre konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare përfshijnë një pjesë të konventave kryesore ndërkombëtare që mishërojnë edhe vlerat e Frankofonisë. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh zbatimin e drejtpërdrejtë të tyre në rendin juridik të Kosovës. Poshtu, më 25 shtator 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Amendamentin kushtetues nr. 26 përmes të cilit, listës së instrumenteve ndërkombëtare drejtpërdrejtë të zbatueshme në rendin juridik të Kosovës i shtohet edhe Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje. Për më tepër, Kushtetuta e Republikën e Kosovës garanton që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore interpretohen në pajtim me vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (neni 53). (ANEX 21).

- **Dispozitat kryesore kushtetuese dhe legjislative në favor të konsolidimit të demokracisë dhe informacionet në lidhje me procesin e rregullt të zgjedhjeve të lira, të besueshme dhe transparente, të hapura për të gjitha palët ligjërish të bazuara dhe për shtetasit e të dy gjinive: Klikoni këtu për të futur tekstin.**

Sistemi zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme është i përcaktuar sipas Kushtetutës së Kosovës dhe sipas disa ligjeve specifike që rregullojnë në tërësi procesin zgjedhor. Aktet normative të cilat rregullojnë procesin e organizimit, administrimit dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve janë Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji për Zgjedhjet Lokale, Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, rregullat zgjedhore të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe rregullorja e punës së KQZ-së.

Sistemi që aplikohet për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës është sistem proporcional i përfaqësimit, me lista të hapura të kandidatëve nga subjektet politike dhe me mandat 4 vjeçar. Republika e Kosovës është një zonë e vetme zgjedhore, ku subjektet politike garojnë për 120 ulëset e Kuvendit të Kosovës, prej të cilave 10 janë të garantuara për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetin serb, ndërsa 10 të tjera janë të garantuara për subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet tjera jo-shumicë, përfshirë 3 ulëse për komunitetin boshnjak, 2 për komunitetin turk, 1 për komunitetin rom, 1 për komunitetin ashkali, 1 për komunitetin egjiptian, 1 vend për komunitetin rom, ashkali ose egjiptian, bazuar në numrin më të madh të votave të fituara nga komuniteti përkatës, si dhe 1 për komunitetin goran.

Sipas nenit 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, çdo shtetas i Republikës së Kosovës është i barabartë në ushtrimin e të drejtës për të votuar dhe për t'u zgjedhur pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji; Të gjitha subjektet politike dhe organet zgjedhore janë të obliguara t'i respektojnë kërkesat për kuotën e gjinisë siç përcaktohet me këtë ligj;

KQZ, në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, kujdeset që çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhjet, se vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Ndërsa, e drejta e votës mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor. Pragu zgjedhor për të gjitha subjektet politike që garojnë në zgjedhje është 5%. Ndërsa, për subjektet politike të cilat garojnë për ulëset e garantuara nuk aplikohet fare prag zgjedhor.

Zgjedhjet komunale mbahen çdo katër vjet për t'i zgjedhur kryetarët e komunave dhe anëtarët e kuvendeve komunale. Kryetarët e 38 komunave zgjedhën drejtpërdrejt nga votuesit e komunës në një sistem të shumicës me dy runde. Anëtarët e kuvendeve komunale zgjedhën sipas sistemit të përfaqësimit proporcional, me lista të hapura.

Bazuar në aktet ligjore në fuqi, Kosova aplikon kuotë të dyfishtë gjinore. Kuota e parë aplikohet në listat e dorëzuara për certifikim nga subjektet politike, që parasheh që të paktën 30% e listës së secilit subjekt politik duhet të jetë e përbërë nga gjinia më pak e përfaqësuar. E njëjta kuotë zbatohet edhe në ndarjen e ulëseve në Kuvendin e Kosovës. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) në Republikën e Kosovës përcakton sistemin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin, mbrojtjen e të drejtës për të votuar, kriteret për pramueshmërinë e votës, mirëmbajtja e listës së votuesve, regjistrimin dhe certifikimin e subjekteve politike, përgjegjësitë dhe funksionimin e KQZ-së, organizimin dhe funksionimin e komisioneve komunale zgjedhore dhe këshillave të vendvotimeve, rregullat për akreditimin e vëzhguesve, kufizimet e shpenzimeve për fushatë dhe obligimet për publikim financiar, mbulimin e fushatës zgjedhore nga mediat, Kodin e mirësjelljes të subjekteve politike, kandidatëve dhe mbështetësve, procedurat e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve, si dhe aspekte tjera lidhur me procesin zgjedhor në Kosovë.

Ligji për Financimin e Subjekteve Politike rregullon administrimin, shpenzimet, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin financiar të subjekteve politike para, gjatë dhe pas fushatës zgjedhore. Më konkretisht, përmes këtij ligji specifikohen në detaje çështjet financiare dhe shpenzimet e subjekteve politike, përfshirë këtu edhe kohën e zgjedhjeve. Ndër specifikat kryesore të këtij ligji janë rregullimi i aspekteve rreth statusit të subjektit politik, burimet financiare dhe materiale të subjekteve, forma e kontributeve për subjektet politike, fondi për mbështetjen e subjekteve politike që alokohet nga buxheti i shtetit dhe të ngjashme.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës në një kapitull të tërë, i përbërë nga 11 nene lidhur me të drejtën e votimit, përcakton të gjitha veprat penale kundrejt procesit zgjedhor. Disa nga veprat penale që sanksionohen me Kodin Penal janë: ndalimi ose pengimi i personit nga kandidimi në zgjedhje, pengimi i kandidatit nga aktivitetet e fushatës, pengimi i votuesit gjatë votimit ose ndikimi në vendim, ndërmjetësimi i ryshfetit për favor të votave, votimi ose tentativa për të votuar në emër të dikujt tjetër, shpërdorimi i detyrës zyrtare të stafit zgjedhor, votimi i dyfishtë, pengimi ose ndalimi i paligjshëm i procesit të votimit, shkelja e privatësisë në votim, falsifikimi i rezultateve, dëmtimi i dokumenteve të votimit dhe të tjera. Legjislacioni sekondar, i cili zgjeron parimet e përfshira në ligjet që rregullojnë zgjedhjet, është miratuar nga KQZ-ja

përmes rregullave zgjedhore me anë të së cilave rregullohen aspekte të caktuara të procesit zgjedhor. KQZ-ja ka miratuar rregulla zgjedhore dhe udhëzime administrative që adresojnë aspekte të ndryshme të procesit Zgjedhor.

- **Dispozitat kryesore kushtetuese dhe legjislativë në favor të respektimit të të drejtave të njeriut: *Kliko këtu për të futur tekstin.***

Republika e Kosovës, nëpërmjet kuadrit të saj kushtetues dhe ligjor, është e përkushtuar të zbatoj standardet universale të të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët e saj.

Objektiv strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës mbetet hartimi dhe zbatimi efektiv i legjislacioneve dhe politikave që përmirësojnë dhe përmbushin të drejtat dhe shërbimet e qytetarëve në vend, me fokus në grupet më të marginalizuara të shoqërisë, duke përfshirë fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, personat e pagjetur (zhdukur), viktimat e dhunës seksuale, të moshuarit, komunitetet joshumicë, komunitetin (LGBTI), të kthyerit, personat e zhvendosur gjatë luftës etj. Nga ky këndvështrim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës është ndër kushtetutat më miqësore në botë ndaj të Drejtës Ndërkombëtare në përgjithësi dhe veçanërisht ndaj të Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban shumë dispozita në lidhje me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Neni 3 i Kushtetutës përcakton se autoritetet publike në Kosovë sigurojnë barazinë e të gjithë individëve para ligjit dhe respektimin e plotë të “të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht”. Neni 7 përcakton që rendi kushtetues i Kosovës bazohet, mes tjerash, në parimet e barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe mosdiskriminimit, dhe mishëron barazinë gjinore si vlerë themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë.

Kapitulli II i Kushtetutës përcakton dispozita specifike që mbrojnë të drejtat civile dhe politike (p.sh., e drejta për jetën, të drejtat për proces të rregullt gjyqësor, e drejta e privatësisë dhe liria e shprehjes, liria e tubimit paqësor, liria e asociimit dhe liria e lëvizjes), si dhe disa të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore (p.sh., e drejta për arsim dhe liria e zgjedhjes së profesionit). Edhe pse Kosova nuk mund të bëhet zyrtarisht palë në konventat dhe mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, neni 22 i Kushtetutës përcakton instrumente të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara (KB) dhe rajonale të cilat zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë, duke ofruar kështu burime plotësuese ligjore që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut në Kosovë.

Në një zhvillim të rëndësishëm për të drejtat e grave dhe vajzave, në shtator 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës ndryshoi nenin 22 të Kushtetutës, duke e shtuar Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) në listën e instrumenteve të të drejtave të njeriut që zbatohen drejtpërdrejt. Edhe pse Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK), mbetet jashtë Kushtetutës së vendit, Kuvendi i Kosovës e ka adoptuar Agjendën e vitit 2030 dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në një rezolutë unanime me 24 janar 2018, duke siguruar një pikënisje të mirë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore në Kosovë.

Qeveria e Kosovës ka inicuar procesin për plotësim-ndryshimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 22 për përfshirjen e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Së fundi, më 27.06. 2023 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligji nr. 08/L-232 për aderimin në Marrëveshjen për Statusin dhe Funkcionet e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (Ligji nr. 08/L-232). Instrumenti i aderimit është depozituar në Ministrinë Punëve të Jashtme të Holandës, në Hagë.

Në vitin 2015, Kosova bëri progres të mëtutjeshëm në përafrimin e kornizës së saj ligjore me standardet ndërkombëtare, kur miratoi pakon e ligjeve themelore për të drejtat e njeriut, gjegjësisht, Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligjin nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore dhe Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Padyshim zbatimi i plotë i tyre është thelbësor për zbatimin efektiv të kornizës së të drejtave të njeriut në Kosovë. Kosova ka edhe ligje të tjera më specifike lidhur me mbrojtjen e të drejtave ose grupeve të caktuar të personave si: Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Ligji nr. 06/l-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Ligji nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit; Ligji nr. 08/l-035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-017 për Ndihmë Juridike falas.

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e 159-të me datë 12.09.2023 ka miratuar Raportin e Vlerësimit Ex-Post për Ligjin Nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, ku si rekomandim ka dalur plotësim ndryshimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, konkretisht fuqizimi i mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në rrjedh të kësaj Zyra e Kryeministrit ka filluar hartimin e Projektligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi i cili është përfshirë në Programin Legjislativ për vitin 2024.

Janë miratuar ligjet të cilat mbulojnë fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore: Ligji nr. 03/l-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 02/l-37 për përdorimin e gjuhëve, si dhe Ligji nr. 03/l-039 për zonat e veçanta të mbrojtura, Ligji nr. 02/l-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, Ligji nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, Ligji nr. 04/L-196 për Fshatin Zym i Hasit, Ligji nr. 04/L-62 për Fshatin Hoçë e Madhe.

Ndërkaq sipas Neni 108 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian “Palët marrin përsipër të nxisin bashkëpunimin kulturor. Ky bashkëpunim do të shërben për të fuqizuar kapacitetin e politikës kulturore, forcimin e kapacitetit të operatorëve kulturor dhe përmirësimin e mirëkuptimit të ndërsjellët midis individëve, minoriteteve dhe popujve. Bashkëpunimi gjithashtu do të mbështet reformat institucionale për të promovuar shumëllojshmërinë kulturore, veçanërisht në bazë të parimeve në kuadrin e Konventës së UNESCO-s për mbrojtjen dhe nxitjen e larmisë të shprehjeve kulturore, të miratuar në Paris më 20 tetor 2005”.

Kosova ka krijuar organe dhe mekanizma të veçantë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Mekanizmat e të drejtave të njeriut janë krijuar duke u bazuar në një qasje holistike, ku zyrtarë të të drejtave të njeriut janë emëruar në çdo institucion në nivel lokal dhe qendror, të gjithë të koordinuar nën Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZKM). Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim (ZQM) harton politika në fushat e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe kundër diskriminimit mbikëqyr, këshillon dhe rekomandon Ministrinë në fushat e përmendura. Republika e Kosovës gjithashtu ka themeluar Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Komisionerin e Gjuhëve, Agjencinë për Barazi Gjinore dhe Institucionin e Avokatit të Popullit, Agjensionin për Informim dhe Privatësi si mekanizëm ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe

promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik. Institucioni i Avokatit të Popullit është organ i pavarur kushtetues me mandatin për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve nga shkeljet e autoriteteve. Në përmbushjen e mandatit, LAP-ja, veç tjerash, mund të pranojë ankesa, të nisë hetime, të bëjë rekomandime dhe të publikojë raporte, si dhe të avokojë për ndryshime që përmirësojnë zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut, njëherit vepron edhe si Mekanizëm Kombëtar për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, në të gjitha institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione është një nga komisionet e përhershme të Kuvendit të Kosovës, i cili ka mandatin për të hartuar ligje dhe për të monitoruar zbatimin e tyre.

Grupi Koordinues Ndër-institucional për të Drejtat e Njeriut, është një mekanizëm politik i nivelit të lartë i cili udhëhiqet nga Zëvendëskryeminstria për çështje të pakicave dhe drejtat e njeriut, Znj.Emilija Rexhepi, dhe është përgjegjës për prioritizimin, zhvillimin dhe koordinimin e politikave të Qeverisë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Reforma në Administratën Publike mbetet prioritet i lartë i Qeverisë së Kosovës. Përpyekjet e vazhdueshme janë të orientuara në zhvillimin e reformave në administratën publike bazuar në ofrimin e mundësive të barabarta, trajtimit të barabartë, transparencës dhe llogaridhënies. Në këtë kontekst, respektimi i Institucionit të Avokatit të Popullit si institucion i pavarur i shtetit i mandatuara për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe zbatimi i rekomandimeve të tij mbetet prioritet dhe angazhim i vazhdueshëm i Qeverisë së Kosovës. Qeveria e Kosovës, është duke i dhënë prioritet raportimit dhe zbatimit të rekomandimeve që i adresohen Qeverisë nga trupat e ndryshme ndërkombëtare, lidhur me zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare të cilat janë pjesë e ligjit të aplikueshëm në Kosovë. Megjithatë, angazhim dhe përkushtim më i madhë na pret sidomos në adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve që Qeverisë i adresohen nga mekanizmat e ndryshëm ndërkombëtar, raportuesve special të Kombeve të Bashkuara, organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që monitojnë dhe vlerësojnë performancën dhe transparencën e qeverisë karshi zbatimit të standardeve ndërkombëtare, ligjeve dhe politikave në fushën e të drejtave të njeriut.

Duhet shtuar që janë hartuar dhe miratuar një mori e dokumenteve - Programeve dhe Strategjive në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe të njëjtat janë në proces të zbatimit: Strategjia dhe Plani Kombëtar për Zhvillim 2023, Strategjia për Sundimin e Ligjit (2021-2026), Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave(2022-2026), Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 dhe Plani i Veprimit, Programi për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (2021-2025 dhe Plani i Veprimit tre vjeçar (2021-2023) për zbatimin e tij, Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës (2021-2023), në kuadër të Strategjisë Nacionale Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2023), Strategjia për avancimin e të drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës për vitet 2022-2026 dhe Plani i veprimit të saj për vitet 2022-2024, Strategjia Qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023.

Gjithashtu, hartimi i Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale 2023-2028 dhe themelimi i Institutit për Dokumentimin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë janë objektivat kryesore në kuadër të ballafaqimit me të kaluarën tonë. Me anë të këtij dokumenti strategjik synohet të vendoset një kornizë gjithëpërfshirëse për trajtimin e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut

dhe të drejtës humanitare ndërkombëtare që i shërben realizimit të të drejtave të viktimave dhe ndërtimit të një të ardhme paqësore.

• Reformat e kryera gjatë dhjetë (10) viteve të fundit në favor të vendosjes dhe konsolidimit të shtetit të së drejtës: *Kliko këtu për të futur tekstin.*

Në dhjetë vitet e fundit janë zhvilluar politika të shumta në fushën e drejtësisë të cilat janë materializuar me hartimin e legjislacionit përkatës dhe reformimin apo funksionalizimin e mekanizmave të rëndësishëm për sistemin e drejtësisë, siç janë:

Sistemi gjyqësor dhe prokurorial - Më 1 janar 2013, në Kosovë ka filluar funksionimi i strukturës së re të gjykatave dhe prokurorive. Struktura e re e gjykatave përbëhet nga Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, ndërkohë që brenda juridiksionit të Gjykatës Themelore janë krijuar departamentet përkatëse. Ndërsa, krahas sistemit gjyqësor, më 1 janar 2013 ka filluar së funksionari edhe sistemi i ri prokurorial i përbërë prej: Prokurorive Themelore, Prokurorisë së Apelit, Prokurorisë Speciale dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Profesionet e Lira - Në këtë periudhë janë bërë hapa të rëndësishëm në funksionalizimin dhe avancimin e profesioneve të lira në Kosovë. Për herë të parë kanë filluar punën noterët, ndërmjetësuesit, përmbaruesit privat dhe administratorët falimentues. Gjatë kësaj periudhe janë themeluar edhe Odat përkatëse, si Oda e Noterëve, Oda e Përmbaruesve Privat, Oda e Ndërmjetësuesve dhe Oda e Administratoreve Falimentues.

Kompensimi i Viktimave të Krimeve të Luftës - Është zhvilluar politika dhe është materializuar me legjislacion përkatës Kompensimi i Viktimave të Krimit, mekanizëm i cili mundëson që viktimat e krimit të kenë vëmendjen financiare nga shteti duke iu ofruar ndihmë në fazat fillestare deri në realizimin e të drejtave nga kryesi i veprës penale.

Kodifikimi i fushës civile - Është hartuar Projekt Kodi Civil, i cili përbën një reformë të rëndësishme në rregullimin e fushës së marrëdhënieve juridike civile. Në kuadër të kësaj reforme, janë inkorporuar edhe përmes dispozitave ligjore standarde ndërkombëtare të cilat janë me ndikim në zhvillimin ekonomik, investimet e huaja, qasje në drejtësi dhe krijim të sigurisë juridike. Është hartuar politika e transmetuar përmes Koncept Dokumentit për fushën e Procedurës Civile. Kjo është reformë me shumë rëndësi dhe do të ketë ndikim direkt në qasjen në drejtësi, zbritje të numrit të lëndëve në gjykata dhe shkurtim të procedurave gjyqësore. Duke ju referuar gjitha këtyre, mund të themi se përmes kësaj reforme do të kemi zhvillim dhe avancim të sistemit juridik, dhe si rrjedhojë shtim të sigurisë juridike në Republikën e Kosovës.

Themelimi i Gjykatës Komerciale - Me miratimin e Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale është themeluar dhe funksionalizuar Gjykata Komerciale, e cila vendos për të gjitha kontestet tregtare dhe konfliktet administrative që janë në kompetencë të saj.

Gjykata Administrative dhe të Punës - Pas miratimit të Koncept-Dokumentit është themeluar Grupi Punues për hartimin e Projektligjit me miratimin e së cilit do të hapet rruga për themelimin e Gjykatës Administrative dhe asaj të Punës.

Drejtësia Penale - Në fushën e drejtësisë penale gjatë kësaj periudhe janë hartuar dhe miratuar: kodet - ligjet e reja, siç në vijim: Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale; Ligji nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; Ligji nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues

të Kosovës; Ligji nr. 08/L-129 për Shërbimin Sprovues të Kosovës; Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës; Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të mitur.

Ndër reformat tjera në fushën e drejtësisë duhet veçuar edhe miratimin e Projektligjeve, si:

- Ligji nr. 08/L-177 për Institutin e Krimeve të kryera gjatë Luftës në Kosovë;
- Ligji nr. 08/L-155 për Sanksionet e shënjestruara kundër shkelësve të huaj të drejtave të njeriut;
- Ligji nr.08/L-028 për të Drejtën Ndërkombëtare Private;
- Ligji nr. 08/L-020 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Civile;
- Ligji nr. 08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në republikën e Kosovës;
- Ligji nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Ligji nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë;
- Ligji nr. 06/L -085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve;
- Ligji nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë;
- Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje;
- Ligji nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar;
- Ligji nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale;
- Ligji nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore.

Vetingu në drejtësi - Miratimi i Koncept Dokumentit për zhvillimin e procesit të Vetingut në Sistemin e Drejtësisë ka mundësuar fillimin e procesit për ndryshimet e nevojshme kushtetuese e ligjore për veting në drejtësi.

Projektligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificuar

Fusha e Anti-Korrupsionit - Ligji nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (21.7.2022); Ligji nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.

Strategjitë - Gjatë kësaj periudhe kohore janë miratuar strategjitë si në vijim: Strategjia për Sundimin e Ligjit; Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje; Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë; Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë.

Projektligjet në proces të miratimit: Projektligji për Tokën Ndërtimore; Projektligji për Pronën Publike; Projektligji për Kontestet Administrative; Projektligji për Përfaqësimin e institucioneve shtetërore në procedura gjyqësore dhe arbitrazh; Projektligji për Falimentimin.

• **Legjislacioni kombëtar që garanton lirinë e shtypit dhe audiovizuelës: *Klikoni këtu për të shtypur tekstin.***

Republika e Kosovës përfiton nga një mjedis i gjallë dhe pluralist mediatik dhe korniza e saj ligjore është kryesisht në përputhje me standardet evropiane. Indeksi i fundit i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor tregoi që korniza ligjore në Kosovë është e mjaftueshme, megjithatë Kosovës i mungon zbatimi i ligjeve relevante¹. Sipas raportit të laripërmendur, Ligji Nr. 02/L-65 kundër Shpifjes dhe Fyerjes e përkufizon përgjegjësinë civile ndaj personave apo

¹ Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, Raport narrativ për Kosovën 2020

gazetarëve kur ka padë për shpifje apo fyerje. Korniza ligjore në Kosovë i ka dekriminalizuar shpifjen dhe fyerjen. Prandaj, gazetarët nuk mund t'iu nënshtrohen hetimeve penale për artikujt, raportet apo opinionet e tyre. Ligji civil nr. 02/L-65 kundër Shpifjes dhe Fyerjes është hartuar për t'iu zbatuar dhe interpretuar në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut si garanci për promovimin e lirisë së shprehjes dhe mendimit. Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes nuk parashikon sanksione, por ligji parashikon detyrim për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga të pandehurit përmes shpifjes dhe fyerjes. Autoriteteve publike u ndalohet të paraqesin kërkesë për kompensim për dëmin e shkaktuar nga shpifja ose fyerja. Zyrtarët publikë mund të paraqesin dëmshpërblim për shpifje ose fyerje vetëm privatisht dhe ekskluzivisht në cilësinë e tyre personale. Kosova ka shënuar përparim sa i përket lirisë së mediave, tregon Indeksi i Lirisë së Shtypit Botëror, i publikuar nga organizata Reporterët pa Kufij, me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, për lirinë e medias, në indeksin që përfshin 180 vende, Kosova radhitet në vendin e 56-të – një rritje prej 5 vendesh në krahasim me vitin e kaluar, kur radhitej në vendin e 61-të.

Në shenjë të solidarizimit me Ukrainën dhe me qëllim mundësim të ushtrimit të profesionit për gazetarët ukrainas, me kërkesën e MPJD-së, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndarë mjete buxhetore në vlerë 150 mijë euro për pranimin në Kosovë të 20 gazetarëve nga Ukraina (Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr 03/66, datë 1.03. 2022). Këto mjete janë ndarë me qëllim të strehimit të përkohshëm në Kosovë të gazetarëve nga Ukraina për 6 muaj. Ky projekt « Gazetarët në Rezidencë – Kosovë » implementohet bazuar në memorandumun e bashkëpunimit mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK). Duhet theksuar që përzgjedhja e gazetarëve është bërë nga Qendra Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias, dhe nga Federata Evropiane e Gazetarëve, bashkë me Qeverinë e Republikës së Kosovës duke i dhënë përparësi gazetarëve gra. (<https://ëëë.agk-ks.org/gazetaret-ne-residence-kosove/lajme/>).

• **Angazhimi për ruajtjen e paqes (kontributet, nëse ka, në ruajtjen e paqes operacionet paqëruajtëse) dhe angazhimin për ruajtjen e marrëdhënieve paqësore dhe fqinjësia e mirë, veçanërisht me Shtetet dhe qeveritë anëtare të ONF-së : *Klikoni këtu për të shtypur tekstin.***

Republika e Kosovës është një vend i cili kontribuon në ruajtjen e paqes në rajon dhe në botë. Politika e saj paqësore dhe e fqinjësisë së mirë, e orientuar kah Perëndimi ka ndikuar dukshëm në zgjidhjen e problemeve në rajon, sidomos sa i përket dialogut Kosovë - Serbi. Politika dhe angazhimi i Republikës së Kosovës në çështjet e ruajtjes së paqes dhe sigurisë në botë është në linjë me vlerat demokratike euro-atlantike të përfaqësuara nga demokracitë më të fuqishme dhe më të avancuara. Dialogu ka qenë dhe mbetet e vetmja rrugë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Serbinë. Kosova, e cila ka përjetuar një luftë të tmerrshme në vitet 1998-1999, e kupton shumë mirë se çka është paqja dhe në këtë kuadër ruajtja dhe kultivimi i saj është jetike për të. Përndryshe, përveç me Serbinë e cila akoma nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, me asnjë vend tjetër fqinjë Kosova nuk ka probleme, por përkundrazi, me secilin prej tyre ka marrëdhënie të mira fqinjësore. Dy prej vendeve fqinje të Kosovës (Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut) janë anëtare me të drejta të plota në ONF, Mali i Zi është vëzhgues, kurse Serbia, sikurse edhe Kosova është anëtar i asociuar.

Në bazë të Ligjit Nr.06/L-122, Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes (4 janar 2019) Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës kalon dhe riorganizohet si Ministri e Mbrojtjes në kuadër të

Qeverisë së Republikës së Kosovës me qëllim të administrimit, mbikqyrjes dhe kontrollit civil demokratik mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Në kuadër të angazhimeve në ruajtjen e paqës, Ministria e Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë vitit 2021 ka pasur bashkëpunim bilateral me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe bashkëpunim partneriteti me Gardën Kombëtare të Ioëa-s. Si rezultat i kësaj, në muajin maj 2021 kontingjenti i FSK-së ka zbarkuar në Kuvajti së bashku me Gardën Kombëtare të Ioëa-s. Flamuri i Republikës së Kosovës për herë të parë u ngrit në misionin paqësor të FSK-së në Kuvajti, si anëtar i koalicionit në Forcën e Përbashkët e Kombinuar (Inherent Resolve). (2 qershor 2021). Poashtu, më 21 tetor 2021, Republika e Kosovës ka arritur marrëveshje për statusin e forcave në mes të Republikës së Kosovës dhe Shtetit të Kuvajtit, me qëllim të lejimit të qëndrimit të përkohshëm dhe transit të Forcave të Sigurisë së Kosovës për të marrë pjesë në kuadër të misioneve të Forcave amerikane në Republikën e Irakut. Me këtë është treguar se Kosova është e përkushtuar për paqe dhe siguri në mbarë botën. FSK ka marrë pjesë në manovrat e shteteve të NATO-s, më 2022 dhe 2023 siç është operacioni « Defender Europe » dhe ashtu pritet të marrë pjesë edhe në të ardhmen (ANEX 22).

• **Çdo element shtesë që bën të mundur të tregojë, aty ku është e zbatueshme, përpjekjet në favor të zgjidhjes paqësore të konfliktit: Kliko këtu për të futur tekstin.**

Kosova tashmë ka një traditë në angazhimin e saj për zgjedhje paqësore të konflikteve. Pa u thelluar shumë në histori, duhet të theksojmë se pas rënies së murit të Berlinit dhe marrjes fund të regjimeve totalitare në Evropë (1989), Kosovës e cila atëherë ishte pjesë përbërëse e Federatës Jugosllave, iu pati marrë autonomia në mënyrë të dhunshme dhe të njëanshme. Për dhjetë vite radhazi, prej vitit 1989 deri në vitin 1998, Kosova ka bërë një rezistencë paqësore dhe ka bërë thirrje të vazhdueshme për dialog në mënyrë që të zgjidhet problemi i saj në mënyrë paqësore. Siç dihet Federata Jugosllave u shpërbë pas luftërave të përgjakshme në Slloveni, Kroaci, Bosnje e Hercegovinë, por më në fund edhe në Kosovë. Me qëllim të zgjidhjes paqësore të problemit ka marrë pjesë edhe nëpër Konferenca ndërkombëtare, siç ka qenë ajo e Rambujesë (Francë) në vitin 1999 dhe ka nënshkruar marrëveshjen e ndërmjetësuar nga pala ndërkombëtare. Pas luftës Kosova ka zhvilluar negociata (Bisedimet e Vjenës 2006-2007) me Serbinë me ndërmjetësim të Bashkësisë ndërkombëtare për të zgjidhur statusin e saj përfundimtar. Pas shpalljes së pavarësisë përsëri janë zhvilluar dialogu me Serbinë përsëri me ndërmjetësim nga Bashkimi Evropian dhe është arritur Marrëveshja e Brukselit (2013) pastaj ajo për implementimin e saj (2015). Ndërkohë, gjithnjë me lehtësimin e BE-së ka vazhduar dialogu Kosovë Serbi dhe më 27.02.2023 në Bruksel është arritur Marrëveshja për rrugën e normalizimit të marrëdhënieve Kosovë – Serbi, kurse më 18.03 2023, në Ohër të Maqedonisë së Veriut është arritur pajtimi për Aneksin implementues të kësaj marrëveshje.

Kosova është e gatshme gjithmonë për dialog dhe nuk sheh rrugë tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përveç dialogut. Sa i përket aspekteve të brendshme, sidomos atyre që kanë të bëjnë me demokracinë elektorale, Kosova po ashtu ka një traditë të dëshmuar demokratike në këtë aspekt. Në asnjë rast prej se janë mbajtur zgjedhje të lira nuk ka ndodhur që pala humbëse mos ta njeh fituesin. Tranzicione pushtetesh në Kosovë kanë ndodhur disa herë, dhe secilën herë tranzicioni është bërë në mënyrë të qetë dhe demokratike.

• **Dispozitat kushtetuese dhe/ose legislative që garantojnë barazinë ndërmjet grave dhe burrave: Klikoni këtu për të futur tekstin.**

Duhet theksuar që korniza ligjore e Republikës së Kosovës e përcakton barazinë gjinore si të drejtë themelore dhe parim thelbësor. Në nenin 7.2 të Kushtetutës, barazia gjinore njihet “si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje

të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore”. Kushtetuta i referohet veçanërisht Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEGFDG) dhe Konventës së Stambollit. Legjislacioni i Kosovës e njihë Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (Rezoluta 1325 e OKB-së). Ligjet dhe rregulloret vendore për barazinë gjinore i reflektojnë parimet dhe legjislacionin ndërkombëtar për barazinë gjinore dhe promovimin e të drejtave të grave. Këtu përfshihet Ligji nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligji nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Ngacmimi seksual dhe dhuna në familje janë përfshirë në Kodin Penal të rishikuar të vitit 2020.

Ligji nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës i miratuar më 27 tetor 2022 parasheh si parim të përgjithshëm barazinë gjinore dhe përcakton që Qeveria ushtron pushtetin e saj duke u bazuar në parimin e barazisë gjinore dhe mundësitë e barabarta siç përcaktohet me Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Mekanizmat institucionalë që e promovojnë dhe mbrojnë zbatimin e barazisë gjinore si e drejtë kushtetuese në institucionet publike dhe i mbrojnë politikat që sigurojnë qasje të barabartë të grave në shoqëri dhe në shërbime, janë të rregulluara me ligj. Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) është organ i rëndësishëm e cila ka mandat të hartojë, të zbatojë, të propozojë, të koordinojë, të monitorojë politika publike vendore dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore, dhe po ashtu është përgjegjëse për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në Kosovë.

◦ **Masat kryesore të miratuara në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burra: Klikoni këtu për të futur tekstin.**

Në zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore- Nenit 11, Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar dhe miratuar Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGJ) 2020 -2024 me vendimin Nr.01/341, nën udhëheqjen e Agjencisë për Barazi Gjinore – Zyra e Kryeministrit. Përmes Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, synohet të sigurohet që barazia gjinore të jetë në qendër të proceseve transformuese në Kosovë, në kuadër të të gjitha strukturave, institucioneve, politikave, procedurave, praktikave dhe programeve të qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve. Ky objektivi synohet të arrihet duke punuar në këto tri drejtime/ tri objektive strategjike në tri shtyllat kryesore të PKBGJ-së: Krijimin e mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfitur në /nga zhvillimi ekonomik, rritjen e gjithëpërfshirjes dhe përmirësimin e mirëqenies sociale; Avancimin e barazisë gjinore, përmes arsimit dhe shëndetësisë cilësore, gjithëpërfshirjes, dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore si kontribuues në zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor dhe zhdukjen e pabarazive dhe stereotipave gjinore; dhe avancimin drejt realizimit të plotë të së drejtës në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi si garantues i arritjes së barazisë gjinore.

Arritjet kyçe në agjendën e barazisë gjinore në Kosovë, të Qeverisë së RKS, akterëve vendorë dhe ndërkombëtarë, sipas vlerësimit të dhënave të monitoruara nga Agjencia për Barazi Gjinore gjatë vitit 2020 dhe 2021 janë të listuara si në vijim: përfshirja e Konventës së Stambollit në Kushtetutën e Kosovës; miratimi i Koncept Dokumentit për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor, i aprovuar nga Qeveria në nëntor 2022; Është miratuar Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026; Republika e Kosovës për herë të parë gjatë kohës së realizimit të këtij raporti, raportoi para Komitetit të Këshillit të Evropës – GREVIO mbi nivelin e përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së

Kosovës kur kemi të bëjmë me Konventën e Stambollit, dhe nivelin e zbatimit në përgjigje ndaj dhunës në familje me fokus dhunën ndaj grave; Përplotësimi i Ligjit për Ndihmë Juridike Falas, përmes të cilit garantohet ndihmë juridike falas pavarësisht gjendjes ekonomike dhe sociale për viktimat e dhunës në familje; viktimat dëshmitare të dhunës, viktimat e dhunës në baza gjinore; viktimat e cilitdo lloj të dhunës seksuale, përfshirë dhe ngacmimin seksual;

Poashtu, Qeveria e Kosovës, ka miratuar Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 01/ 2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në Emër të dy Bashkëshortëve, i aprovuar në mbledhjen e Qeverisë, më datë 23.03.2022, (vendimin nr. 08/86). Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është ndryshimi i nenit 9 të udhëzimit administrativ bazik nr.03/2016 për stimulimin e regjistrimit të pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të dy bashkëshortëve, në regjistrat publikë, si masë afirmative, që promovon barazinë gjinore. Kjo masë, e prezantuar për herë të parë në vitin 2016, ka çuar në një rritje të dukshme në regjistrimin e grave si pronare të pronave. Sipas të dhënave, nga kjo masë afirmative për periudhën janar- tetor 2022 kanë përfituar 3560 çifte, ndërsa në total janë 11 727 çifte që kanë pronën në emër të përbashkët, pra prona është në emër të dy bashkëshortëve.

Më 25/11/2023 Ministria e Drejtësisë ka bërë hapjen e fushatës vetëdijësuese “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, ku në kuadër të kësaj fushate janë organizuar mbi 80 aktivitete me qëllim që të rritet fryma në shoqërinë tonë për angazhim të përhershëm në ngritje të vetëdijës qytetare me qëllim të parandalimit të dhunës me bazë gjinore, si dhe fuqizimin e institucioneve dhe mekanizmave ligjor që ndërhyjnë në mënyrë efektive për të ndaluar dhe ndëshkuar aktet e dhunës. Në këtë kuadër, me vendim të ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit znj. Arbërie Nagavci, në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës, një orë e mësimi i është knshtuar diskutimit mbi fenomenin e dhunës me bazë gjinore, me qëllim të ngritjes së vetëdijes te moshat e reja, për të parandaluar dhe luftuar veprimet e tilla të dëmshme.

• Çdo element shtesë (politika publike, avokim, veprim, program, etj.) duke bërë të mundur të demonstrojë lidhjen e saj me promovimin dhe respektin për demokracinë, të drejtat dhe liritë: *Kliko këtu për të futur tekstin.*

Presidenca –Presidentja e Republikës së Kosovës, Sh.T. Dr. Vjosa Osmani Sadriu, gjithashtu Komandante Supreme e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ka vendosur Agjendën për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në qendër të angazhimit të saj për të fuqizuar sektorin e sigurisë dhe për të zhvilluar politika publike të qëndrueshme, të përqendruara në promovimin e barazisë gjinore. Në vijim të këtij angazhimi, në vitin 2021, si pjesë e zotimeve të Republikës së Kosovës në kuadër të Samitit për Demokraci të Presidentit Biden dhe me iniciativë të Presidentes Osmani, u organizua edicioni i parë i Forumit Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Ky forum, i cili vendosi Kosovën në hartën globale të ngjarjeve ndërkombëtare, tashmë është bërë një platformë tradicionale që shërben si vendtakim për liderë botërorë, organizata ndërkombëtare, ekspertë të fushës, akademikë etj. Qëllimi qendror i diskutimeve është fuqizimi i rolit të grave në proceset e paqes dhe sigurisë. Forumi rikthehet këtë vit me edicionin e dytë, duke u fokusuar në dy tema qendrore: parandalimi i dhunës seksuale në luftë dhe garantimi i sigurisë për gratë dhe vajzat përballë sfidave të shkaktuara nga ndryshimet klimatike.

Si rezultat i këtij angazhimi, Republika e Kosovës është përzgjedhur të jetë një nga tre vendet nikoqire të Qendrave rajonale të Ekselencës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, së bashku me Kolumbinë dhe Indonezinë. Themelimi i kësaj qendre po bëhet me mbështetjen e Zyrës së

Sekretarët të Shtetit të SHBA-ve për Çështjet Globale të Grave, si pjesë e Strategjisë për Gratë, Paqen dhe Sigurinë të administratës Biden-Harris. Kjo qendër do të ndihmojë në fuqizimin e përpjekjeve për avancimin e agjendës jo vetëm në Kosovë, por edhe në gjithë rajonin, si dhe do të shërbejë në drejtim të fuqizimit të shkëmbimit të praktikave më të mira të zbatimit të kësaj agjende, duke përfshirë edhe vendet e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë.

Më tej, pas organizimit të edicionit të parë të Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe në prag të edicionit të dytë, edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës ka pohuar një rol më aktiv duke shtuar angazhimin parlamentar për monitorimin e zbatimit të kësaj agjende dhe avancimin e saj përmes ligjeve përkatëse. Në këtë drejtim, vërehet një rritje e angazhimit nga Grupi i Grave Deputete. Përmes angazhimit të Zyrës së Presidentes dhe përmes Forumit për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, është promovuar bashkëpunimi i rregullt dhe aktiv me shoqërinë civile, akademinë, organizatat ndërkombëtare dhe komunitetin e biznesit. Kjo ka nxitur një qasje gjithëpërfshirëse në bashkëpunim, e cila ka mundësuar partneritete me homologë në të gjitha fushat dhe nga shtete të ndryshme anembanë botës, duke përfshirë edhe vendet anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë.

Forumi Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, si dhe Qendra Rajonale e Ekselencës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, përveç se fuqizojnë përpjekjet e Kosovës për zbatimin e suksesshëm të kësaj agjende, do të shërbejnë gjithashtu në thellimin e marrëdhënieve me vendet mike në drejtim të fuqizimit të rolit të grave dhe vajzave në proceset e paqes dhe sigurisë, dhe jo vetëm.

Qeveria - Duhet shtuar që Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë kohës së zbatimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore në vitet 2020 dhe 2021, ka arritur që të integrojë perspektivën gjinore në kuadër të Fondit të Rimëkëmbjes Ekonomike 2020, si dhe Pakos për Ringjallje Ekonomike të qershorit 2021. Kjo e vendosë Kosovën ndër vendet të cilat me sukses kanë arritur t'i përgjigjen situatës së Covid 19 me perspektivë gjinore, me masa të ndjeshme në aspektin e gjinisë dhe njetëve buxhetore të dedikuara për këtë qëllim. Në vitin 2020 është ndarë fond tek Agjencia për Barazi Gjinore në vlerë prej 1 milionë Euro dhe janë mbështetur kopshtet në pronësi private dhe në partneritet publiko-privat të udhëhequra nga 108 gra dhe 7 burra) ; 6,638 fëmijë nga të cilët 3,249 vajza dhe 3389 djemë, të përfshirë në këto kopshte; 1,145 gra të punësuar në 115 çerdhet e mbështetura. Në vitin 2021 Agjencia për Barazi Gjinore përmes Fondit në vlerë prej 1 milionë Euro ka mbështetur 273 bizneseve të vogla në pronësi të grave, në vlerë totale prej 207,284.00 Euro; dhe 24 OJQ - organizata në vlerë prej 647,000 Euro. Përmes financimit të këtyre 24 OJQ-ve janë mbështetur 1,296 gra dhe vajza nga ky numër : 296 gra dhe vajza kanë përfituar shërbimeve si: këshilla juridike, shërbime dhe iniciativa të fuqizimit ekonomik; 185 gra dhe vajza -persona fizik përfituan grante për zgjerim biznesi; 48 OJQ përfituan (sub) grante; 803 gra dhe vajza, janë trajnuar për hapje e bizneseve të reja, shitjen e produkteve online, marketingun e produkteve, themelimin e brendit, funksionalizimin e faqeve për shitje të produkteve të bizneseve individuale. Me qëllim të rritjes së qasjes së grave në financa dhe në mbështetje të bizneseve në pronësi të grave, kolateralit si mbështetje e rëndësishme për bizneset në pronësi të grave, në fund të vitit 2021, Fondi për Garanci Kreditore ka mbështetur 269 biznese të grave me garanci në vlerë prej 8.6 milionë Euro, vlera e kredisë ishte 11.7 milionë Euro.

Ministria e Financave, Punës dhe Transferit - në kuadër të Pakos për Ringjallje Ekonomike të aprovuar në vitin 2021 ka mbështetur punësimin dhe me këtë rast janë ri-punësuar 1,939 gra në vlerë prej 290,850 Euro për secilën që nuk ka qenë e punësuar në 3 muajt e fundit, e në rast

të punësimiit Qeveria- subvencion 50% të pagës për 3 muajt e parë, deri në maksimumin prej 150 euro në muaj dhe pas tre muajve pagesën e kontributit pensional deri në një vit. Masa 1.2 mbështetja për punëtorët e formalizuar 1,490 punëdhënës me gjithsej 3,571 të punësuar, vlera e mbështetjes është 1.6 milionë Euro. Masa 3.5- Pagesa për lehonat e papuna – 3 mil Euro, në kuadër të kësaj skeme, të gjitha lehonat që nuk punojnë, do të përfitojnë mbështetje në nivelin e pagës minimale për 6 muaj me radhë. Vitin 2021, 2,384,760 Euro janë paguar për lehonat e papunë dhe 948,940 Euro shtesë për lehonat e punësuarat e që kanë qenë në pushim të lehonisë.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - ka ndarë 1,365 bursa për vajza dhe gra që studiojnë në fushën STEM, secilës nga 1,000 Euro, gjithsej 1,365,000 Euro. Gjatë vitit 2021 ka përkrahur 24 kandidatë për bursë të doktoratës për studentët që studiojnë në 500 universitet me të mira të botës, prej tyre 10 vajza.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - gjatë vitit 2020, ka ofruar mbështetjen për 91 klube sportive të vajzave me vlerë buxhetore 442,750 Euro dhe 134,640 Euro për klube të përzierat.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - në vitin 2020 ka ndarë fond prej 470,000 Euro për të mbështetur bizneset në pronësi të grave – 32 subvencione iu kanë shpërndarë bizneseve në pronësi të grave. Duhet shtuar që Institucionet e Republikës së Kosovës kanë adresuar çështjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, në kuadër të procesit të hartimit të Planit të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 “Gratë Paqja dhe Siguria” 2013-2015. Ky Plan i Veprimit, i miratuar nga Qeveria e RKS-së është realizuar në nivelin 79% të aktiviteteve. Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2014 ka miratuar ndryshimet në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për “Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, Viktimat Civile dhe Familjet e tyre” që përfshinte Kategorinë e Personave të Përdhunuar gjatë Luftës, si kategori - Viktimat Civile të Luftës. Mekanizmi përgjegjës për njohjen e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës është Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Personave të Dhunuar Seksualisht gjatë Luftës, i cili zyrtarisht filloi punën më 5 shkurt 2018. Ky komision përbëhet nga nëntë anëtarë ku njëri prej tyre është anëtar i shoqërisë civile. I tërë procesi garanton sigurinë e plotë të të mbijetuarës/it përfshi mbrojtjen e të dhënave personale. Poashtu Qeveria e Republikës së Kosovës financon në baza të rregullta vjetore 10 strehimore në nivel vendi, përmes thirrjes publike të subvencionimit,

SHTOJCA
KRITERET PËR NDARJEN DHE PROMOVIMIN E VLERAVE TË
FRANKOFONISË

Lista indikative dhe jo shteruese e konventave kryesore ndërkombëtare që bëjnë pjesë kryesisht në vlerat e Frankofonisë:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948)
- Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit (1948)
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (1965)
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (1966) dhe Protokollet e tij Opsionale (1976, 1989)
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966) dhe Protokollin e tij opsional (2008)
- Konventa mbi mosparashkrimin e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit (1968)
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979) dhe Protokollin e tij opsional (1999)
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit (1982)
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese (1984) dhe Protokollin e saj opsional (2002)
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës (1989) dhe Protokollet e saj opsionale (2000, 2011)
- Konventa për ndalimin e përdorimit, grumbullimit, prodhimit dhe transferimit të minave kundër personelit dhe shkatërrimi i tyre (1997)
- Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale (1998)
- Konventa për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të shprehjeve kulturore (2005)
- Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin e saj opsional (2006)
- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave të zhdukur me forcë (2010).

Instrumentet kryesore rajonale për shtetet candidate të interesuara që janë kryesisht në përputhje me vlerat e Frankofonisë:

- Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950)
- Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut (1969).
- Karta afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve (1981) dhe Protokollin e saj mbi të Drejtat e Grave (2003).
- Deklarata e Parimeve Politike të Komunitetit Ekonomik të Afrikës Perëndimore (1991).
- Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2000).
- Protokollin mbi Demokracinë dhe Qeverisjen e Mirë shtesë i Protokollit në lidhje me Mekanizmin për Parandalimin, Menaxhimin, Zgjidhjen e Konflikeve, Ruajtjen e Paqes dhe Sigurisë (2001).
- Karta Arabe e të Drejtave të Njeriut (2004).
- Karta Afrikane për Demokracinë, Zgjedhjet dhe Qeverisjen (2007).

DOKUMENTET E BASHKËNGJITURA: SHTOJCAT

- ANNEXE 1: <https://mfa-ks.net/wp-contact/uploads/2023/4/konkurs-per-poziten-specialiste-te-pergjithshem-te-shkencave-politike-njohja-e-gjuhes-frengje.pdf>.
- ANNEXE 2: <https://www.tirana.al/artikull/edicioni-i-9-te-i-parlamentit-frankofon-ne-tirane-veliaj-pershendet-ne-gjuhen-frengje-sesionin-e-hapjes-plenare-eshte-viti-i-lidhjeve-mes-te-rinjve-nga-mbare-bota>.
- ANNEXE 3 : <https://kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/ftese-per-aplikim-per-pjesemartje-ne-edicioni-26466/>; <https://kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/kuvendi-i-republikes-se-kosoves-dhe-asambleja-27818/>.
- ANNEXE 4: Vendimi i Kuvendit të Kosovës për emërimin e kryetarëve, nënkryetarëve dhe anëtarëve të 56 Grupeve të Miqësisë (8 prill 2022).
- ANNEXE 5: Marrëveshja për Bashkëfinancimin e Bursave të Arsimit të Lartë në Nivelin Master.
- ANNEXE 6: Korniza Kurrikulare - FINALE.pdf.
- ANNEXE 7: Vendim nr. 383-01B per aprovimin e teksteve shkollore.pdf.
- ANNEXE 8: <https://kryeministri.rks-gov.net/zyra-e-kryeministrit/zyrat/zyra-e-komisionerit-per-gjuhe/>.
- ANNEXE 9: Memorandumi i partneritetit lidhur me Iniciativën Kombe4tare Frankofone mes ONF dhe Republikës së Kosovës për periudhat kohore 2019-2022, dhe 2023- 2026.
- ANNEXE 10 : <https://masht.rks-gov.net/category/arsimi-parauniversitar/page/10/>.
- ANNEXE 11: Protokollit i Bashkëpunimit shkencor lidhur me misionin arkeologjik francez dhe kosovar, 9 qershor 2017 dhe plotësim-ndryshimi i protokollit të Bashkëpunimit shkencor lidhur me misionin arkeologjik francez dhe kosovar, i datës 27.07.2022.
- ANNEXE 12: Shkresat e pranimit të Odës së Avokatëve të Kosovës në CIB.
- ANNEXE 13: Shkresat e pranimit të Institucionit të Avokatit të Popullit në Asociacionin e Ombudsmanëve Frankofonë.
- ANNEXE 14: Shkresat e pranimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP) e Republikës së Kosovës në Shoqatën Frankofone për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- ANNEXE 15: Shkresa e kërkesës për aderim të Gjykatës Supreme të Kosovës në AHJUCAF dhe shkresa e SP të AHJUCAF konfirmimi i pranimit si anëtar vëzhgues.
- ANNEXE 16: <https://kosovo.ambafrance.org/-Aleanca-Franceze-e-Prishtines>
(<https://af-pristina.com/>).
- ANNEXE 17: (<https://kosovo.ambafrance.org/Shkollja-Nderkombetare-Franceze-e-Prishtines>).
- ANNEXE 18: Konventa për bashkëpunim midis Akademisë franceze dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, më 16 nëntor 2017 në Prishtinë.
- ANNEXE 19: Marrëveshja për Bashkë-prodhim të Filmit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës:
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=59755>.
- ANNEXE 20 : Lista e aktiviteteve të Filharmonisë në bashkëpunim me Francën.
- ANNEXE 21 : Amandamenti nr. 26 kushtetues i datës 25 shtator 2020, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.
- ANNEXE 22 : Ligji nr. 08/L-118 për ratifikimin e Marrëveshjes për statusin e forcave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shtetit të Kuvajtit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, për Projektin "Fondi i Mirëbesimit me një Donator të Vetëm për Programin e Nxitjes dhe Levimit të Mundësive për Sigurinë e Ujit".
2. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafit 8. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete buxhetore në shumë prej 142,000.00€, (njëqindedyzet e dy mijë euro), për financimin e Samitit të Ballkanit Perëndimor të organizuar nga "The Economist".
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nën-programi për Promovim të Vendit dhe transferohen në llogarinë bankare të përcaktuar nga "The Economist".
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Udhëtarëve dhe Mallrave.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/208

Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Finlandës për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Udhëtarëve dhe Mallrave.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/208

Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 15, paragrafit 4, të Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-058, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2025.
2. Obligohet Agjencia e Statistikave të Kosovës që pjesën e implikimeve financiare të Planit nga pika 1. e këtij Vendimi, ta harmonizojë me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave të Kosovës për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/208

Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 49 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 16 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Z. Ilir Muçaj, emërohet Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë katër (4) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij Vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosje të masave kufizuese ndaj Iranit

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton masat kufizuese të vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
 - 1.1. Rregullores së Këshillit (EU) Nr.267/2012, (23.03.2012), lidhur me masat shtrënguese kundër Iranit, amendamentuar dhe zgjeruar me rregulloren zbatuese të Këshillit (EU) Nr.2022/2196 (16.10.2023), respektivisht Vendimit të Këshillit 2010/413/CFSP, (26.07.2010), amendamentuar me Vendimin: (CFSP) 2023/2195 (16.10.2023).
2. Të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve, të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1. konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Masat shtrënguese do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen, plotësohen apo ndryshohen.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:


V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022 "Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për vendosje të sanksioneve ndaj Federatës Ruse dhe Bjellorusisë, në raport me situatën në Ukrainë"

1. Ndryshohet dhe plotësohet Pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/64, të datës 25 shkurt 2022, si në vijim: Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian përmes:
 - 1.1. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 269/2014, (17.03.2014), lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloren zbatuese të Këshillit (EU) Nr.2024/753 (23.02.2024), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/145/CFSP, (17.03.2014), amandamentuar me vendimet: (CFSP) 2024/747 (23.02.2024), 2024/195 (21.12.2023), 2023/2874 (18.12.2023), 2023/2871 (18.12.2023);
 - 1.2. Rregullores së Këshillit (EU) Nr. 833/2014 (31.07.2014) lidhur me masat shtrënguese ndaj veprimeve destabilizuese të Rusisë, lidhur me situatën në Ukrainë, amandamentuar dhe zgjeruar me rregulloret zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2024/745 (23.02.2024), respektivisht Vendimit të Këshillit 2014/512/CFSP (31.07.2014), amandamentuar me Vendimin: (CFSP) 2024/746 (23.02.2024).
2. Të gjitha llojet e sanksioneve, emrat e individëve, entiteteve dhe produkteve, të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1. konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Masat shtrënguese do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen, plotësohen apo ndryshohen.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:


V E N D I M

Për zbatimin nga Republika e Kosovës të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosje të masave kufizuese lidhur me shkeljen serioze dhe abuzimeve të të drejtave të njeriut, në Federatën Ruse

- Qeveria e Republikës së Kosovës, zbaton masat kufizuese të vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian, përmes:
 - Rregullores Implementuese të Këshillit (EU) Nr. 2020/198 (07.12.2020), lidhur me shkeljen serioze dhe abuzimeve të të drejtave të njeriut, amendementuar dhe zgjeruar me rregulloren zbatuese të Këshillit (EU) Nr. 2024/951 (22.03.2024), respektivisht Vendimit të Këshillit (CFSP) 2020/1999 (07.12.2020), amendementuar me Vendimin (CFSP) 2024/951 (22.03.2024).
- Të gjitha llojet e masave kufizuese, emrat e individëve, entiteteve, të lidhura me vdekjen e Alexey Navalny, të cilat janë të sanksionuara përmes akteve ligjore të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anekseve përkatëse të cekura në pikën 1.1. konsiderohen pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
- Masat kufizuese do të jenë në fuqi, deri në një Vendim tjetër dhe varësisht nga rrethanat mund të përditësohen, plotësohen apo ndryshohen.
- Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Grupit Redaktues për trajtimin e veprave të botuara dhe dorëshkrimeve të pa botuara të Prof. Ukshin Hoti

- Themelohet Grupi Redaktues për trajtimin e veprave të botuara dhe dorëshkrimeve të pa botuara të Prof. Ukshin Hoti, në këtë përbërje:
 - Z. Bislim Elshani, autor; dhe
 - Z. Gent Carrabregu, studiues.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/208
Datë: 13.06.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, dhe Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 3,000,000€ (tre milionë euro) për zbatimin e Masës 2.2 "Mbështetja e Bizneseve për Qasje në Financa" të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me kod 201, nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet buxhetore sipas pikës 2. këtij Vendimi, transferohen nga Thesari tek organizata jobuxhetore Fondi Kosovar për Garanci Kreditore në llogarinë e përcaktuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpunimit sipas pikës 5. të këtij Vendimi.
4. Mjetet buxhetore sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e projektit (00098) te organizata buxhetore dhe programi përkatës.
5. Autorizohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të nënshkruajë Marrëveshje të Bashkëpunimit me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore për përcaktimin e përgjegjësisive institucionale në themelimin dhe zbatimin e Skemës së Garancisë Kreditore "Dritarja për Investimet e Diasporës".
6. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/208
Datë: 13.06.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-208 për Parqet Industriale dhe Teknologjike, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Parku i Përgjithshëm në Komunën e Drenasit me kohëzgjatje prej 99 vite.
2. Pronat e paluajtshme në të cilat themelohet Parku i Përgjithshëm janë të regjistruara në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kanë një sipërfaqe prej 36.50 ha.
3. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 23/208
Datë: 13.06.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14.07.2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25.08.2021, Vendimin Nr. 01/49 të datës 17.12.2021, Vendimin Nr. 15/62 të datës 23.02.2022, Vendimin Nr. 04/90 të datës 26.07.2022, Vendimin Nr. 20/140 të datës 26.04.2023, dhe Vendimin Nr. 23/159 të datës 13.09.2023, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 3,000,000€ (tre milionë euro) për zbatimin e Masës 4.5 "Mbështetja e Mërgatës" të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me kod 201, në nën-programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Mjetet buxhetore sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e projektit (00098) të organizata buxhetore dhe programi përkatës.
4. Autorizohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës të nënshkruajnë Memorandumin e Bashkëpunimit me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Byronë Kosovare të Sigurimit, sipas fushave të përgjegjësive institucionale, për mbulimin e plotë të obligimeve të primit të sigurimit kufitar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për të gjitha automjetet dhe motoçikletat që janë subjekt i policës kufitare dhe vijnë në Kosovë deri në fund të vitit 2024, sipas përkufizimeve që përcaktohen në Memorandumin e Bashkëpunimit.
5. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa fillimi i mbulimit të sigurimit kufitar dhe lëshimit të policës kufitare pa kosto për bashkatdhetarët dhe të huajt, sipas pikës 1. të këtij Vendimi përcaktohet me Memorandumin e Bashkëpunimit.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë